

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje Europiane dhe të sigurisë - 24

Çështje Europiane dhe të sigurisë

European and security affairs

Revistë katërmujore mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Bordi shkencor:

Prof. dr. Rexhep Meidani (kryetar)

Dr. Pëllumb Qazimi (anëtar)

Arjan Dyrmishi (anëtar)

Dr. Elona Dhëmbo (anëtare)

Foto Duro, kandidat për Dr. (anëtar)

Redaktor përgjegjës:

Elira Hroni - MA

Ndihmuan në përgatitje:

Egest Gjokutaj

ISSN 2223-9278

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare
të Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s
dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur OSI Think tank Fund

PËRMBAJTJA

Parathënie	7
-------------------------	----------

Jasna Pekic - Jasmin Porobic	9
Mbrotjtja e të drejtave të njeriut në forcat e armatosura të Bosnjë-Hercegovinës: Roli i Komisionerit Parlamentar për ushtrinë e Bosnjë-Hercegovinës	

Dr. Elona Dhembo

Përkatësia gjinore dhe çështjet e sigurisë 23

Bedrudin Brljavac

Diskriminimi institucional ndaj grupeve minoritare në Bosnjë-Hercegovinë: pengesë për anëtarësimin në BE35

Foto Duro

Sistemi i densionimit në Forcat e Armatosura të Shqipërisë62

Rezart Tërshana.....

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të drejtat e liritë themelore të njeriut (e drejta e shoqërimit)82

Drita Avdyli - Kandidate për Dr.

Gentiana Bektashi (Patozi) - doktorante në studimet europiane

Analizë mbi politikën e maksimizimit të ndikimit pozitiv të kthimit të emigrantëve shqiptarë nga jashtë vendit105

Abstracts.....	122
-----------------------	------------

PARATHËNIE

Në përpjekje për të kontribuar në informimin e publikut mbi çështjet kryesore të politikave mbi reformat dhe performacën e sektorit të sigurisë në përgjithësi, trendet europiane dhe globale të sigurisë, debatin aktual dhe të ardhshëm mbi fushat prioritare të NATO-s, sfidat e Shqipërisë për reformimin e institucioneve dhe qeverisjes në sektorin e sigurisë, çështjet debatuese dhe partneritetet e NATO-s me BE-në dhe organizatat e tjera botërore, ky numër i revistës për Çështjet europiane dhe të sigurisë vjen më një tematikë të veçantë mbi të drejtat e njeriut në sektorin e sigurisë.

Kjo fushë studimi, duke u përqendruar te respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të punonjësve në sektorin e sigurisë (polici, forcat e armatosura dhe institucione të tjera të sigurisë) kërkon të japë një panoramë mbi sfidat dhe problematikat në këtë fushë. Përveç të tjerave, trajtohen edhe disa problematika të tjera, si: balanca gjinore dhe diversiteti në sektorin e sigurisë apo mbrojtja e të drejtave të minoriteteve si një parakusht për perspektivën europiane.

Jasna Pekic
Jasmin Porobic

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT
 NË FORCAT E ARMATOSURA TË BOSNJË HERCEGOVINËS:
 ROLI I KOMISIONERIT PARLAMENTAR PËR USHTRINË
 E BOSNJË HERCEGOVINËS

Përmbledhje

Komisioneri parlamentar për ushtrinë përmirëson mbrojtjen e të drejtave të njeriut në ministrinë e mbrojtjes dhe forcat e armatosura të bosnjë hercegovinës. Ai kontribuon në mënyrë domethënëse për rritjen e besueshmërisë në sektorin ushtarak duke krijuar transparencë më të madhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut pa paragjykime, bazuar në hierarkinë ushtarake.

Ky studim analizon rolin dhe mandatin e komisionerit për ushtrinë në kuadrin e përgjithshëm institucional për të drejtat e njeriut. Ai krahason mandatin e komisionerit me atë të inspektorit të përgjithshëm të ministrisë së mbrojtjes të bosnjë hercegovinës dhe me mandatin e institucionit të ombudsman-it të bosnjë hercegovinës. Pasi parashton qartësisht rolin, mandatin dhe rezultatet e komisionerit për ushtrinë, studimi argumenton se komisioneri për ushtrinë ushtron një ndikim pozitiv në kuadër të përpjekjeve të bosnjë hercegovinës për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut jo vetëm në mjedisin civil, por edhe në atë ushtarak.

Modeli gjerman i komisionerit parlamentar për ushtrinë, që kur është vendosur në bosnjë hercegovinë ka përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personelit ushtarak. Numri i rasteve të dhunimit të të drejtave të njeriut, të raportuara, është rritur dukshëm. Përqindja e rasteve të zgjidhura gjithashtu është afërsisht 90 %. Komisioneri krijon një mjedis që përmirëson aksesin te drejtësia, ndihmën ligjore falas dhe mbrojtjen e të

drejtave të njeriut për personelin ushtarak. Ai gjithashtu eliminon rrezikun e frikës nga ndëshkimi prej komandantëve të ushtrisë dhe kontribuon për një mbrojtje më të mirë të të drejtave të njeriut në bosnjë hercegovinë. Shumë sfida të tjera shtrihen përpara dhe ai mbetet thelbësor për zgjidhjen e rasteve të dhunimit të të drejtave të njeriut të personelit ushtarak në të ardhmen e afërt.

Hyrje

Komisionet parlamentare për mbrojtjen dhe sigurinë janë zhvilluar si mjete institucionale për mbikëqyrjen e aktivitetit të sektorit të mbrojtjes dhe atij të sigurisë me kompetenca ligjore dhe kushtetuese të përcaktuara qartësisht, praktika të mirëpërcaktuara, burime, ekspertizë dhe vullnet politik. Komisionet janë institucione të zakonshme në demokracitë e zhvilluara dhe adresojnë një sërë çështjesh me rëndësi për mbikëqyrjen civile mbi sektorin e mbrojtjes dhe atë të sigurisë si edhe për sa i përket shtetit ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në institucionet e mbrojtjes dhe sigurisë. Megjithatë, jo shumë vende në botë mund të pretendojnë se adresojnë siç duhet mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Forcat e Armatosura, sikundër është rasti i Bosnjë Hercegovinës përmes institucionit të Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë.

Sipas rekomandimeve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, anëtarët e Forcave të Armatosura konsiderohen si “qytetarë me uniformë” dhe gëzojnë të njëjtat të drejta themelore duke përfshirë ato që përcaktohen në “Kartën Sociale Europiane” si edhe të njëjtën mbrojtje të të drejtave dhe dinjitetit të tyre si çdo qytetar tjetër (duke pasur parasysh edhe kufizime për shkak të nevojave të veçanta të detyrave ushtarake). Pavarësisht kësaj, vende të ndryshme interpretojnë nocionin e “qytetarit me uniformë” në mënyra të ndryshme dhe nuk ekziston një model unik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personelit të forcave të armatosura¹.

1. OSCE, DCAF, Handbook on Human Rights and Fundamental Freedoms of Armed Forces Personnel, OSCE ODIHR, Warsaw 2008, p. 22.

Modeli i vendosur në Bosnjë Hercegovinë përbën një përpjekje të suksesshme për përmirësimin e qasjes ndaj të drejtave të njeriut në efektivat dhe personelin e Forcave të Armatosura. Ky studim analizon aspektet kryesore të Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë, si: historiku, mandati dhe rezultatet e punës së Komisionerit. Studimi prezanton punën e këtij institucioni dhe kontekstualizon rolin e Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë në kuadrin e përgjithshëm institucional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Studimi përshkruan gjithashtu eksperiencën nga rajoni dhe thekson rëndësinë e Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë.

Studimi është zhvilluar nëpërmjet dy instrumenteve: a) për qëllimet e këtij studimi është zhvilluar një intervistë me Komisionerin Parlamentar për Ushtrinë, si edhe b) janë analizuar dokumente relevante dhe Ligji për Komisionerin Parlamentar për Ushtrinë të Bosnjë Hercegovinës. Intervista ishte e gjysmëstrukturuar, ndërsa analizat e dokumenteve ishin të thelluara dhe në formë rishikimi të burimeve ekzistuese (deskreview). Studimi i mëposhtëm përfshin gjithashtu një reflektim mbi rezultatet e punës së Komisionerit, siç u prezantua në Konferencën Rajonale për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Forcat e Armatosura që u mbajt në Sarajevë si edhe bazuar në raportet vjetorë të Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë.

Studimi ndahet në pesë kapituj kryesorë:

- a) Sfondi dhe historiku.
- b) Mandati, roli dhe përgjegjësitë.
- c) Komisioneri Parlamentar për Ushtrinë dhe marrëdhëniet e tij me institucionet e tjera.
- ç) Mbrojtja e të drejtave të njeriut të personelit ushtarak në kontekstin rajonal.
- d) Raportet parlamentare për ushtrinë dhe rezultatet kryesore.

Sfondi dhe historiku

Komisioneri i parë Parlamentar për Ushtrinë në botë (ose Ombudsman, siç i referohen zakonisht) u krijua në Norvegji në vitin 1952. Ombudsman-i, për ushtrinë ka si detyrë të sigurojë

të drejtat e të gjithë anëtarëve të Forcave të Armatosura. Institucioni i Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë ekziston gjithashtu edhe në vende të tjera. Shembulli më domethënës për modelin e Bosnjë Hercegovinës është institucioni i Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë pranë Bundestagut gjerman.

Komisioni për Mbrojtjen dhe Sigurinë i Asamblesë Parlamentare të Bosnjë Hercegovinës u prezantua me modelin e Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë të Bundestagut gjerman në vitin 2009 gjatë një udhëtimi studimor. Për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personelit ushtarak, Bosnjë Hercegovina vendosi për testimin e këtij sistemi duke krijuar institucionin e Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë me mandat trevjeçar. Në vijim, ligji për Komisionerin Parlamentar për Ushtrinë u miratua gjithashtu në vitin 2009. Komisioneri Parlamentar për Ushtrinë është një institucion i pavarur dhe pjesë e Asamblesë Parlamentare të Bosnjë Hercegovinës. Themelimi i tij përmirëson mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të personelit ushtarak dhe të kadetëve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Bosnjë Hercegovinës si dhe, gjithashtu, forcon shtetin ligjor. Komisioneri heton rastet kur dyshohet për dhunim të të drejtave të njeriut në Forcat e Armatosura si edhe merr vendime për rastet e hetuara. Rekomandimet që lëshohen nga Komisioneri janë të detyrueshme për të gjithë njësitë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.

Pavarësisht vullnetit dhe përpjekjeve të singerta të Ministrisë së Mbrojtjes, aktualisht ekzistojnë 10 000 persona - staf profesionist - ose personel të Forcave të Armatosura të Bosnjë Hercegovinës që ende nuk gëzojnë të drejtat themelore të njeriut të garantuara plotësisht nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe nga Kushtetuta e Bosnjë Hercegovinës. Komisioneri Parlamentar për Ushtrinë merr rreth njëqind raste në vit. Institucioni i Komisionerit Parlamentar u themelua për të eliminuar rrezikun që keqpërdorimi apo ngacmimi ndaj anëtarëve ose punonjësve të Forcave të Armatosura të kalonte pa u ndëshkuar për shkak të mungesës së besimit të procedurat disiplinore dhe për shkak të frikës nga ndëshkimi prej komandantëve ushtarakë çka mund të përkeqësonte mbrojtjen e të drejtave të njeriut të anëtarëve të Forcave të Armatosura.

Themelimi i këtij institucioni zgjeron mundësitë që personeli ushtarak ka për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ai siguron, gjithashtu, edhe një akses më të mirë te drejtësia për personelin ushtarak, mundëson ndihmë ligjore falas si edhe kontribuon për zhvillimin e Forcave të Armatosura moderne në Bosnjë Hercegovinë. Këto arsye konfirmuan rëndësinë e institucionit të Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë dhe si rrjedhojë mandati i tij është zgjatur.

Mandati, roli dhe përgjegjësitë

Aktiviteti ushtarak është unik, duke pasur parasysh se ai përfshin kompetenca specifike (për shembull: përdorimin e forcës), por gjithashtu edhe një sërë kufizimesh (për shembull: për të drejtën për grevë ose për pjesëmarrjen në grupime politike). Në praktikën e përditshme, të gjithë personelit profesionist ushtarak - respektimi i zinxhirit të komandimit merret seriozisht dhe është pjesë e praktikës së punës. Në kontekstin e dhunimit të të drejtave të njeriut, kjo do të thotë se oficerët e komandës, nëse nuk detyrohen nga etika morale e profesionit të tyre, mund t'i keqtrajtojnë vartësit e tyre në shumë raste pa pasur nevojë të justifikojnë sjelljen e tyre. Ata që kanë grada më të ulëta mund ta kenë të vështirë të raportojnë incidente të tilla për shkak sepse iu duhet që, së pari, të drejtohen tek eprori i tyre i drejtpërdrejtë dhe më pas tek instancat e tjera. Në Bosnjë Hercegovinë në sajë të institucionit të Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë, çdo ushtarak ose kadet në Forcat e Armatosura ka të drejtën të kontaktojë drejtpërdrejtë me Komisionerin për Ushtrinë pa ndërmjetësimin e strukturave zyrtare si edhe mund të hartojë një ankesë. Ankesa nuk mund të përbëjë shkak për procedura disiplinore ose për diskriminim.

Komisioneri Parlamentar për Ushtrinë mundëson gjykim dhe hetim efektiv dhe efikas të rasteve të dhunimit të të drejtave të njeriut për personelin ushtarak në Bosnjë-Hercegovinë. Siç theksohet edhe në Ligjin për Ombudsman-in parlamentar, rastet zgjidhen në përputhje me standardet më të larta për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si edhe përmes një procesi vendimmarrës transparent. Veprimet e tij sigurojnë se nuk ka grumbullim çështjesh

të pazgjidhura si edhe se drejtësia vendoset në kohë për të gjithë aplikantët. Komisioneri Parlamentar për Ushtrinë punon bazuar në kuadrin ligjor të përbërë nga Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore², Ligji për Komisionerin Parlamentar për Ushtrinë të Bosnjë-Hercegovinës si edhe nga një sërë rregulloresh shtesë që rregullojnë marrëdhëniet e Komisionerit me institucione të veçantë si Zyra e Ombudsman-it dhe Inspektorati i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes³.

Komisioneri viziton kazermat e ushtrisë për t'u siguruar se puna dhe kushtet e jetesës janë në nivele të pranueshme si edhe harton rekomandime detyruese në rastet kur, sa më sipër, nuk vërtetohet. Komisioneri për Ushtrinë ka akses të përhershëm në të gjithë infrastrukturën e Forcave të Armatosura dhe tek të gjitha dosjet e tyre dhe mund të fillojë hetimet menjëherë pasi merr në dorëzim ankesa nga individët (personel ushtarak profesionist i çdo grade) pjesë të Forcave të Armatosura. Çdo ushtarak ka të drejtë të dorëzojë çështjen e tij drejtpërdrejt te Komisioneri pa qenë i detyruar të kalojë përmes kanaleve zyrtare.

Gjatë kryerjes së detyrave të tij, Komisioneri Parlamentar për Ushtrinë mund të zhvillojë seanca dëgjimore me liri të plotë komunikimi, mund të kërkojë raportime nga Ministri i Mbrojtjes ose mund të zhvillojë çdo lloj veprimtarie tjetër hetimore. Komisioneri, gjithashtu, mund të marrë pjesë në seancat dëgjimore disiplinore ose në mbledhjet e Komisionit Parlamentar për Mbrojtjen dhe Sigurinë. Komisioneri harton rekomandime të detyrueshme për palët të cilave iu drejtohen. Në rastet kur dhunimi i të drejtave të njeriut është i dukshëm për të evituar punën hetimore, Komisioneri mund të iniciojë një proces pajtimi.

Rregullat strikte të funksionimit e bëjnë Komisionerin një instrument të dobishëm për vendosjen e marrëdhënieve të

2. KEDNJ ka precedencë ndaj kushtetutës në Bosnjë Hercegovinë.

3. Rregullorja e KPU-së; Rregullorja për bashkëpunimin ndërmjet KPU-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Bosnjë Hercegovinës, Inspektoratit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes të Bosnjë Hercegovinës dhe FA-së të Bosnjë Hercegovinës; si dhe Kodi i Sjelljes për Aspektet Ushtarake dhe Politike të Sigurisë, kuadri ligjor i OSBE-së për bashkëpunim ndërmjet KPU-së dhe zyrës së Ombudsman-it për të Drejtat e Njeriut.

balancuara ndërmjet civilëve dhe Forcave të Armatosura⁴. Sipas Ligjit për Komisionerin Parlamentar për Ushtrinë, gjatë kryerjes së detyrave të tij, Komisioneri mund të kërkojë informacion dhe të aksesojë të dhënat nga ministri i Mbrojtjes dhe nga personeli nën varësinë e ministrit. Kjo e drejtë mund të mohohet vetëm kur ekzistojnë arsye të rëndësishme për ruajtjen e konfidencialitetit të cilat duhen argumentuar përpara Komisionit Parlamentar për Mbrojtjen dhe Sigurinë.

Komisioneri për Ushtrinë, gjithashtu, shtrin mbështetjen e tij edhe te njësitë ushtarake që marrin pjesë në operacionet paqeruajtëse. Aktivitetet e tij në këtë drejtim sigurojnë trajtimin e barabartë dhe dinjitetin njerëzor për gjithë personelin ushtarak në Bosnjë-Hercegovinë. Aksesit të drejtësisë dhe të ndihmës ligjore falas ka rëndësi thelbësore për mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Prandaj Komisioneri sigurohet se çdo person me uniformë ka mundësinë të adresojë shqetësimet e tij për të drejtat e njeriut si edhe se ai/ajo merr trajtim të barabartë përpara ligjit.

Komisioneri Parlamentar për Ushtrinë dhe marrëdhëniet e tij me institucionet e tjera

Komisioneri për Ushtrinë në kuadër të detyrave të tij të përditshme bashkëpunon me Ministrinë e Mbrojtjes, me Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës si edhe me institucionin e Ombudsman-it. Ky seksion analizon këtë bashkëpunim duke synuar të pozicionojë institucionin e Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë në kuadrin e përgjithshëm institucional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Institucioni i Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë plotëson punën e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe atë të institucionit të Ombudsman-it. Të tre këto institucione kanë mandate të ndryshme të cilat nuk mbivendosen dhe që përmirësojnë mundësitë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personelit ushtarak. Komisioneri për Ushtrinë rrit besueshmërinë

4. Ankesat dhe shqetësimet civile nga Ministria e Mbrojtjes e Bosnjë-Hercegovinës i çohen Zyrës së Ombudsmanit.

në sektorin ushtarak duke krijuar një transparencë më të madhe pa paragjykim ndaj hierarkisë ushtarake dhe eliminon rrezikun që keqpërdorimi dhe abuzimi i anëtarëve të Forcave të Armatosura të kalojë pa u ndëshkuar për shkak të frikës ndaj ndëshkimit prej komandantëve ushtarakë. Ndërsa Komisioneri për Ushtrinë është një strukturë e pavarur, Inspektori i Përgjithshëm është një njësi organizative e Ministrisë së Mbrojtjes. Inspektori i Përgjithshëm zhvillon trajnime dhe këshillon Ministrin e Mbrojtjes lidhur me eliminimin e kushteve që prekin moralin, efikasitetin dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi. Ajo që ka rëndësi për këtë studim, është se Inspektorati i Përgjithshëm fillon dhe zhvillon hetime lidhur me pretendimet për shkelje dhe për dhunimin e të drejtave të njeriut në Forcat e Armatosura. Inspektori i Përgjithshëm ka autoritetin për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut pa paragjykim dhe është i autorizuar që t'i propozojë ministrit të Mbrojtjes miratimin e zgjidhjeve sistematike që themelojnë procedurat për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Duket sikur roli i Inspektoratit mbivendoset disi me atë të Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë. Megjithatë, ndërmjet tyre ekziston një ndryshim i rëndësishëm: "Inspektorati i Përgjithshëm është një njësi organizative brenda një institucioni me kompetenca ekzekutive (pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes). Ai ka gjithashtu një shkallë të madhe pavarësie. Inspektorati i Përgjithshëm, megjithatë, dorëzon raportet e tij pranë ministrit të Mbrojtjes dhe për këtë arsye raporti mbetet i ekspozuar ndaj keqpërdorimit"⁵.

Bashkëpunimi ndërmjet Institucionit të Ombudsman-it për të Drejtat e Njeriut të Bosnjë-Hercegovinës dhe Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë përcaktohen në Rregulloren për Bashkëpunim ndërmjet Institucionit të Ombudsman-it për të Drejtat e Njeriut të Bosnjë-Hercegovinës dhe Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë të dhjetorit të vitit 2009. Dy institucionet shkëmbejnë informacione dhe bashkëpunojnë në fushën e dhunimit të të drejtave të njeriut. Ombudsman-i mundet që, pa pasur miratimin paraprak të paditësit ushtarak, të informojë për një çështje Komisionerin për Ushtrinë për veprime të mëtejshme.

5. Protecting Human Rights and Freedoms of AF Personnel, Regional Conference Publication, BiH PA INDOK, 2011, p. 20 (speech by BiH Parliamentary Military Commissioner).

Në raste të tilla Komsioneri për Ushtrinë informon Ombudsman-in për të Drejtat e Njeriut për ndërmarrjen e procedurave dhe përfundimet e nxjerra prej tyre. Megjithëse Komisioneri mbron të drejtat e njeriut të personelit ushtarak, ai mund t'i transferojë Ombudsman-it çështje që lidhen me kontraktorë civilë që janë punësuar prej Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo - modus operandi - siguron mospasjen e mbivendosjes ndërmjet institucioneve si edhe që të dy institucionet të kontribuojnë përmes bashkëpunimit të ndërsjellë për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të qytetarëve të Bosnjë-Hercegovinës, qofshin këta civilë apo ushtarakë.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut të personelit ushtarak në kontekstin rajonal

Ndërsa të drejtat e njeriut për personelin ushtarak në Bosnjë-Hercegovinë garantojnë përmes Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë, mbrojtja e të drejtave të njeriut për “qytetarët me uniformë” në vendet e rajonit sigurohet kryesisht përmes mekanizmave “civilë” për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në vitin 2010 Mali i Zi miratoi Ligjin për Mbikëqyrjen Parlamentare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Ligji përmban standardet e respektimit të të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët e Malit të Zi dhe sidomos për sa i përket punonjësve në sistemin e mbrojtjes dhe sigurisë⁶. Për më tepër, Institucioni i Ombudsman-it mbron të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve duke përfshirë edhe anëtarët e Forcave të Armatosura. Kjo mbrojtje garantohet nga Kushtetuta e Malit të Zi si edhe përmes zbatimit të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, zbatimit të një sërë konventash të OKB-së dhe atë të instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë. Struktura ushtarake njeh institucionin e Inspektorit të Mbrojtjes i cili, sipas dispozitave kushtetuese, ka për detyrë ndërmjet të tjerash edhe “që askush të mos quhet përgjegjës ose të mos

6. Neni 17 i Ligjit rregullon qartësisht rolin e secilit individ në sistemin e mbrojtjes dhe të sigurisë, duke i lejuar ata që të raportojnë çdo dhunim të mundshëm.

vuajë ndonjë pasojë për shkak të sjelljeve që ka theksuar gjatë ankimit të tij”. Në Maqedoni, Ombudsman-i në të njëjtën mënyrë përfaqëson një mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ombudsman-i është përgjegjës për mbrojtjen e personelit të Forcave të Armatosura dhe ka ndërhyrë në disa raste për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të këtyre forcave. Roli i Ombudsman-it ka qenë veçanërisht i rëndësishëm gjatë konfliktit në Maqedoni ku ai ka marrë pjesë në mënyrë aktive në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personelit të Forcave të Armatosura sipas përcaktimeve të Ligjit për Mbrojtjen, Ligjit për Amnistinë e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë që nuk kanë përfunduar shërbimin ushtarak të detyrueshëm etj.

Në Kroaci, mbrojtja e të drejtave të njeriut shtrihet gjithashtu përgjatë të gjithë sistemit ligjor. Qeveria themeloi Komisionin Qeveritar për të Drejtat e Njeriut i cili ka forcuar më tej sistemin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu ka edhe një institucion të Ombudsman-it i cili pranon ankesa për të drejtat e njeriut. Inspektorati i Mbrojtjes, nga ana tjetër, është një njësi organizative e pavarur e Ministrisë së Mbrojtjes. Ai përbëhet nga një inspektor me detyrë monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Institucioni i Ombudsman-it në Serbi numëron më pak se 1 % të numrit total të ankesave që lidhen me të drejtat e personave me uniformë. Rastet më të shpeshta lidhen me të drejtat ekonomike dhe sociale. Sipas Ombudsman-it të Republikës së Serbisë ekziston frika se ushtarët dhe oficerët do të përballen me pasoja serioze në rast se ata nisin një procedurë ankimi. Një zgjidhje për këto çështje ofrohet në sistemin e trajnimit dhe edukimit ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes së Sllovenisë. Barazia, diversiteti, mosdiskriminimi dhe promovimi i mundësive të barabarta në Forcat e Armatosura të Sllovenisë janë çështje që promovohen gjerësisht në programet arsimore për ushtarakët sllovenë. Gjithashtu, në rastet e dhunimit të të drejtave të njeriut, sistemi ofron konsulencë si edhe veprime zyrtare.

Raportet e Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë dhe rezultatet kryesore

Sipas rekomandimeve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, anëtarët e Forcave të Armatosura janë qytetarë me

uniformë të cilët duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta themelore përfshirë edhe ato që parashikohen nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe nga Karta Sociale Europiane. Kjo do të thotë që ata duhet të gëzojnë të njëjtat standarde mbrojtjeje të të drejtave dhe dinjitetit të tyre si edhe qytetarët e tjerë, duke pasur parasysh edhe kufizimet që iu vendosen për shkak të natyrës specifike të detyrave ushtarake.

Në shtetet demokratike ekzistojnë katër modele për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Forcat e Armatosura (të cilat përfshijnë zyrat e Ombudsman-it, institucionet brenda Ministrisë së Mbrojtjes etj.) por vetëm modeli gjerman, i cili përdoret aktualisht edhe në Bosnjë-Hercegovinë mundëson një qasje unike dhe efikase për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Përveç institucioneve që janë të disponueshme edhe për qytetarët e tjerë dhe punonjësit e MM-së (Ombudsman-i dhe Inspektorati) ky institucion ka më tepër kompetenca dhe efikasitet më të madh në punën e tij siç theksohet edhe më sipër. Për shembull, çdo ushtarak ose kadet në Forcat e Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës ka të drejtë të kontaktojë drejtpërdrejt me Komisionerin për Ushtinë pa ndërmjetësimin e strukturave zyrtare. Gjithashtu KPU-ja mund të kryejë edhe vizita të paralajmëruara ose të paparalajmëruara në çdo ndërtesë dhe objekt ushtarak për të vlerësuar gjendjen e të drejtave të njeriut në terren.

Kjo qasje ka treguar efikasitet dhe produktivitet të lartë përgjatë tre vjetëve të fundit. Gjatë periudhës së ekzistencës së tij, KPU-ja ka publikuar tre raporte vjetore⁷ mbi gjendjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të personelit të Forcave të Armatosura. Ankesat zakonisht përfshijnë shkeljen e të drejtave dhe detyrimeve të anëtarëve të FA-së, menaxhimin e mënyrës së sjelljes, zbatimin e rregulloreve disiplinore, rregulloret që iu referohen orëve të punës, rrogave dhe rimbursimeve, ankesa lidhur me kushtet e jetesës dhe çështje që lidhen me avancimin në karrierë dhe me matjen e performancës. Ndonëse shpesh shumë prej këtyre ankesave nuk kanë të bëjnë domosdoshmërisht me dhunimin e të drejtave të njeriut (por janë deri diku shkelje të legjislacionit të punës) është lehtësisht e mundur që ato të

7. Pa përfshirë raportin e vitit 2009 që mbulon periudhën mes shtatori - fund dhjetori të vitit 2009.

përkeqësohen deri në raste diskriminimi, privimi nga aksesit tek të drejta të ndryshme, dhunim i dinjitetit njerëzor përmes ngacmimeve dhe keqtrajttimeve etj.

Në vitin 2010, 132 ankesa iu dorëzuan institucionit të Komisionerit. Viti 2011 përfshinte 58 ankesa dhe në vitin 2012 numri i ankesave ishte 58⁸. Përqindja e përgjithshme e suksesit për zgjidhjen e çështjeve është pak më pak se 90 %. Shumë prej ankesave individuale në këto raporte nxjerrin në dukje probleme sistematike (për shembull kushtet e këqija të jetesës në disa kazerma) por, megjithatë, siç theksohet nga Komisioneri Parlamentar për Ushtrinë në të gjithë raportet e tij nuk ka dhunim sistematik të të drejtave të njeriut në Forcat e Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës. Duke vepruar bazuar tek ankesat individuale, Komisioneri për Ushtrinë, lëshon rekomandime për rastet kur hetimet kanë arritur në konkluzionin se nuk ka pasur dhunim të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të anëtarëve të Forcave të Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës. Megjithatë, përgjithësisht vlerësohet se situata e respektimit të të drejtave të njeriut në Forcat e Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës është relativisht e mirë⁹.

Dhunimet raportohen si raste individuale, por, megjithatë, vullneti i strukturave menaxhuese të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës për të eliminuar çdo rast moszbatimi të procedurave dhe parregullsitë që vërehen ka qenë gjithashtu inkurajues dhe ka rikonfirmuar se nuk ka pasur dhunim sistematik të të drejtave të njeriut¹⁰.

Konkluzione

Ky studim nxjerr në pah disa nga karakteristikat thelbësore të institucionit të Komisionerit Parlamentar për Ushtrinë në Bosnjë-

8. Duke qenë se institucioni ka filluar punën e tij që në vitin 2009, raporti i atij viti mbulon periudhën mes shtatori - fund dhjetori dhe raportin për 25 ankesa të kryera gjatë kësaj periudhe.

9. Siç theksohet në raportet e KPU-së të viteve 2010, 2011 dhe 2012.

10. Protecting Human Rights and Freedoms of AF Personnel, Regional Conference Publication, BiH PA, INDOC, 2011, p. 20 (speech by BiH Parliamentary Military Commissioner).

Hercegovinë. Duke u bazuar te zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personelit ushtarak në Bosnjë-Hercegovinë, studimi arrin në konkluzionin se Komisioneri për Ushtrinë luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të mbrojtjes së të drejtave të njeriut për stafin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të vendit. Ai plotëson punën e Inspektoratit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Institucionit të Ombudsman-it të Bosnjë-Hercegovinës. Komisioneri luan një rol të rëndësishëm si një institucion i pavarur për të drejtat e njeriut që forcon aksesin te drejtësia dhe te mekanizmat për ndihmë ligjore falas për personelin ushtarak gjatë mbrojtjes së të drejtave të tyre themelore.

Ky institucion, gjithashtu, ka treguar se është mekanizmi më efikas dhe qasja më e mirë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të Forcave të Armatosura. Ai nxit zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe mundëson që të gjithë individët ushtarakë të ndihen të fuqizuar për t'u përballur me çështje sensitive që përbëjnë një shqetësim të gjerë, si për shembull diskriminimi dhe forma të tjera të dhunimit të dinjitetit njerëzor. Niveli i lartë i efikasitetit në zgjidhjen e ankesave të ndryshme nxjerr në pah akoma më shumë kapacitetet e institucionit për të adresuar të drejtat e njeriut në mjedisin ushtarak.

Me Komisionerin Parlamentar për Ushtrinë, sistemi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Bosnjë-Hercegovinë njih mjaftueshëm specifikat e kontekstit ushtarak dhe siguron mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe lirive për qytetarët boshnjakë me uniformë. Gjithashtu ky institucion bën që Bosnjë-Hercegovina të përbëjë një shembull të mirë rajonal praktikash të suksesshme për ruajtjen e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut përgjatë zhvillimeve të kuadrit të sigurisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Bibliografi

OSCE, DCAF, Handbook on Human Rights and Fundamental Freedoms of Armed Forces Personnel, OSCE ODIHR,

- Warsaw, 2009.
- Regional Conference Publication, Protection of Human Rights and Freedoms of Armed Forces Personnel, BiH Parliamentary Assembly, INDOC, Sarajevo, 2011.
- Conference Publication, Proces napredovanja profesionalnih vojnih lica u OS BiH, BiH Parliamentary Assembly, INDOC, Sarajevo, 2012.
- Law on Parliamentary Military Commissioner, BiH Official Gazette Nr. 51 - 2009.
- 2010 Report on the work of the Parliamentary Military Commissioner of Bosnia and Herzegovina, BiH Parliamentary Assembly, Office of the BiH PMC, Sarajevo, 2011.
- 2011 Report on the work of the Parliamentary Military Commissioner of Bosnia and Herzegovina, BiH Parliamentary Assembly, Office of the BiH PMC, Sarajevo, 2012.
- 2012 Report on the work of the Parliamentary Military Commissioner of Bosnia and Herzegovina, BiH Parliamentary Assembly, Office of the BiH PMC, Sarajevo, 2013.
- Intervistë me z. Boško Šiljegović, Komisioneri Parlamentar për Ushtrinë i Bosnjë-Hercegovinës, Sarajevë, 17.05.2013.

Dr. Elona Dhëmbo

PËRKATËSIA GJINORE DHE ÇËSHTJET E SIGURISË

Abstrakt

Gjinia është një komponent kyç për identitetin tonë. Megjithatë, gjinia ndërvepron dhe është e influencuar nga shumë faktorë të tjerë, si klasa, etnia, kombësia, orientimi seksual, mosha etj. Burrat mësohen të jenë “mashkullorë” dhe gratë mësohen të jenë “femërore” në varësi të moshës, klases sociale, origjinës etnike, vendit, kulturës, madje edhe nënkulturës së tyre, si ajo urbane dhe rurale (GTZ, 2005). Këto çojnë drejt tipave e formave të shumta të maskilitetit dhe feminilitetit. Në disa shoqëri, kufiri midis tyre është shumë i mprehtë, në të tjera disi më i mjegullt. Këto dallime (të përmasave të ndryshme) të gjinisë janë të pranishme në të gjitha sferat e jetës, përfshirë edhe sigurinë. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë kanë nevojë, prioritet dhe eksperiencë të ndryshme në lidhje me sigurinë, të cilat përcaktohen si nga gjinia edhe nga seksi i tyre (Valasek, 2007; GTZ, 2005). Për shembull, gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat bëhen pjesë e formave të ndryshme të dhunës. Disa nga llojet e ndryshme të dhunës që përjetojnë burrat dhe gratë e kanë bazën në diferencat e tyre sociale. Prandaj në këtë artikull përmes rishikimit të literaturës relevante argumentohet se gjinia është e rëndësishme për sigurinë tonë dhe kjo e bën gjininë thelbësore për debatin e sigurisë. Është e nevojshme që edhe debatet mbi çështjet e sigurisë në Shqipëri ta shohin me prioritet integrimin e perspektivën gjinore.

* * *

Sigurimi, në vetvete, është një liri relative nga lufta, çiftëzuar me një pritshmëri relative që shkatërrimi nuk do të jetë pasojë e ndonjë lufte që mund të ndodhë (Buzan, 1991, f. 16). Në këtë perspektivë, sigurimi përfshin si mjetet shtrënguese për të verifikuar një agresor, ashtu edhe të gjitha mënyrat e bindjes,

të përkrahura nga perspektiva për përfitime reciproke, për ta shndërruar gjendjen e luftës në bashkëpunim. Kështu pra, sigurimi, në një kuptim objektiv, mat mungesën e rrezikut në vlerat e mësuara, ndërsa në një kuptim subjektiv, mungesën e frikës që vlera të tilla do të sulmohen.

Nga ana tjetër, Reforma e Sektorit të Sigurimit nënkupton transformim të sistemit të sektorit të sigurisë, që përfshin të gjithë aktorët, rolet e tyre, veprimet dhe përgjegjësitë e të punuarit bashkë për ta menaxhuar dhe operuar sistemin në një mënyrë të tillë që të jetë më i pajtueshëm me normat demokratike dhe parimet e qeverisjes së mirë, duke kontribuar kështu në një strukturë mirëfunksionuese të sigurimit.

Reforma në sektorin e sigurisë thekson fortësinë e ndërlidhjeve të institucioneve të sektorit të sigurisë dhe ka dy objektiva kryesore. Së pari, të siguroj kontroll civil dhe demokratik në sektorin e sigurisë, për shembull duke përforcuar menaxhimin dhe kapacitetet mbikëqyrëse të dikastereve qeverisëse, parlamentit dhe organizatave të shoqërisë civile. Së dyti, të zhvillojë një sektor sigurimi efektiv, të gjindshëm dhe efikas, për shembull duke ristrukturuar apo duke ndërtuar kapacitete materiale dhe njerëzore.

Në këtë kuadër zhvillimesh gjinia dhe integrimi i një perspektive gjinore merr një rëndësi absolute jo vetëm si pasojë e përvojave, nevojave, prioriteteve dhe eksperiencave të ndryshme që kanë gratë dhe burrat në lidhje me sigurinë, por edhe në kuadër të përjasjes gjithëpërfshirëse që duhet të karakterizojë reformën në sektorin e sigurisë.

1) Përkatësia gjinore dhe siguria

Aq e thjeshtë sa mund të duket, aq më konfuz mund të bëhemi në përpjekjet tona për të kuptuar gjininë dhe mënyrat se si ajo i jep formë jetëve tona. Jo më shumë se një dekadë më parë, ne filluam të diskutojmë për gjininë në një mënyrë ndryshe nga ajo ç'ka ne ishim mësuar të përdornim në të kaluarën. Të gjithë ata që kanë jetuar dhe studiuar në Shqipëri përpara viteve '90, mund të kujtojnë lehtësisht klasat e gjuhës ku mësuesit kërkonin të përcaktohej "gjinia" e një emri. Megjithatë, po kështu mund të kujtojmë që përpjekja për të dalluar ndërmjet aspekteve biologjike dhe sociale nuk ishte aspak një çështje për diskutim.

Vështrimi i diferencave ndërmjet burrave dhe grave në kohë dhe hapësirë ka vënë në pikëpyetje shumë aspekte të këtij koncepti. Në mënyrë që ne të jemi në gjendje të dallojmë se si diferencat në jetët tona si gra dhe burra përcaktohen nga biologjia ose/dhe nga shoqëria, së pari duhet të përkufizojmë dhe qartësojmë konceptin e gjinisë. Ky artikull merr përsipër të prezantojë lidhjen midis koncepteve të përkatësisë gjinore dhe reformës në sektorin e sigurisë si dhe të paraqesë -bazuar në literaturë dhe eksperiencat e mira - disa nga instrumentet kryesore që lehtësojnë integrimin e perspektivës gjinore në çështjet e sigurisë.

Zakonisht¹ ne lindim me një tipar seksual, që përkufizon diferencat tona biologjike si femra apo meshkuj. Ky është “seksi”. Karakteristikat biologjike që lidhen me të, si hormonet, organet riprodhuese dhe diferencave gjenetike, përdoren gjerësisht për të diferencuar njerëzit në dy grupe të mëdha: femra dhe meshkuj. Shumë shpesh ne pyetemi rreth seksit tonë në forma aplikimesh të ndryshme, ose kur marrim një shërbim, si p.sh. një kontroll mjekësor. Këto të dhëna përdoren shpesh në raportimet rreth sferave të ndryshme të jetës sonë përmes të ashtuquajturave të dhëna të diasgreguara me bazë seksin.

Megjithatë, thjesht duke cilësuar në një formë aplikimi që ju jeni mashkull ose femër, nuk është mjaftueshëm për dikë, i cili do të përshkruajë se sa femërorë dhe mashkullorë dukeni, apo sa veproni e mendoni ju si një femër apo një mashkull. Masa me të cilën ne zhvillohemi nga femër/mashkull në të qenët vajzë/djalë dhe grua/burrë, ndryshe nga seksi që është universal, variojnë në kohë dhe hapësirë (Hoogensen, 2006; Nakamura, 2005; Basow, 1992). Thjesht përpikuni të mendoni se sa të ngjashëm jeni ju me gjyshërit tuaj të së njëjtës gjini, ose sa të ngjashëm jeni ju me dikë të së njëjtës gjini që jeton në një cep tjetër të botës. Pikërisht këto diferenca përfaqësohen nga termi “gjini”.

Ndërsa seksi është biologjik dhe universal, “gjinia” është sociale dhe relative. Gjinia i referohet roleve të ndërtuara nga shoqëria dhe marrëdhënieve ndërmjet burrave dhe grave (Basow, 1992). Më tepër se e përcaktuar biologjikisht, gjinia

1. Shumica e njerëzve janë që nga lindja meshkuj ose femra. Vetëm në raste të rralla njerëzit mund të lindin me të dy organet seksuale. Megjithatë, ato janë raste të veçanta dhe zakonisht vetëm njëri prej organeve seksuale mund të jetë plotësisht funksional.

është mësuar përmes procesit të socializmit. Me fjalë të tjera, burrave dhe grave u mësohen role të caktuara dhe sjellje të përshtatshme në lidhje me seksin e tyre (Valasek, 2007). Ndërsa ne të gjithë lindim me një seks biologjik, shoqëritë dhe kulturat tona na mësojnë dhe na socializojnë bazuar në konceptin e tyre të mashkullit dhe femrës (GTZ, 2005). Për shembull, gratë nuk janë biologjikisht të destinuara për të gatuar. Megjithatë, në shumë kultura gatimi në shtëpi është, së pari, një punë grash. Në të kundërt, nëse shkon në restorant nuk është e vështirë të shikosh se numri i kryekuzhinierëve burra tejkalon atë të grave. Role gjinore si këto nuk janë statike e mund të ndryshojnë me kohën dhe variojnë gjerësisht brenda dhe ndërmjet kulturave.

II) Përse është e rëndësishme gjinia për sigurinë?

Gjinia është një komponent kyç për identitetin tonë. Megjithatë, gjinia ndërvepron dhe është e influencuar nga shumë faktorë të tjerë, si klasa, etnia, kombësia, orientimi seksual, moshë etj. Burrat mësohen të jenë “mashkullorë” dhe gratë mësohen të jenë “femërore” në varësi të moshës, klasës sociale, origjinës etnike, vendit, kulturës, madje edhe nënkulturës së tyre, si ajo urbane dhe rurale etj. (GTZ, 2005). Këto të çojnë drejt tipave e formave të shumta të maskilitetit dhe feminilitetit. Në disa shoqëri, kufiri midis tyre është shumë i mprehtë, në të tjera i mjegullt.

Këto dallime të mprehta (në masë të ndryshme) të gjinisë janë të pranishme në të gjitha sferat e jetës, përfshirë edhe sigurinë. Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë kanë nevojë, prioritetë dhe eksperiencë të ndryshme në lidhje me sigurinë, të cilat përcaktohen si nga gjinia edhe nga seksi i tyre (Valasek, 2007; GTZ, 2005). Për shembull, gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat bëhen pjesë e formave të ndryshme të dhunës. Disa nga llojet e ndryshme të dhunës që përjetojnë burrat dhe gratë e kanë bazën në diferencat e tyre sociale. Për shembull, burrat dhe djemtë janë shpesh viktimë të luftimit me njëri-tjetrin, gratë dhe vajzat janë shpesh viktimë të dhunës në familje ose të trafikimit të qenieve njerëzore madje edhe më gjerë të “dhunës me bazë gjinore” (DHBGJ) (Valasek, 2007; GTZ, 2005). Megjithatë, DHBGJ-ja nuk është vetëm dhunë kundër grave; burrat dhe djemtë mund të jenë gjithashtu viktimë. Për shembull, burrat, djemtë, gratë dhe vajzat mund të jenë të gjithë viktimë të dhunimit ose trafikimit të

qenieve njerëzore. Sikurse përdhunimi është i lidhur me çështje të pushtetit dhe identitetit gjinor, ky është një krim i klasifikuar si DHBGJ. Dhuna kundër gejeve, lesbikeve dhe njerëzve biseksual bazuar në identitetin e tyre gjinor, kuptohet gjithashtu si një formë e DHBGJ-së, pasi ajo bazohet në perceptimin e antikonformitetit me rolet gjinore.

Prandaj, gjinia është e rëndësishme për sigurinë tonë dhe kjo e bën gjininë thelbësore për debatin e sigurisë. Integrimi i çështjes gjinore në procesin e reformës së sigurisë është duke u kthyer në një detyrim, në mënyrë që të adresohen çështjet e përmendura më sipër. Deri tani sektori i sigurisë ka ndjekur një qasje të verbër gjinore ku burrat përshkruhen shpesh si ushtarë, autorë të krimit dhe më afër luftës, ndërsa gratë si viktimat dhe më afër paqes (Nakamura, 2005). Megjithatë, kërkuesit në fushën e përkatësisë gjinore kanë identifikuar dinamikat gjinore edhe në sferën e sigurisë. Dominimi i të menduari tradicional mbi sigurinë të bazuar në shtet, është një manifestim i maskilitetit, strukturave patriarkale, që kërkojnë që siguria të përkufizohet vetëm nga ky pozicion i privilegjuar (Hoogensen, 2006).

Megjithatë, duhet të jemi të kujdesshëm se si e kuptojmë gjininë. Përkatësia gjinore e kuptuar thjesht si “për gra”, përgjithësisht nënkupton se një njeri përpiket të përfshijë gratë në proces, të marrë “input”-et e tyre, të ballafaqohet me nevojat e grave dhe të mbrojë gratë (Hoogensen, 2006). Perspektiva gjinore e sigurisë e kuptuar si “gra dhe burra” ka shumë të përbashkëta me sigurinë njerëzore. Ato flasin për një kuptim më të gjerë të sigurisë, nga pozicioni individual ose i grupit, duke ngritur zërin për nevojën e një agjende më të gjerë të sigurisë. Përkatësia gjinore flet gjithashtu për “sigurinë shoqërore”² (ajo përfshihet si në sigurinë njerëzore po ashtu edhe si një perspektivë e sigurisë më vete).

Studimet gjinore të sigurisë janë zhvilluar ndjeshëm gjatë dekadës së kaluar, duke vënë në dukje se siguria për njerin nuk

2. ISO - International Organisation for Standardization Technical Committee ISO/TC 223 - siguria shoqërore integron një sërë disiplinash të ndërlidhura, përfshirë mbrojtjen e asketeve (humane, fizike, mjedisore, financiare dhe të paprekshme) sigurinë, menaxhimin e riskut, gatishmërinë, menaxhimin e krizave, menaxhimin e vazhdueshëm të biznesit, menaxhimin e rimëkëmbjes dhe të katastrofave (<http://www.asisonline.org/guidelines/Societal-Security-Management-System-Standards.pdf>).

është domosdoshmërisht e tillë edhe për tjetrin. Konteksti dhe njohja e marrëdhënieve të pushtetit (dominante/jodominante) bën të dukshme - pa siguritë që zakonisht nuk vihen re në një kontekst të sigurisë të bazuar te shteti. Konteksti dhe marrëdhëniet e pushtetit informojnë sigurinë njerëzore, duke i lejuar zërat e mëparshëm të padëgjuar të dëgjohen. Kërkimet gjinore të sigurisë kanë filluar vetëm tani të lejohen e të bëhen pjesë e rrymës qendrore të diskutimeve mbi sigurinë, megjithëse përbëjnë ende një përjashtim dhe nevojitet akoma shumë për t'u bërë.

Në këtë përpjekje që duhet bërë, është e një rëndësie të veçantë përfshirja e grave. Organizatat e grave të shoqërisë civile dhe organizatat që punojnë në çështjet gjinore, janë aktorë kyç të sigurisë lokale, pjesëmarrja e të cilave mund të ndihmojë të sigurojë pjesëmarrjen e grave dhe madje edhe një zotërim në nivel lokal të reformës (Valasek, 2005). Ka një sërë organizatash të shtrira nëpër botë, që punojnë në bazë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Organizatat e grave mund të jenë ofrues të sigurisë, për shembull, duke mundësuar strehë dhe mbështetje për gra apo burra - viktimat të torturës, dhunës në familje apo asaj seksuale. Puna e drejtpërdrejtë me komunitetet lokale nënkupton që organizatat e grave shpesh kanë akses në informacionin e detajuar në lidhje me nevojat e sigurisë të individëve dhe komuniteteve, sidomos grupeve të marginalizuara. Kështu që, organizatat e grave mund të shërbejnë si ura kyçe ndërmjet komuniteteve lokale dhe politikëbërësve të sigurisë, duke forcuar edhe pronësinë lokale ndaj reformës. Ato shpesh kanë edhe ekspertizën e nevojshme për disenjimin dhe implementimin e programeve që lidhen me sigurinë në nivelin komunitar, si për shembull në parandalimin e dhunës së bandave ose trafikimit njerëzor, apo edhe aftësi për të dhënë trajnime mbi çështje të përkatësisë gjinore apo dhe të drejtave të njeriut (Valasek, 2005).

III) Si mund të integrohet çështja e gjinisë brenda sektorit të reformës së sigurisë?

Në këtë pjesë të kësaj eseje, theksi do t'i vihet qasjes se si përqasja gjinore dhe çështjet e sigurisë ndërlidhen në kompleksitetin e realitetit shqiptar, dhe disa masa sugjeruese se si mund të funksionojë skenari më i mirë.

Kur përfundoi Lufta e Ftohtë, zhvillimet gjeopolitike dhe gjeoeconomike sollën rreziqe dhe kërcënime të reja rreth interesave dhe sigurisë të Republikës së Shqipërisë. Rreziqet dhe kërcënimet e sotme karakterizohen nga vështirësi me natyra të ndryshme të parashikuara. Përveç vështirësive të përcaktimit të një ndarje të qartë, ata mund të klasifikohen në rreziqe dhe kërcënime të një natyre të brendshme ndërshtetërore dhe globale.

Situata rajonale dhe ndërkombëtare në fillim të mijëvjeçarit ka sjellë elementë të rinj në mjedisin strategjik ndërkombëtar të sigurisë. Këto rezultate kanë ndikuar në ndryshimin e politikave dhe sfondit të konceptit të sigurisë në mendësinë e Shqipërisë.

Trafikimi i qenieve njerëzore, armët dhe drogat, organizatat kriminale, krimi i organizuar, terrorizmi dhe shpërndarja e armëve të shkatërrimit në masë, po shfaqen si fenomene ndërshtetërore dhe sfida që mund të prekin në mënyrë të konsiderueshme sigurinë, paqen dhe stabilitetin e të gjitha vendeve. Këto aktivitete të jashtëligjshme kanë zgjeruar edhe më tepër sferën e tyre të aktivitetit, duke tejkaluar dimensionin e kufijve kombëtarë.

Ekzistenca e rritjes së rreziqeve nga këto fenomene e ka bërë të domosdoshme një qasje gjithëpërfshirëse të të gjitha politikave të sigurisë dhe të stabilitetit, duke marrë në konsideratë të gjitha kategoritë e aspekteve politike, ushtarake, ekonomike, njerëzore, sociale, mjedisore dhe gjinore.

Kompleksiteti dhe karakteri ndërshtetëror i këtyre fenomeneve thekson rëndësinë e një veprimi kolektiv dhe domosdoshmërinë e themelimit të masave reciproke të besimit. Në këtë pjesë të këtij dokumenti, rëndësi do t'i jepet një qasjeje se si gjinia dhe siguria lidhen në kompleksitetin e realitetit të Shqipërisë dhe disa mjeteve të tjera sugjeruese se si kjo mund të funksiononte në një skenar efektiv.

Zhvillimi i sigurisë së një vendi ka në bazë të rëndësisë së saj interesin kombëtar. Ky interes është vendimtar në formimin e përgjegjësisë, legjitimitetit dhe besueshmërisë të pushteti politik. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet funksionimi i një shteti demokratik. Si rrjedhojë, kjo është detyra sublimë e pushtetit politik: të përkufizojë, mbrojë dhe zhvillojë interesat kombëtare. Kjo detyrë duhet të shoqërohet nga kërkesa dhe siguri i një konsensusi më të gjerë ndërmjet debatit publik. Jo të gjitha interesat kombëtare mund të jenë interesa të heshtur ose të

gjithë interesa në shërbim. Prandaj, unanimiteti për përkufizimin dhe realizimin e interesave nuk është një domosdoshmëri, por pranimi dhe konsensusi janë rregulla për t'u aplikuar rrjedhimisht në një sistem demokratik. Zëri i grave dhe ekuilibri gjinor në hartimin e vendimeve dhe vendimmarrje janë me një natyrë kyçe në këtë strukturë.

Interesi kombëtar jetësor që garanton: ushtrimin e sovranitetit, mbrojtjes së pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit, mbrojtjes së rendit kushtetues; mbrojtjes së jetëve të qytetarëve dhe të detyrave dhe të drejtave njerëzore, zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së zotërimeve dhe vlerave në vitet 2000, formojnë esencën e sigurisë së Republikës së Shqipërisë. Interesat kombëtare dhe kufiri i realizimit të tyre janë lidhur që në thelb me sigurinë.

Disa nga hapa konkrete se si çështjet gjinore mund të shkrihen në sektorin e sigurisë dhe reformave të tij.

- *Politika e sigurisë kombëtare dhe pjesë të tjera të legjislacionit mbi sigurinë*

Përpjekje dhe veprime në përfshirjen dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së grave përmes ndërveprimit të tyre në pëlqimin e miratimit dhe zbatimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (ies) të Republikës së Shqipërisë; Ligji mbi Barazinë Gjinore dhe prezencën e 30 % dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në lidhje me sigurinë mund të jenë shkëndija e parë e dritës në integrimin e gjinisë në një nivel politik mbi çështjet e sigurisë.

- *Vlerësimet e ndikimit të gjinisë në politikat e sigurisë*

Vlerësimet mund të drejtohen nga aktorë mbikëqyrës, si parlamentarët dhe organizatorët e shoqërisë civile, të përcaktojnë se si siguria do të prekë veçanërisht burrat, gratë, vajzat dhe djemtë. Në të njëjtën kohë vlerësimet mund të nxirren nga politikat e propozuara ose ato ekzistuese. Megjithatë, ato janë më të suksesshme kur nxirren në një fazë më të hershme në mënyrë që politika mund të ndryshohet ose ridrejtohet. Në mënyrë të përmbledhur ato mund të perceptohen më mirë kur çështjet gjinore të prioritetizohen mjaftueshëm në rekrutime, logjistikë dhe trajnime.

- *Transformimi i Shqipërisë nga një konsumator në një vend që kontribuon në siguri*

Shqipëria është një vend partner i NATO-s, e përfshirë në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me BE-në, po ashtu brenda

një numri të konsiderueshëm iniciativash rajonale të cilat i japin një dimension tjetër konceptit të sigurisë kombëtare. Niveli i sigurisë së vendit është pashmangshmërisht i lidhur me programe të përmbushura me sukses dhe standardeve të Partneritetit për Paqe dhe Gjithashtu të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Një qasje tjetër që kujdeset për nivelin e sigurisë është pjesëmarrja aktive dhe kontributi në iniciativat për forcimin e besimit politik dhe ushtarak në rajon.

• *Dialogu, bashkëpunimi dhe mjetet paqësore për të zgjidhur debatin*

Disa nga prioritetet e rajonit tonë dhe politikat e çështjeve të brendshme janë respektimi i të drejtave të njeriut në territorin e Shqipërisë, pavarësisht origjinës politike, fetare, rajonale, raciale, etnike, kulturore ose sociale, gjithashtu mbrojtja me mjete institucionale të të drejtave të njeriut të Shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gjithashtu duke përfshirë qytetarët e Shqipërisë që jetojnë përkohësisht ose në mënyrë të përhershme jashtë vendit. Strategjia mbështet ndryshimet e ndjeshme në ekuilibrin e sigurisë në favor të mjeteve politike të institucioneve të sigurisë dhe diplomacisë dhe dimensionit dhe dinjitetit njerëzor në një sistem demokratik. Deri këtu, një këndvështrim tepër gjithëpërfshirës duhet t'i jepet dinamikës gjinore, duke marrë në konsideratë perspektivën që dinamika të tilla u jepen shoqërive të modernizuara.

• *Konsolidimi i shoqërisë demokratike dhe vëzhgimi i të drejtave të njeriut*

Stabiliteti i brendshëm i vendit është një produkt i shtetit ligjor të mbrojtë qytetarët e tij, shoqërinë civile dhe formën shtetërore të veprimeve antiligjore. Është e rëndësishme të perceptohet që qytetarët kanë të drejtat e tyre gjithashtu në një perspektivë gjinore. Forcimi i institucioneve të shtetit është garancia për zhvillimin e shoqërisë demokratike. Një shoqëri që ka standarde të larta të respektimit të të drejtave njerëzore përbën një garanci për një mjedis të sigurt dhe marrëdhënie harmonizuese ndërmjet shoqërisë dhe individit. Gratë marrin përparësitë e tyre në çuarjen përpara të këtyre standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut dhe parimeve të barazisë. Kështu që koncepti i sigurisë nuk bëhet më vetëm i gjerë, por gjithashtu shumë dimensional. Individit, shoqëria dhe shteti kanë detyrime të përbashkëta rreth sigurisë së vendit. Duke e parë nga një perspektivë e barazisë, të gjithë aktorët duhen

ftuar dhe pritët të vendosin barazinë për përfitime të përbashkëta të sigurisë kombëtare. Dhunimi i këtyre detyrimeve, madje edhe nga njëra anë, dëmton rëndë sigurinë. Roli aktiv i organizatave joqeveritare kontribuon në konsolidimin e standardeve demokratike në shoqëri, prandaj këto organizata joqeveritare që mbrojnë parimet gjinore, të përkushtuara në respektimin e të drejtave të njeriut në sfera të përgjithshme janë të një rëndësie jetësore për të përfshirë perspektivën gjinore në agjendën e sigurisë.

IV) Instrumentet e sigurisë

Këto duhet të shihen si aftësia për të mbrojtur interesin kombëtar dhe si një përgjegjësi për të vepruar në çdo situatë. Institucionet konsiderohen si faktorë vendimtarë në suksesin e demokracisë dhe ekonomisë së tregut të lirë në një Shqipëri të zhvilluar. Ato duhet të ndërtohen dhe të funksionojnë mbi parimet e paanshmërisë dhe në të cilat njerëzit nuk shihen vetëm si një prioritet, por gjithashtu të autorizuar në një mënyrë fleksibël. Në mënyrë të përmbledhur masat duhen marrë dhe/ose rriten në themelimin e politikave të burimeve njerëzore dhe praktikave që janë një përgjigje e mirë nga pikëpamja e përgjegjshmërisë gjinore dhe të prira drejt konceptit familjar në përgjithësi.

Duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e përmendura më lart të prekura në mënyrë sipërfaqësore mbi këtë pjesë të kësaj eseje, këtu më poshtë mund të listojmë në vend të konkluzioneve disa rekomandime që mund të jenë me rëndësi në kornizën e Integritimit Gjinor në Çështjet e Reformave të Sigurisë.

- Ngritja e ndërhyrjeve lokale përmes përfshirjes së plotë të organizatave të shoqërisë civile, përfshirë organizatat lokale dhe kombëtare të grave, në vlerësimin, hartimin, zbatimin dhe monitorimin/vlerësimin e politikave dhe programeve të Reformës së Sektorit të Sigurisë.

- Rishikimin dhe modifikimin e legjisllacionit ekzistues të lidhur me sigurinë, politikat dhe protokollet për të siguruar që ato të mos jenë diskriminuese, dhe të marrin parasysh nevojat specifike të sigurisë së grave, burrave, djemve dhe vajzave.

- Zbatimi i politikave, mekanizmave specifike dhe programimit për të parandaluar, adresuar dhe sanksionuar dhunën me bazë gjinore kundër grave, vajzave, burrave si pjesë e Reformës së Sektorit të Sigurisë.

- Ngritja e kodeve të sjelljes dhe politikave të tjera të brendshme dhe mekanizmave që detyrojnë zero tolerancë të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë edhe ngacmimet seksuale në radhët e personelit të sektorit të sigurisë.

- Ngritja e plan-strategjive dhe iniciativave specifike për të rritur rekrutimet, mbajtjen dhe avancimin e grave dhe grupeve të tjera të nënpërfaqësuar në institucionet e sektorit të sigurisë.

- Përfshirja e trajnimeve specifike gjinore si pjesë e thelbit të kurrikulës së trajnimit të personelit të sektorit të sigurisë në të gjitha nivelet. Ndërturja e çështjeve gjinore në kualifikimet e personelit të sektorit të sigurisë.

- Forcimi i proceseve të Reformës së Sektorit të Sigurisë dhe sigurimi që aktorët mbikëqyrës të sektorit të sigurisë janë të orientuar nga përkatësia gjinore dhe bashkëpunues me organizatat e grave të shoqërisë civile.

- Ndërtimi i kapaciteteve dhe kujdesit gjinor të personelit të përfshirë në Reformën e Sektorit të Sigurisë përmes trajnimit për përkatësinë gjinore, punimi me ekspertë gjinorë dhe përfshirja e reagimit ndaj përkatësisë gjinore në termat e referencave për pozicione si dhe për vlerësimet e personelit (Valasek, 2007).

Bibliografia

Basow, S. A. (1992); Gender: Stereotypes and roles (3rd ed.); Pacific Grove, CA: Brooks/Cole.

Bastick, M., Grimm, K. and Kunz. R., (2007), Sexual Violence in Armed Conflict: Global Overview and Implications for the Security Sector Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces: Geneva.

Funk, A., Lang, J. L. and Osterhaus, J., (2005) Ending Violence Against Women and Girls - Protecting Human Rights: Good Practices for Development Cooperation, GTZ: Eschbor, f. 47-48.

GTZ (2005), Gender and Citizen Security: Regional Training Module (Basic Text, Methodological Guide, Support Materials); in english and spanish, <http://www.gtzgenero.org.ni/publicaciones.php?idorigen=1>

Hänggi, H., (2003), "Making Sense of Security Sector Governance", Challenges of Security Sector Governance,

- eds. Hänggi, H. and Winkler, T. H. (DCAF: Geneva).
- Hoogensen, G. (2006), Gender and Security, Department of Political Science University of Tromsø, Tromsø, Norway Research Associate, GECHS.
- Nathan, L., (2007), No Ownership, No Commitment: A Guide to Local Ownership of Security Sector Reform, University of Birmingham: Birmingham.
- Nakamura, F. (2005), Gender, Security & Development, Monterey Institute of International Studies, Prepared for IP 653.
- Valasek, K., "Security Sector Reform and Gender" - Gender and SSR Toolkit, DCAF.
- Vlachová, M. and BIASON, L. (2005), Women in an Insecure World: Violence against Women, Facts, Figures and Analysis, Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces: Geneva.
- Strategjia Kombëtare për Sigurinë e Republikës së Shqipërisë - 2003.
- Wetterskog, L. (2007), "Too much 'moralizing' before deployment", Good and Bad Examples: lessons learned from Working with United Nations Resolution 1325 in international missions, (Uppsala: Genderforce).

Bedrudin Brljavac

DISKRIMINIMI INSTITUCIONAL NDAJ GRUPEVE MINORITARE NË BOSNJË-HERCEGOVINË: PENGESË PËR ANËTARËSIMIN NË BE

Abstrakt

Edhe pse prej më se dhjetë vjetësh Bosnjë-Hercegovina është përfshirë në një proces reformash intensive lidhur me Bashkimin European, vendi përballet ende me një deficit demokratik serioz. Veçanërisht skena publike e post-Dejtonit është dominuar prej elitave politike etnonacionaliste të cilat po bëjnë gjithçka për të përjashtuar jonacionalistët dhe anëtarët e grupeve minoritare nga procesi i vendimmarrjes. Ky fakt përbën qartësisht një paradoks duke qenë se një prej objektivave të integritetit të vendeve europiane në Komunitetin European ka qenë reduktimi i ndikimeve shpërbërëse dhe të rrezikshëm të nacionalistëve dhe themelimi i një komuniteti me prosperitet, paqësor dhe të sigurt. Në këtë artikull do të analizojmë procesin e etnonacionalizimit të periudhës post-Dejton që ka rezultuar në një diskriminim të gjerë kundrejt të ashtuquajturve “të tjerë”, siç përcaktohen prej Kushtetutës. Në Bosnjën e pasluftës pjesëmarrja demokratike është zhvilluar si konkurrencë ndërmjet tri komuniteteve etnike, boshnjakëve, serbëve dhe kroatëve, në vend që të jetë një garë individësh të barabartë të cilët gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën e votës. Për këtë arsye, popullsia e Bosnjës ende po jeton nën një sistem politik i cili përngjan më së shumti me një etnodemokraci sesa me një regjim demokratik. Duke pasur një regjim të tillë diskriminues, Bosnjë-Hercegovina nuk mund të anëtarësohet në Bashkimin European, e cila përbën modelin e një shoqërie të hapur dhe një model shoqërie të hapur dhe demokratike.

Fjalë kyçe:

Demokracia, Marrëveshja e Dejtonit, Bashkimi European, grupet minoritare, qytetarët, etnonacionalizmi, të drejtat e grupeve, të drejtat individuale.

Demokracia pa grupet e minoriteteve dhe jonacionalistët

Në vijim të përhapjes së gjerë të proceseve të demokratizimit në Europën Qendrore dhe Lindore, në nëntor të vitit 1990 në Bosnjë-Hercegovinë (më poshtë referuar si Bosnja ose si BiH-ja) u zhvilluan zgjedhjet e para pluraliste. Këto zgjedhje ishin ndër treguesit e parë që shënuan tranzicionin e vendit nga regjimi komunist drejt demokracisë liberale. Megjithatë partitë politike në vend u lejuan të organizoheshin sipas ndarjeve etnike duke bërë që partitë nacionaliste së bashku të grumbullonin 84% të votave (Arnautović, 2007: 7). Pra, organizimi i zgjedhjeve të para demokratike në vend shënoi fillimin e hegjemonisë politike të partive politike nacionaliste duke qenë se shumica e elektoratit votoi për to. Kështu boshnjakët votuan për Partinë e Veprimit Demokratik (PVD), serbët e Bosnjës votuan për Partinë Demokratike Serbe (PDS dhe kroatët për Unionin Demokratik Kroat (UDK) (Freedom House, 2010: 122). Për ta ilustruar më qartë këtë, edhe shpërndarja e pushtetit pas zgjedhjeve u bazua te principet etnike dhe kësisoj Presidenti i Republikës së Bosnjë-Hercegovinës ishte boshnjak, kryetari i Parlamentit ishte serb, ndërsa kryeministri ishte përfaqësues kroat. Për më tepër, lufta që shpërtheu në vitin 1992 shtoi edhe më tej urrejtjen dhe intolerancën etnike duke e bërë solidaritetin etnik dhe mbi baza etniciteti një ndasi dominuese sociale dhe politike.

Kësisoj, konflikti ndërmjet tre grupimeve etnike shtoi polarizimin ndëretnik dhe forcoi masivisht mbizotërimin politik të partive etnonacionaliste në proceset vendimmarrëse. Gjithashtu, Marrëveshja e Paqes së Dejtonit (MPD) firmosur në vitin 1995 solli përfundimin e luftës që krijoi një proces politik të ngatërruar i cili ka rezultuar shpesh në ngërçe, por edhe ka lënë të pazgjidhura konfliktet që kulmuan me luftën e viteve 1992-1995 duke rrënjësuar principin etnonacionalist në themelet e diskursit politik (Vogel,

2006: 2). Ndërsa MPD-ja përfundoi luftën dhe vendosi themelet për konsolidimin e paqes, shumë analistë besojnë se marrëveshja si dokument reflekton rrethanat e kohës së luftës dhe prandaj nuk mund të sigurojë e vetme të ardhmen e BiH-së si një shtet funksional dhe demokratik (Ashdown, 2005). Pra, hapësira politike dhe shoqërore e pasluftës ka qenë gjerësisht e dominuar nga tre grupe etnike, gjë që ka çuar drejt marginalizimit institucional të grupeve minoritarë dhe anëtarëve të tyre. Në Bosnjën e post-Dejtonit shumica e qytetarëve janë në një pozicion homoduplex ose njerëzish të dyzuar në përpjekjen e tyre për të qenë njerëz të mirë apo besnikë ndaj etnive. Ndërkohë që tranzicioni drejt demokracisë duhet të sjellë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e grupeve të ndryshme etnike në politikbërjen publike, në Bosnjën e pasluftës sfera publike është mbizotëruar prej një matrice etnopolitike duke shkaktuar diskriminim kundrejt grupeve minoritarë.

Për më tepër, një sistem politik diskriminues si ky në fjalë është qartësisht në kundërshtim me përpjekjet e vendit për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian në të ardhmen e afërt. Në fakt, në fund të viteve 1990 përmes Procesit të ri të Stabilizim Asocimit (PSA), Bashkimi Europian synonte të inkurajonte shtetet e rajonit (përfshirë edhe BiH-në) në rrugën drejt integritetit në strukturat ekonomike dhe politike të Bllokut (Becker, 2008: 20). Gjithashtu, në qershor të vitit 2000 Samiti i Këshillit Europian i Fieras vendosi që vendet pjesë e PSA-së (ku përfshihet edhe Bosnja) janë kandidatë potencialë për anëtarësim në BE. Në vijim të procesit të vështirë të reformave, Bosnjë Hercegovina firmosi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me BE-në në qershor të vitit 2008 çka përbënte mjetin e parë të paraaderimit për këtë vend të Ballkanit në rrugën drejt anëtarësimit eventual në BE. Pra, për BiH dhe për të gjithë Ballkanin Perëndimor, procesi i reformave që lidhet me BE-në do të thotë përafrimi me modelet perëndimorë të avancuar si edhe siguri dhe prosperitet për të ardhmen (Anastasakis, 2005: 80). Me fjalë të tjera, i ashtuquajturi proces evropianizimi, i cili ka ndikuar në politikbërjen politike, sociale, ekonomike dhe administrative në vend.

Kubicek (2005, 374) argumenton se procesi i evropianizimit jo vetëm garanton mundësi të reja për forcat shoqërore që kanë qenë më parë të përjashtuara nga politikbërja, por gjithashtu

kontribuon për transformimin e elementëve të tjerë strukturorë si ideologjia politike (politikat e identitetit), kuadri ligjor dhe sistemi partiak dhe nxit ndryshime tek të gjithë këta elementë duke rezultuar në reforma të brendshme. Gjithashtu Lardrech (1994) përmend fuqitë transformuese të procesit të europianizimit si ndikues të shtetësisë dhe identiteti kombëtar. Megjithatë, mbetet shumë e debatueshme se deri në ç'nivel procesi i europianizimit në Bosnjë ka ndikuar idenë e shtetësisë duke qenë se grupet minoritare dhe anëtarët jonacionalë marginalizohen gjerësisht si në nivelin shtetëror ashtu edhe në atë shoqëror.

Edhe pse ka pasur një sërë problemesh të vështira të cilët kanë ngadalësuar procesin e reformave që lidhen me BE-në në Bosnjë, përhapja e gjerë e polarizimit etnik dhe mbizotërimi mbi sferën publike i etnicitetit përbëjnë sfidat më të mëdha në rrugën e vendit drejt Brukselit. Kjo do të thotë se marrëveshjet etnopolitike aktuale në Bosnjë kanë kufizuar të kuptuarit e identitetit individual të qytetarëve i cili duhej të ishte pjesë thelbësore e procesit të europianizimit. Bosnja e pasluftës ka qenë më afër procesit të "ballkanizimit" i cili perceptohet si e kundërta e vlerave dhe normave "perëndimore" (Todorova, 1994).

Teoria e Njohjes së Shtetasit e Jurgen Habermas

Një nga objektivat kryesorë për themelimin e Komunitetit European (më vonë Bashkimi European), ka qenë reduktimi i ndikimeve shpërbërës dhe të rrezikshme të nacionalistëve nëpërmjet integritetit të vendeve europiane në një komunitet paqësor, me prosperitet dhe të sigurt. Kjo do të thotë se kuadri institucional i BE-së ka inkurajuar bashkekzistencën në harmoni dhe paqe ndërmjet grupeve të ndryshëm kombëtare, linguistike, fetare, seksuale dhe racore (Zofia Wilk-Woœ, 2010: 79). Veçanërisht në fillimin e viteve 1990, përpara zgjerimit me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, BE-ja ka intensifikuar aktivitetet e saj në fushën e mbrojtjes së minoriteteve. Në qershor të vitit 1993 Samiti i Këshillit European i Kopenhagës ra dakord për vendosjen e të ashtuquajturave kritere të Kopenhagës ku mes të tjerash theksohej edhe mbrojtja e grupeve minoritare. Kjo do të thotë se kriteri politik i Kopenhagës kërkon që vendet kandidatë të arrijnë "stabilitetin e institucioneve duke garantuar

demokracinë, të drejtat e njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve” . (Harryvan dhe Van der Harst, 1997: 285). Përveç kësaj, vendet që aspirojnë anëtarësim duhet të kenë zbatuar reformat përkatëse dhe të kenë miratuar legjislacionin e nevojshëm që garanton një mbrojtje efektive të grupeve minoritare.

Pra, Kriterii i Kopenhagës ka kontribuar në mënyrë domethënëse për zgjerimin e të drejtave të njeriut pasi ai ka vendosur parimin se “personat që iu përkasin minoriteteve kombëtare mund të ushtrojnë dhe gëzojnë të drejtat e tyre si individë si edhe në komunitet me anëtarët e tjerë të grupit të tyre” (OSCE, 1990). Gjithashtu, Neni 12 i Traktatit të Komunitetit Europian (TKE) ndalon diskriminimin bazuar tek identiteti kombëtar. Pas Traktatit të Amsterdimit, Neni 13 i TKE-së ndalon aktet diskriminuese bazuar në tetë arsytet e mëposhtme: seksi, raca ose përkatësia etnike, feja ose besimi, paafësia, mosha dhe orientimi seksual. Për më tepër, Traktati i Lisbonës njeh ligjërisht grupet minoritare në tekstin e legjislacionit parësor të BE-së (FRA, 2010, 46). Në Nenin 1/a të këtij traktati theksohet se të drejtat e personave që iu përkasin grupeve minoritare janë bërë vlerat dhe principet thelbësorë që mbron BE-ja. Gjithashtu, Karta e të Drejtave të Njeriut e BE-së hap rrugën drejt principit të mosdiskriminimit dhe inkurajon vendet anëtare që të mbrojnë diversitetin kulturor, linguistik dhe fetar (Vouters, 2001). Të gjitha këto e kanë sjellë BE-në më afër idealit të saj vizionar të “bashkimit në diversitet”.

Nga ana tjetër, jeta bashkëkohore publike në Bosnjë është karakterizuar prej një modus vivendi të fortë politik, i cili bazohet në dhunimin ekstrem të të drejtave themelore të njeriut duke marginalizuar si qytetarët që nuk janë dakord me politikat nacionaliste ashtu edhe anëtarët e grupeve minoritare. Pra, modeli politik i post-Dejtonit përqendrohet te niveli dhe natyra e pjesëmarrjes politike të qytetarëve që iu përkasin tre kombësive më të mëdha në vend. Për të kuptuar thellësisht dhe për të analizuar siç duhet procesin e pjesëmarrjes politike të qytetarëve në vend, nocioni i njohjes së shtetasit i Jurgen Habermansit mundëson një kuadër të përshtatshëm teorik si bazë për debat konstruktiv. Për shembull, Habermans analizon rastet kur identitetit kombëtar ose kulturor i qytetarëve pengon pjesëmarrjen

e tyre politike në sferën publike, sepse pjesa tjetër e shoqërisë iu mohon atyre të drejtat themelore të njeriut. Sipas Habermansit, në skenat publike që karakterizohen nga dhunime serioze të të drejtave të njeriut nga qytetarët e tjerë, ekziston “një përfshirje e paplotë ose e pabarabartë e qytetarëve të cilëve ju mohohet statusi i plotë si anëtarë të komunitetit politik” (2005: 16). Me pak fjalë, Habermans mbështet mendimin se demokracia është e mundur vetëm kur ekziston një përhapje e gjerë e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse brenda një shoqërie të caktuar.

Pra, Habermans ka mbrojtur fort principet demokratike, si: sovraniteti popullor, shteti ligjor, garantimi i të drejtave kushtetuese dhe atyre qytetare si komponentë të pazëvendësueshëm të një regjimi demokratik dhe të hapur. Kësisoj, Habermans argumenton se kushtetutat janë bazat për krijimin e një shoqërie paqësore dhe demokratike në kontekstet heterogjene. Këtu ai thekson gjithashtu se principet kushtetuese që bazohen te shteti ligjor bashkojnë dhe integrojnë qytetarët e një shoqërie që karakterizohet nga shumëllojshmëri vlerash dhe idesh sociale, kulturore, kombëtare dhe filozofike (2003). Kjo do të thotë se kushtetuta gjithëpërfshirëse përbën bazën për rendin demokratik në çdo shoqëri të lirë dhe të hapur. Siç thekson O'Neill: “Asnjë qytetar ose grup qytetarësh nuk duhet përjashtuar nga një proces demokratik legjitimimi. Interesat dhe nevojat përkatëse, vlerat dhe aspiratat, bindjet dhe konceptimet e identitetit duhet të faktorizohen në njëfarë mënyre në procedurat ekzistuese për bërjen e ligjeve” (2000: 1). Pra, shoqëritë që e perceptojnë vetveten si demokratike nuk mund të themelojnë rendet e tyre politikë mbi principe kushtetues përjashtues dhe diskriminues dhe as bazuar te mendësitë shoqërore marginalizuese.

Hegjemonia e elitave etnonacionaliste

Më se pesëmbëdhjetë vjet pas firmosjes së Marrëveshjes së Dejtonit, tensionet politike janë ende të kudogjendura në shoqërinë boshnjake dhe udhëheqësit kombëtarë po sfidojnë gjithnjë e më hapur dhe më me forcë se kurrë më parë Marrëveshjen e Pagues. Kjo do të thotë se në Bosnjën e post-Dejtonit qasja ekskluzivisht etnonacionaliste ndaj politikës ka

fituar përparësi mbi pajtimin dhe konsensusin (Bianchini, 2000: 79). Pra, BiH është mjaft larg të qenët një shtet funksional dhe demokratik sipas synimeve të marrëveshjes. Sot vendi përbëhet ende de facto nga tre territore monoetnike, tre sisteme arsimore dhe një qeveri kombëtare ku etniciteti është rregulli kryesor i funksionimit. Në fakt, e gjithë struktura shtetërore ndërtohet sipas një modeli tërësisht etnonacionalist. Prandaj, të tria grupet kryesore etnike dominojnë diskursin publik në çdo aspekt të jetës duke përjashtuar minoritetet dhe jonacionalistët. Shembulli më i mirë është presidenca me rotacion e Bosnjës, e cila përbëhet nga tre anëtarë: një boshnjak, një kroat dhe një serb, secili prej tyre zgjidhet drejtpërdrejt nga etnia përkatëse. Kjo do të thotë që kushtetuta boshnjake trajton anëtarët joetnikë të komunitetit të saj si qytetarë të huaj ose të dorës së dytë. Për më tepër, nën një regjim të tillë politik është e turpshme dhe ndonjëherë edhe e rrezikshme që të deklarohesh si jonacionalist ose si anëtar i grupeve minoritare.

Në fakt, siç theksohet edhe në Marrëveshjen e Dejtonit, Kushtetuta e BiH-së parandalon kandidimin e “të tjerëve”, të cilët janë grupe minoritetesh, në presidencë dhe në Shtëpinë e Popullit (Parlamenti) bazuar në origjinën e tyre etnike sepse këto pozicione garantohen për të ashtuquajturat “popullsi përbërëse” (domethënë për boshnjakët, serbët dhe kroatët). Pra, grupet etnike përfaqësohen si komunitete në nivele të ndryshme të ndarjes së pushtetit duke institucionalizuar nacionalizmin etnik si objektiv kryesor politik. Hegjemonia e etnopolitikanëve është mundësuar nga ideja e vagullt dhe manipulative e “popullsive përbërëse”. Si rrjedhojë, grupet e minoriteteve dhe anëtarët joetnikë të shoqërisë boshnjake janë tërësisht të përjashtuar nga modeli aktual i ndarjes së pushtetit. Është thuajse heretike të deklarohesh joetnik ose simpatizant i një identiteti minoritar. Siç argumentojnë edhe Touquet dhe Vermeersch: “Tashmë këta njerëz janë të përjashtuar nga kuadret për emancipim që vijnë si pasojë e konfliktit të fundit. Nuk ka më mundësi që të jesh jugosllav, boshnjak ose eskimez në një kontekst ku nacionalizmi etnik ka uzurpuar gjithçka tjetër dhe ku ekzistojnë variacione që përqendrohen intensivisht tek identiteti dhe ndjenjat ‘kombëtare’” (2008: 280).

Shumë studiues theksojnë vazhdimisht se Marrëveshja

e Paqes së Dejtonit u negociua nga aktorët nacionalistë të cilët ishin shkaktarët kryesorë të luftës dhe kësaj aje thjesht zgjeri pushtetin e partive etnonacionaliste dhe udhëheqësve të tyre (Kaldor, 1997: 28-30). Qytetarët boshnjakë që nuk i përkasin të ashtuquajturave “popullsi përbërëse” u harruan gjatë negociimeve në Dejton dhe më vonë u përjashtuan tërësisht nga kuadri institucional. Pra, të ashtuquajturit “të tjerë” në kushtetutën boshnjake, ose më konkretisht hebrenjtë, romët dhe të gjithë minoritetet e tjera kombëtare së bashku me ata të cilët nuk deklarojnë përkatësi në tre grupet etnike kryesore janë shndërruar në qytetarë të cilët nuk kanë hapësirën institucionale për të ushtruar të drejtat e tyre sociale dhe politike. Për shkak të dispozitave të tilla antiligjore në kushtetutën boshnjake, vendi është përballur me një krizë të thellë kushtetuese dhe institucionale që po kërcënon hapur idenë e pjesëmarrjes demokratike. Ndërsa Bosnja e pasluftës u konceptua për të qenë “një shtet etnik” në sytë e udhëheqësve etnonacionalistë minoritetet kombëtarë si argument për pasjen e një modeli të vërtetë shumëkombësh në Bosnjë janë marginalizuar në skenën publike.

Pra, përmes institucionalizimit të gjerë të etnonacionalizimit, Bosnja është bërë vendi ku vetëm qytetarët që e deklarojnë veten si nacionalistë kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse të vendit. Në fakt, kategoria e “të tjerëve” dhe jonacionalistët perceptohen haptazi si rrezik për modelin e ndarjes së pushtetit përmes rotacionit ku tre grupet etnike zgjedhin përfaqësuesit përkatës. “Modeli i rotacionit” është një mekanizëm i qartë i teknikave politike për të arritur objektivin e një Bosnjeje të ndarë sipas etnive. Pra, pjesëmarrja demokratike në vend është në fakt konkurrenca ndërmjet etnive apo komuniteteve etnike në vend që të jetë një garë ndërmjet personalitetesh të barabartë me të drejtë vote. Rrjedhimisht, hegjemonia e pasluftës e etnonacionalistëve ka rezultuar në mënyrë paradoksale në rritjen e deficitit demokratik të vendit. Si pasojë e kësaj, të gjithë ata që i përkasin kategorish së “të tjerëve” (në BiH janë 17 grupe etnike: shqiptarë, malazezë, çekë, italianë, hebrenj, hungarezë, maqedonas, gjermanë, polakë, romë, rumunë, rusë, rutenianë (Ruthenians), sllovakë, sllovenë, turq dhe ukrainas (Hammarberg, 2010: 6)) luajnë thjesht rolin e spektatorit gjatë zgjedhjeve demokratike. Kësaj “të tjerët” dhe

jo nacionalistët pjesë e popullsisë së Bosnjës janë bërë “të huaj në vendin e tyre”.

Përrjashtimi i anëtarëve të minoriteteve nga procesi politikbërës

Marrëveshja e Dejtonit rezultoi në një strukturë të ndarjes së pushtetit, e cila e ka ndarë Bosnjën sipas entiteteve “etnike” (zonën me popullsi serbe të Bosnjës, Republika Srpska dhe zonën me popullsi kroate dhe boshnjake të Federatës së Bosnjë-Hercegovinës). Gjithashtu, në nivel shtetëror ekziston presidenca me rotacion e cila përbëhet nga tre përfaqësues etnikë dhe një parlament shtetëror që qëndron mbi strukturat institucionale etnike. Pavarësisht kësaj, siç theksohet edhe në Marrëveshjen e Dejtonit, Kushtetuta e Bosnjë-Hercegovinës ndalon kandidimin e të “tjerëve” të cilët iu përkasin grupeve minoritare për president dhe për në Shtëpinë e Popullit (Parlamenti) bazuar te përkatësia e tyre etnike pasi këto pozicione garantohen për të ashtuquajturat “popullsi përbërëse” (domethënë për boshnjakët, serbët dhe kroatët). “Këtu përfshihen edhe minoritetet kombëtare të cilët kanë jetuar në Bosnjë-Hercegovinë prej shekujsh” - (Claridge, 2010: 1). Kjo marrëveshje për ndarjen e pushtetit ka kontribuar dukshëm për pasjen e një procesi etnonacionalizimi duke qenë se elementët joetnikë janë thuar se tërësisht të përrjashtuar nga pjesëmarrja në politikën e vendit ku kanë lindur. Kjo do të thotë se qytetarëve nga grupet minoritare, si romët, turqit ose hebrenjtë iu garantohet vetëm një nivel i kufizuar vetë administrimi (Soberg, 2008: 715). Megjithëse BiH u anëtarësua në Këshillin e Europës më 24 prill të vitit 2002, diskriminimi ndaj minoriteteve në vend është në rritje.

Duke privuar anëtarët e minoriteteve nga e drejta për të kandiduar për një pozicion zyrtar, kushtetuta boshnjake dhuron të drejtat themelore të njeriut edhe pse në vitin 2002 qeveria e vendit ratifikoi KEDNJ-në dhe protokollet e saj. Për këtë arsye Jakob Finci dhe Dervo Sejdić, të cilët i përkasin respektivisht minoritetit hebre dhe atij rom, kundërshtuan këto dispozita përpara GJEDNJ-së për shkak se ato pengonin kandidimin e tyre për një pozicion zyrtar. Në dhjetor të vitit 2009 gjykata

vendosi se përjashtimi i grupeve minoritare nga pozicionet më të larta të zyrtarëve të zgjedhur në Bosnjë përbënte diskriminim të pajustificuar. Pra, “Gjykata Europiane ka bërë të qartë se përjashtimi racor nga pozicionet zyrtare politike nuk mund të ndodhë në Europë” - thekson Clive Baldwin, këshilltar i lartë ligjor i Human Rights Watch (Guardian, 2009). Nëse zbatohen siç duhet, vendimi i GJEDNJ-së do të ndihmonte për shpërbërjen e ndarjeve etnike dhe fetare në Bosnjë Hercegovinë si dhe do të inkurajonte pjesëmarrjen politike dhe përfaqësueshmërinë dhe do të nxiste përfshirjen sociale (Claridge, 2010: 2). Megjithatë, thuajse dy vjet prej vendimit të gjykatës, politikanët e vendit nuk kanë hequr ende dispozitat diskriminuese nga kushtetuta për shkak të interesave etnike të ndryshëm të tyre. Si rrjedhojë, Bosnja ende mbetet një vend thellësisht jodemokratik. Ndërsa shumica e Europës ecën drejt strukturave shumëkombëshe, Bosnja shtyhet ende drejt etnonacionalizimit.

Problemi i romëve në vend përbën rastin më domethënës. Edhe pse në vitin 2008 Bosnjë-Hercegovina miratoi Planin e Veprimit për Adresimin e Problemeve të Romëve në Punësim, Strehim dhe Shëndetësi, ky grup minoritar ende marginalizohet gjerësisht. Gjithashtu, si në Bosnjën e paraluftës ashtu edhe në atë të pasluftës pjesëtarët e komunitetit rom kanë qenë ndër më të marginalizuarit dhe më pak të përfaqësuarit. Sipas OJF-ve rome, në BiH jetojnë 75 000 deri në 100 000 romë dhe ata konsiderohen si një prej minoriteteve më të mëdha kombëtare në vend. Edhe pse vendi është në rrugën drejt Bashkimit Europian, ka pasur një diskriminim të thellë ndaj romëve në arsim, punësim, shëndetësi dhe përfaqësim politik. Për shembull, romët janë grupi etnik më i madh ndër të pastrehët në BiH. Më shumë se 70 % e romëve nuk kanë shtëpi, ndërsa numri i romëve të rikthyer është shumë i vogël (2009). Sipas një raporti të UNICEF-it të vitit 2007, mëse 80 % e fëmijëve romë në Bosnjë-Hercegovinë nuk frekuentojnë shkollat, vetëm 20 % e romëve ndjekin arsimin e mesëm dhe më pak se 1 % e tyre ndjekin arsimin e lartë (2007). Përqindja e romëve të punësuar në sektorin publik në Bosnjë-Hercegovinë vlerësohet 2-3 %. Pra, ata diskriminohen edhe përsa iu përket të drejtave themelore të njeriut. Për më tepër, edhe në media anëtarët e komunitetit rom denigrohen dhe përshkruhen si “problematikë”, “të dhunshëm”, “të rrezikshëm” etj. Për shembull,

kur ndodh një aksident që përfshin romët, raportohen emrat e plotë përmes titujve sensacionalë edhe pse personat mund të jenë të mitur si dhe etiketohen thujse detyrimisht si pjesëtarë të minoritetit rom (Turcilo, 2009).

Gjithashtu, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Europës, z. Thomas Hammarberg dhe delegacioni që e shoqëronte vizituan Bosnjë-Hercegovinën në datat 27-30 nëntor të vitit 2010 për të vlerësuar kushtet e jetesës së grupeve minoritare në vend. Lidhur me minoritetin rom, delegacioni theksoi se mënyra e tyre e jetesës pengonte shtetin që t'i përfshinte ata në statistika. Qeveria ka dijeni se ata jetojnë në situata të vështira dhe e ka marrë këtë çështje seriozisht. Por delegacioni, gjithashtu, theksoi se problemi që shtrihet kishte më shumë të bënte me paragjykimin sesa me diskriminimin (2011). Gjithashtu, delegacioni rekomandon që qeveria boshnjake të intensifikojë përpjekjet për të përmirësuar kushtet ekonomike dhe shoqërore të komunitetit rom bazuar te rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Europës për politikën për romët dhe/ose popullsinë migratore në Europë (CM, 2008).

Institucionalizimi i paradigmës etnonacionaliste

Në Bosnjë sistemi arsimor është përdorur gjerësisht nga udhëheqësit etnonacionalistë për të forcuar hegjemoninë e saj. Në fakt, udhëheqësit etnikë nuk kanë treguar vullnetin dhe përkushtimin politik që nevojitet për pasjen e shkollave tërësisht multietnike. Për më tepër, politikën arsimore kanë luajtur rol domethënës për promovimin e segregimit mbi bazë etnie. Siç është theksuar edhe nga Komisioni Europian në raportin e progresit të vitit 2009 për BiH: “Ndarjet në sistemin arsimor përmes zhvillimit të shkollave monoetnike në të gjitha etnitetet përbëjnë ende një çështje shqetësuese dhe rezultojnë në një segregim de facto të nxënësve që në fillim të shkollimit të tyre” (2009). Për shembull, sistemi arsimor në Federatën e BiH është ndërtuar sipas modelit të “dy shkollave nën të njëjtën çati”, ku fëmijët që iu përkasin dy grupeve të ndryshme etnike (kroatë dhe boshnjakë) mësojnë në të njëjtën godinë, por fizikisht të ndarë prej njëri-tjetrit dhe sipas kurrikulave të ndryshme. Sot ekzistojnë

57 shkolla të tilla në këtë pjesë të Bosnjës. Disa politikanë etnikë kundërshtojnë modelin e shkollave të integruara multietnike ku nuk ka diskriminim politik, fetar dhe asnjë diskriminim tjetër duke argumentuar se duke u përzier së bashku fëmijët do të humbnin identitetin e tyre etnik. Etnonacionalistët kanë përdorur arsimin për indoktrinimin sistematik të grupeve etnike përkatëse.

Gjithashtu sistemi i arsimit në BiH në vend që të luajë rolin e një platforme integruese ku konceptohen normat dhe vlerat demokratike ka qenë nën ndikimin e fortë të elitave politike etnonacionaliste duke rezultuar në diskriminimin e grupeve minoritare. E thënë më thjesht, fëmijët e grupeve minoritare në Bosnjë kanë vuajtur efektet anësore të politikbërjes etnonacionaliste në fushën e arsimit. Gjithashtu, OECD-ja thekson në raportin e saj të publikuar në shtator të vitit 2002 se “sistemet arsimore nuk duhet të jenë thjesht ‘të drejtë’ kundrejt minoriteteve. Ato duhet të nxitin shpirtin e tolerancës dhe barazisë ndërmjet grupeve kulturore dhe etnike” (2001). Pavarësisht kësaj, në Bosnjën e post-Dejtonit minoritetet janë bërë “inekzistentë” në sistemin arsimor, çka po shemb paradigmen etnonacionaliste. Siç argumenton edhe Valery Perry:

“Le të fokusohemi te gjuha. Gjuha zyrtare në Republikën e Srpskasë është serbishtja, në Federatë gjuhët zyrtare janë gjuha boshnjake ose kroatishja në varësi të kantonit. ‘Të tjerët’ mësojnë gjuhën që mbizotëron në zonën ku jetojnë. Duhet theksuar se ne kemi tre gjuhë zyrtare brenda një vendi. ‘Të tjerët’ janë asimiluar brenda një gjuhe zyrtare në gjuhën e zonës ku jetojnë, gjë që sipas meje nuk përputhet me të drejtat e njeriut që ata duhet të gëzojnë” (2002: 27).

Ndoshta marginalizimi i grupeve minoritare nga negociatat e Dejtonit dhe nga marrëveshja për të cilën u ra dakord ishte rrjedhojë e reagimit të shpejtë për përfundimin e luftës dhe për të gjetur zgjedhje kompromiseshe të vështira. Gjëja më e rëndësishme ishte përfundimi i luftës së tmerrshme dhe gjetja e një modeli për ndarjen e pushtetit, ku secili prej grupeve etnike do të merrte pjesë pa u diskriminuar dhe pa u dominuar nga dy grupet e tjera. Kjo do të thotë se objektivi kryesor i negociatave të Dejtoni ishte paqja dhe jo barazia, duke diskriminuar kësaj

grupet jonacionaliste. Siç thekson edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut në vendimin e saj për çështjen Sejdic-Finci:

“Një armëpushim shumë i brishtë ishte vendosur në terren. Dispozitat u hartuan për të përfunduar një konflikt brutal karakterizuar nga gjenocidi dhe ‘spastrimi etnik’. Natyra e konfliktit ishte e tillë që miratimi prej ‘popullsive konstitutive’... nevojitej për sigurimin e paqes. Kjo mund të shpjegojë, pa qenë nevoja për justifikim, mungesën e përfaqësueshmërisë së komuniteteve të tjera... në negociatat për paqe dhe preokupimin e pjesëmarrësve për barazinë efikase të ‘popullsive përbërëse’ në shoqërinë postkonfliktuale” (2009: 34).

Si rrjedhojë e sa më sipër, BiH u shndërrua në një legjislaturë bikamerale ku të tre grupimet e të ashtuquajturave ‘popullsi përbërëse’ (serbët, boshnjakët dhe kroatët) përfaqësohen në mënyrë të barabartë (5:5:5) në dhomën e dytë (Shtëpinë e Popullit) (Marko, 2005: 6). Gjithashtu, si presidenca e shtetit ashtu edhe qeveria kombëtare me ministrat dhe deputetët e tyre përbëhen sipas ndarjes së pushtetit mbi baza etnike. Pra, kuadri institucional i post-Dejtonit bazohet gjerësisht te modeli konsociacionalist (consociationalist model) i ndarjes së pushtetit (Lipjhart, 1994). Konsociacionalizmi (consociationalism) është një formë e ndarjes së pushtetit e cila ka për qëllim kryesor pajtimin e preferencave të ndryshme sociale sipas kriterëve etnike dhe fetare (Schneckener 2002: 203-206). Me fjalë të tjera, Marrëveshja e Dejtonit ka sjellë një kuadër institucional brenda të cilit tre grupet etnike më të mëdha njihen zyrtarisht në Kushtetutë dhe marrin pjesë në mënyrë të barabartë në të gjitha nivelet administrative të vendimmarrjes dhe gjithashtu gëzojnë të njëjtën të drejtë vetoje kur “interesat thelbësorë kombëtarë përkatës” rrezikohen (Bieber, 2004). Megjithatë, modeli konsociacionalist i ndarjes së pushtetit në Bosnjë nuk ka sjellë transformimin demokratik dhe pajtimin e dëshiruar edhe pas 15 vjetësh tranzicion. Për më tepër, ndërsa u hartua për të mbajtur ekuilibrin ndërmjet tre grupeve etnike, modeli konsociacionalist që doli nga Dejtoni përjashton thujtë tërësisht anëtarët e grupeve minoritarë dhe jonacionalistët nga procesi vendimmarrës.

Konceptimi institucional: shfarosja e idesë së shtetësisë

Rendi i ndarjes së pushtetit në Bosnjë ka ndikuar dukshëm mbi grupet etnike përbërëse. Megjithatë, performanca e dobët e demokracisë dhe tolerancës etnike nën regjimin aktual nxjerr në pah limitet e kuadrit institucional (Manning & Antić 2003, 55-56). Është me rëndësi thelbësore aplikimi i idesë së shtetësisë në konceptimin e institucioneve në shoqëritë postkonfliktuale për të sjellë paqen dhe stabilitetin ndërmjet palëve ndërluftuese. Faktikisht, konceptimi institucional është arti i mundësimit të rregullave dhe institucioneve për arritjen e qëllimeve politike si krijimi dhe funksionimi i një demokracie multietnike (Reilly 2001; Grofman & Stockwell 2003). Pavarësisht kësaj, lufta në Bosnjë u mendua se do të përfundonte përmes ndarjes së pushtetit sipas balancës etnike çka rezultoi në një koncept politik, i cili prodhoi efektin e kundërt duke rritur më tej tensionet etnike ndërmjet palëve në luftim. Siç thekson edhe prof. Zarije Seizovic: “‘Kriteri etnik’ në Parathënien e Kushtetutës të BiH (përforcuar nga përcaktimi i numrave të vendeve në pjesën normative të saj) pengon autoritetet e BiH për të ndarë pushtetin në mënyrë të barabartë brenda shoqërisë civile sepse favorizon grupet etnike në kurriz të individit” (2007: 2). Në fakt, një model i tillë i ndarjes së pushtetit është parë në terma thelbësore dhe absolutiste nga grupet etnike ose si një shembull i qartë i lojës me shumën zero (zero sum game).

Faktikisht, ndërsa grupet minoritare u marginalizuan tërësisht gjatë negociatave prej grupeve etnike ndërluftuese, prezenca dhe përfshirja politike e tyre mund të përdoret për zhvillimin e një sistemi qeverisjeje demokratike dhe të hapur. Ndërsa, aktualisht, pas vendimit të GJEDNJ-së ata përbëjnë një problem të madh për integrimin e vendit në strukturat euroatlantike ata mund të jenë pjesë e zgjidhjeve afatgjata. Në fakt, Kushtetuta e BiH njeh të drejtat themelore të njeriut dhe mbrojtjen e grupeve minoritare dhe kërkon që institucionet shtetërore dhe të dy qeveritë etnike të sigurojnë nivelin më të lart të standardeve ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut dhe mos-diskriminimit. (neni II 4). Megjithatë, në praktikë të gjithë qytetarët e vendit nuk gëzojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në mënyrë të barabartë. Kjo do të thotë se kuadri kushtetues aktual që kur u vendos në BiH nuk garanton mbrojtjen e individit por mbrojtjen e identitetit kolektiv

të tyre (Seizovic, 2007: 2). Nëse minoritetet do të mbroheshin nga aktet diskriminuese, i gjithë koncepti do të kthehej nga etnik në qytetar, duke zhdukur homogjenizimin etnik që është burimi kryesor i tensioneve politike dhe sociale në Bosnjë. Kjo do të çonte në forcimin e zbatimit të të drejtave universale të njeriut siç ndodh në një rend demokratik liberal.

Në vijim të konfliktit etnik të viteve 1992-1995 dhe të mbizotërimit të paradigmës etnonacionaliste gjatë periudhës së pasluftës, shtetësia në Bosnjë ka marrë tipare unike që bazohen ekskluzivisht te përparësia e të drejtave të grupeve kundrejt të drejtave të individit. Në fakt, kuadri kushtetues i Dejtonit garanton përkatësinë shtetërore dhe etnike për popullatën e Bosnjë-Hercegovinës. Kjo do të thotë se marrja e përkatësisë etnike ka intensifikuar edhe më tej procesin e homogjenizimit etnik dhe përjashtimin e elementëve joetnikë në vend. Siç thekson edhe Sarajlic: “Krahas pafuqisë së tranzicionit postsocialist që u përjetua nga të gjithë shtetet pasardhës të ish-Jugosllavisë, regjimi i qytetarisë ekzistues në Bosnjë është ndikuar dukshëm nga një trashëgimi konfliktesh etnike dhe nga kuadri provizor kushtetues i vendit. Konceptualizimi i qytetarisë në Bosnjë-Hercegovinë ka qenë i varur nga përkufizimi i komunitetit të qytetarëve që përbëjnë shtetin. Meqenëse Bosnjë-Hercegovina nuk është një shtet-komb (dhe nuk ka qenë kurrë një i tillë), por një bashkim federal bazuar te sovraniteti i grupeve etnike të cilët kanë supremaci politike mbi individët dhe krijimi i përkufizimeve të qarta të shtetësisë boshnjake është thujse i pamundur (2010: 2).

Prandaj është thujse e palogjikshme të flasësh për qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës duke qenë se më shumë se gjysma e popullsisë së vendit e ndiejnë veten serbë, kroatë dhe boshnjakë më shumë sesa shtetas të federatës. Me fjalë të tjera, diskursi politik në Bosnjë është bërë i kufizuar deri në shtrëngues për anëtarët e komunitetit që identifikohen si jugosllavë, boshnjakë, hebrenj e kështu me radhë. Lidhur me këtë, prof. Atajic thekson: “Çdo gjë, që nga përshëndetja që t’i përdor, dialekti që flet dhe gazeta që t’i mban në xhep komentohet, gjykohet dhe kategorizohet sipas një koncepti të kudogjendur dhe të mitizuar ‘etniciteti’. Në këto rrethana, të përcaktosh veten si shtetas i shtetit të BiH, perceptohet thujse si një tradhti ndaj identitetit kombëtar individual” (2002:118). Në fakt, shumica dërrmuese e

popullatës në Bosnjë e percepton etnicitetin si një dogmë fetare e cila duhet respektuar. Kjo situatë ka prodhuar pasoja negative për zhvillimin e një shtetësie të përbashkët boshnjake. Në këtë kontekst ekziston edhe një lloj absurditeti ku ata që janë qytetarë të Bosnjës (në vend që të jenë serbë, boshnjakë ose kroatë) janë minoritet në BiH (Turcilo, 2009: 1). Me fjalë të tjera, çdo person që nuk identifikohet me një nga tre grupet etnike, konsiderohet automatikisht si minoritet ose si një element i huaj.

“Interesat vitale kombëtare” si rregull i lojës

Interesi kolektiv ka mbizotëruar mbi preferencat individuale të qytetarëve duke parandaluar zhvillimin e diskutimi të lirë dhe përfshirjen e elementëve joetnikë të shoqërisë. Siç thekson Mujkic dhe Husley: “Që prej zgjedhjeve të para demokratike në Bosnjë-Hercegovinë në vitin 1991, politika është karakterizuar nga etnopolitikat në vend të politikave që bazohen tek interesat kombëtare. Rezultati i kësaj është fakti që konkurrenca politike për votues është reduktuar në nivelet e një censusi etnik” (2010: 144). Për më tepër, përpara ditës së zgjedhjeve shumica dërrmuese e grupeve etnike kanë vendosur “kolektivisht” për t’i dhënë votën anëtarëve të partive politike etnonacionaliste përkatëse. Jo vetëm që nacionalistët dhe anëtarët e grupeve minoritare përjashtohen nga diskursi publik, por shpesh ata përballen me presion të fortë për të votuar një nga partitë politike nacionaliste. Me fjalë të tjera, diskursi i etnonacionalizimit i periudhës së pasluftës ka krijuar një “presion etnonacionalist” të kudogjendur mbi anëtarët e shoqërisë së Bosnjës që i detyron ata të identifikohen me një nga tre grupet kombëtare. Kjo do të thotë se paradigma etnonacionaliste e pasluftës ushtron një presion “të natyrshëm” mbi myslimanët boshnjakë, katolikët boshnjakë dhe ortodoksët boshnjakë për të qenë pjesë e partive nacionaliste përkatëse.

Për sa i përket etnonacionalizimit institucional, sistemi boshnjak vuan nga bllokadat institucionale të krijuara për shkak se politikanët që zgjidhen në mënyrë të veçantë nga secili komunitet etnik nuk mund të bien dakord për kompromise të cilat tejkalojnë kompetencat për veto (Chivvis & Đogo, 2010). Struktura institucionale përjashtuese boshnjake e Dejtonit ka

lejuar që përfaqësuesit e secilit prej tre grupeve etnike të gëzojnë kompetencën për veto mbi çdo akt legjislativ të propozuar dhe ka krijuar një presidencë tre palëshe e cila konsiston nga përfaqësues të secilit grup dhe ka pajisur çdo anëtar me të drejtën për ushtrimin e vetos mbi çdo legjislacion. Ndërsa “fuqia për veto” e përfaqësuesve etnikë përbën mekanizmin që garanton se ata do të përfshihen në mënyrë të barabartë në procesin vendimmarrës, ajo është qartësisht diskriminuese ndaj interesave qytetare. Siç argumenton edhe Lyon, “koncepti i ‘kushtetueshmërisë së kombësive’ lejon legalizimin e diskriminimit bazuar në prejardhjen etnike dhe kundërshton prima facia principet e Këshillit të Europës. Pa dyshim që e gjithë kushtetuta thekson diskriminimin etnik si princip ligjor (2006: 52). Faktikisht, çdo iniciativë civile diskreditohet nga institucionalizimi i lartë i diskursit etnonacionalist.

Gjithashtu, institucionalizimi i tejskajshëm i politikave etnonacionaliste në Bosnjën e post-Dejtonit është realizuar përmes një kuadri strukturor ku të drejtat etnike garantohen bazuar tek të ashtuquajturat “interesa vitale kombëtare” (IVK). Kjo do të thotë se në Shtëpinë e Popullit të BiH përfaqësuesit e secilës etni përbërëse kanë të drejtë të bllokojnë një ligj nëse ai është kundër IVK-së të etnisë përkatëse. Në të njëjtën mënyrë, anëtarët e presidencës shtetërore trepalëshe kanë të drejtën e vetos nëse gjykojnë se legjislacioni paraqet rrezik për IVK-në e kombeve të tyre. Megjithatë, nocioni i IVK-së në rastin e Bosnjës përfshin një ndjesi të dobët të “kombëtares”. Kombëtarja përkufizohet e barabartë me “etnike” (Mujkic, 2007). Prandaj, në zemër të nocionit të IVK-së qëndron dukshëm dimensionet etnik i përfaqësimit politik dhe jo interesat shtetërore apo ato kombëtare. Prandaj principi i IVK-së është shumë diskriminues kundër grupeve minoritare dhe jonacionalistëve duke pasur parasysh se ata nuk kanë të drejtën të përdorin veto në nivel shtetëror dhe etnik. Me pak fjalë politizimi i gjerë i etnicitetit dhe suksesi i partive politike të orientuara etnikisht janë pengesa serioze për procesin afatgjatë të demokratizimit (Chandler, 2000: 111).

Ideja kryesore pas interesave vitale kombëtare ishte mundësia i një sistemi të sofistikuar kontrolli dhe balance për të garantuar të drejtat e “popullsive përbërëse” të Bosnjë-

Hercegovinës (boshnjakëve, kroatëve dhe serbëve). Kushtetutat shtetërore dhe etnike krijojnë mekanizma bllokues që mbrojnë “interesat vitale” të këtyre popullsive përbërëse (EC, 2005: 9). Megjithatë, ndërsa IVK-ja marginalizojnë tërësisht secilin anëtar të shoqërisë që nuk deklarohet si nacionalist ato gjithashtu ngadalësojnë procesin legjislativ gjatë rrugës së vendit drejt integritit euroatlantik. Kjo dispozitë për ndarjen e pushtetit që bazohet te koncepti i IVK-së ka cenuar cilësinë e demokracisë boshnjake ku qytetarët përfaqësohen vetëm si anëtarë të një prej tre popullsive përbërëse duke vendosur përfaqësimin etnik përpara interesit të përgjithshëm dhe duke bërë që “kombet dhe jo qytetarët të jenë bartës të të gjithë të drejtave” (Katana and Igric, 2005). Siç theksohet në raportin e USAID-it, “kushtetuta e Bosnjës thekson ‘interesen vital kombëtar’ të popullsive përbërëse dhe kështu garanton përfshirjen politike dhe përjashtimin në bazë etnie. Boshnjakët filtrojnë diskursin politik në baza etnike duke përfshirë si të vlefshme pikëpamjet e grupeve të tyre dhe duke përjashtuar si të pavlefshme pikëpamjet e grupeve të tjerë. Skena publike është e disponueshme për të gjithë, por sipas rendit: një opinion, një zë, një grup” (2007: 6).

Me deficit demokratik drejt Brukselit!

Sistemi politik i pasluftës në Bosnjë nuk përmban vlera demokratike si barazia dhe liria dhe nuk garanton që të gjithë qytetarët të ndihen të barabartë përpara ligjit dhe të kenë akses të barabartë në procesin legjislativ. Siç thekson edhe Bojkov, demokracia në Bosnjën e pasluftës nuk mund të thuhet se ishte themeluar në mënyrë konstitucionale (2003: 60). Demokracia është një formë qeverisjeje ku të gjithë qytetarët mund të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në procesin vendimmarrës që ndikon në jetët e tyre. Termi “demokraci” u krijua në Greqinë e lashtë në mes të shekullit IV para erës sonë për të përkufizuar rendin politik të disa qytet-shteteve greke dhe kuptimin e “pushtetit të popullit” e përbërë nga demos (populli) dhe kratos (pushteti). Nga ana e ontologjisë së pushtetit në Bosnjën e pas-Dejtonit pushteti politik ka qenë në duart e oligarkive etnike dhe komuniteteve etnike dhe jo në ato të shtetasve individualë. Kjo do të thotë se konteksti social i Bosnjës është mbizotëruar prej

idesë së Volksgemeinschaftit (komunitetit të popujve) dhe jo nga ideja e komunitetit të individëve të lirë. Gjithashtu, prof. Živanović i përkufizon grupimet politike të pasluftës në Bosnjë-Hercegovinë si vijon: “Këtu ne nuk jetojmë si qenie njerëzor, por si serbë, kroatë dhe boshnjakë” (2005). Në fakt, regjimi i pas-Dejtonit ka dehumanizuar skenën publike në Bosnjë.

Sot Bosnja duket më shumë si një “demokraci joliberalë” sipas termit që përdoret nga Fareed Zakaria për të shpjeguar fenomenin e nxitjes së zgjedhjeve të reja nëpër botë pa dispozita që garantojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore (1997). Pra, regjimi politik i pasluftës në Bosnjë është më së shumti një etnokraci sesa një demokraci përfaqësuese. Etnokracia është regjimi që lehtëson “shtrirjen e etnicizimit dhe kontrollin e territorit të kontestuar dhe shtetit nga një grup etnik dominues” (Yiftachel and Ghanem, 2004: 649). Në fakt, prioritizimi ekstrem i vlerave etnike mbi principet individuale përbën rrezik për demokracinë. Siç thekson edhe Mujkic:

“Unë shoh një komunitet që karakterizohet nga prioriteti politik i grupeve etnike mbi atë të individit dhe që zbatohet përmes vetëlegjitimitimit demokratik dhe një komuniteti që karakterizohet nga prioriteti politik i të drejtave të njeriut të grupeve etnike për vetëvendosje mbi të drejtat e qytetarëve për vetëvendosje ku anëtarësimi i qytetarëve në një komunitet politik përcaktohet nga anëtarësimi i tij/e saj në një grup etnik (etnopolis). Gjithashtu i bëj thirrje narrativës dhe praktikës politike që të justifikojë këtë konstrukt social të bazuar tek etnia (etnopolitikën)” (2007: 116).

Kuadri kushtetues që bazohet te Dejtoni është në kundërshtim me vlerat e Bashkimit Europian për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Me pak fjalë, Marrëveshja e Dejtonit siguron mbrojtjen e të drejtave kolektive të grupeve etnike ndërsa të drejtat e grupeve minoritare nuk janë përfshirë në këtë kuadër ligjor. Pra, në mars të vitit 2005 Komisioni i Venecias propozoi paketën e reformave kushtetuese që nevojiteshin për të përgatitur Bosnjë-Hercegovinën për anëtarësimin e ardhshëm në BE. Rekomandimet kryesore të Komisionit të Venecias përfshijnë:

- Transferimin e kompetencave nga etnitë drejt shtetit.
- Reformë e strukturave inefikase legislative dhe ekzekutive.
- Eliminimi i “prerogativave për të drejtat e etnike dhe ato të grupeve”.
- Forcimi i të drejtave të qytetarëve.
- Qartësimi i marrëdhënies së ardhshme të etnive me shtetin (Joseph and Hitchner, 2008: 5).

Komisioni i Venecias gjithashtu përkufizon integrimin e Bosnjës në BE si të rrezikuar, duke qenë se kuadri institucional i vendit shkel drejtpërdrejtë të drejtat e KEDNJ-së duke iu referuar veçanërisht “ekzistencës së tensioneve ndërmjet një sistemi kushtetues që bazohet te grupet etnike, nga njëra anë, dhe principit të të drejtave individuale dhe barazive të qytetarëve, nga ana tjetër” (2005: 17).

Individët që nuk i përkasin asnjërit nga tre grupet etnike më të mëdhenj mund të bëhen pjesë e një nga tre forcat politike nacionaliste për t’u ndier të barabartë me anëtarët e tre grupeve të tjera etnike. Për shembull, ka pasur zyrtarë të lartë të qeverisë së shtetit të cilët kanë preferuar të jenë pjesë e një prej partive etnike për “të ushtruar të drejtat e tyre si qytetarë”. Megjithatë, kjo nuk përbën një zgjidhje afatgjatë që mund të garantojë barazinë e qytetarëve në të gjithë vendin. Për këtë, Komisioni i Venecias thekson se:

“Së pari, interesat e atyre që nuk i përkasin tre popullsive përbërëse rrezikojnë të neglizhohen ose njerëzit detyrohen që të identifikohen artificialisht me një nga tre popullsitë, edhe pse ata mund të jenë të përzier ose t’i përkasin ndonjë kategorie tjetër. Çdo individ është i lirë të ndryshojë përkatësinë e tij politike. Në kontrast me këtë, identiteti etnik është më i përhershëm dhe individët nuk do të donin të votonin për partitë që i perceptojnë si përfaqësues të interesave të grupeve të ndryshme etnike edhe kur këto parti mundësojnë qeveri më të mira dhe më efikase. Një sistem që favorizon dhe synon një sistem partiak që bazohet tek etniciteti, duket i palogjikshëm” (2005: 12).

Konkluzionet

Bosnjë-Hercegovina ka qenë pjesë e grupit të vendeve ish-komuniste që filluan transformimin e gjerë demokratik pas shpërbërjes së dhunshme të ish-Jugosllavisë në fillimin

e viteve 1990. Ndërsa pritej që tranzicioni demokratik të sillte pjesëmarrje të gjerë të grupeve të ndryshme shoqërore në proceset politikbërëse, skena publike në Bosnjën e pasluftës është dominuar nga etnonacionalistët duke sjellë diskriminim në çdo fushë për grupet minoritare dhe për ata të cilët deklarohen si jonacionalistë. Kjo do të thotë se demokracia ka sjellë një doktrinë kolektive në vend që të promovonte të drejtat e individëve. Gjithashtu, pavarësisht se BiH po shkon drejt një procesi të thellë europianizimi gjatë të cilit supozohet se sistemi politik, ekonomik dhe administrativ i vendit do të transformohet në struktura të qëndrueshme, funksionale dhe demokratike, anëtarët e grupeve të minoriteteve dhe jonacionalistët marginalizohen gjerësisht dhe përjashtohen prej proceseve vendimmarrëse. Edhe pse kriteri politik i Kopenhagës iu kërkon vendeve që aspirojnë anëtarësim arritjen e “stabilitetit të institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve”. BiH edhe tani po përballet me një deficit demokratik serioz sidomos lidhur me përhapjen e gjerë të diskriminimit ndaj anëtarëve të grupeve minoritare dhe individëve të cilët nuk ndihen nacionalistë.

Me pak fjalë, në Bosnjën e post-Dejtonit skena publike ka qenë e kufizuar vetëm për anëtarët e tre grupeve etnike më të mëdha që njihen nga kushtetuta, si popullsitë përbërëse. Siç argumenton edhe Jurgen Habermas, skena publike është ndërtuar mbi marginalizimin ekstrem të qytetarëve si mbajtës të pushtetit duke qenë se statusi i tyre si anëtarë të komunitetit politik është kufizuar. Në fakt, pjesëmarrja demokratike në skenën publike të vendit është kthyer në një konkurrencë ndërmjet komuniteteve etnike në vend që të jetë një garë individësh të barabartë me të drejtë vote. Çështja e etnisë është bërë një *raison d'être* për të tre grupet etnike, duke qenë se ata besojnë se mbijetesa fizike e tyre varet nga përpjekja e vazhdueshme për identitet etnik. Një model politik i tillë përbën një lloj etnodemokracie ose etnokracie e cila vazhdimisht dhunon të drejta e njeriut dhe liritë themelore dhe kështu ngadalëson progresin e vendit drejt anëtarësimit në BE. BiH nuk mund të hyjë në BE ndërkohë që skena publike e vendit mbizotërohet gjerësisht prej elitave etnonacionaliste që parandalojnë zhvillimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike. Prandaj politikanët, media, shoqëria civile dhe aktorët e tjerë

shoqërorë proeuropianë në BiH duhet të bëjnë përpjekje të mëtejshme për përfshirjen e grupeve të ndryshme shoqërore, si grupet minoritare dhe jonacionalistët në procesin vendimmarrës. Me shumë gjasa përfshirja e anëtarëve të minoriteteve në procesin politikbërës do të kthehet nga një problem në një pjesë të zgjidhje për ngërçin dhjetëvjeçar të vendit.

Bibliografi

1. Anastasakis, O., (2005), "The Europeanization of the Balkans", *The Brown Journal of World Affairs*, XII (1), 2005, p. 80.
2. Arnautovic, Suad, (2007), "Ten Years of Democratic Chaos: Electoral Processes in Bosnia and Herzegovina from 1996 to 2006", Sarajevo: Promocult.
3. Ashdown, Paddy, (2005), "A superb agreement to end a war, but a very bad agreement to make a state", *Former HR in BiH*, Lord Paddy Ashdown, Farewell, Sarajevo, *The Guardian*, 2 November 2005, www.guardian.co.uk/article/o..i6o64.8Q.oo.html.
4. Atajic, Ramo, (2002), "Civilitet kroz povijest", Bihac.
5. Becker, Jens, (2008), "The European Union and the Western Balkans", *South-East Europe Review*, p. 7-27, 2008.
6. Bianchini, S., (2000), "Political Culture and Democratization in the Balkans", in *Experimenting with Democracy: Regime Change in the Balkans*, eds. G. Pridham and T. Gallagher, London: Routledge, 2000.
7. Bieber, F., (2004), "Towards better governance with more complexity?", in: C. Solioz & T. K. Vogel (Eds), *Dayton and Beyond: Perspectives on the Future of Bosnia and Herzegovina*, p. 74-87 (Baden-Baden: Nomos).
8. Bojkov, Victor, (2003), "Democracy in Bosnia and Herzegovina: Post-1995 Political System and its Functioning", *Southeast European Politics*, Vol. IV, No. 1, p. 41-67.
9. Chandler, David (2000): "Bosnia: Faking Democracy after Dayton", 2nd edition, London: Pluto Press.
10. Claridge, Lucy, (2010), "Discrimination and political participation in Bosnia and Herzegovina, Sejdic and Finci v. Bosnia and Herzegovina", *Minority Rights Group International*, January 2010.

11. CM, (2008), "Recommendation CM/Rec (2008) 5 of the Committee of Ministers to member states on policies for Roma and/or Travellers in Europe", available at <https://wcd.coe.int>.
12. EC, European Commission, (2005). "Bosnia and Herzegovina 2005 Progress Report", Brussels, 9 November 2005, available at http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1422_final_progress_report_ba_en.pdf.
13. EC, European Commission, (2009), "Commission Staff Working Document, Bosnia and Herzegovina 2009 Progress Report accompanying the Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Enlargement Strategy and Main Challenges 2009-2010", Brussels, 14.10.2009.
14. ECHR, (2009), "European Court of Human Rights", judgment of 22 December 2009, Sejdić and Finci v. Bosnia and Herzegovina, available at <http://www.ustavnareforma.ba/files/articles/20101014/192/en.%20Case%20of%20Sejdic%20and%20Finci%20v.%20Bosnia%20and%20Herzegovina,%2022.12.2009.pdf>.
15. FRA, (2010), "Annual Report 2010", European Union Agency for Fundamental Rights, Conference Edition, available at http://fra.europa.eu/fraWebsite/attachments/AR_2010-conf-edition_en.pdf.
16. Freedom House, (2010), "Nations in Transit 2010: Bosnia and Herzegovina" prepared by Jasna Jelicic, available at <http://www.freedomhouse.eu/images/Reports/NIT-2010-Bosnia-final.pdf>.
17. Guardian, (2009), "Bosnia's bar on minorities in parliament ruled illegal", by Afua Hirsch, available at <http://www.guardian.co.uk/world/2009/dec/22/bosnia-election-law-ruled-illegal>, Tuesday 22, December 2009.
18. Grofman, B., & Stockwell, R. (2003) "Institutional design in plural societies: Mitigating ethnic conflict and fostering stable democracy", In R. Mudambi, P. Navarra, G. Sobbrío, R. Mudambi, P. Navarra & G. Sobbrío (Eds), Economic welfare, international business and global institutional change, p. 102-137 (Cheltenham, Elgar).
19. Hammarberg, Thomas, (2011), "Issues reviewed: Fight against discrimination, human rights of people displaced by the war, asylum seekers and stateless persons, post-war

- justice and reconciliation", REPORT by Thomas Hammarberg, Commissioner for Human Rights of the Council of Europe Following his visit to Bosnia and Herzegovina on 27-30 November 2010, Strasbourg, 29 March 2011.
20. Habermas, Jurgen, (2003), "Intolerance and Discrimination", Oxford University Press and New York University School of Law, 2003, I.CON., Volume 1, Number 1, 2003, p. 2-12.
 21. Habermas, Jurgen (2005), "Equal Treatment of Cultures and the Limits of Postmodern Liberalism", The Journal of Political Philosophy, v. 13, n. 1, March 2005.
 22. Harryvan, A. G., and J. van der Harst (New York: St. Martin's, 1997), p. 285, "Decision of the Heads of State or Government, Meeting in Copenhagen, on Future EU Enlargement", Documents on European Union.
 23. Joseph, Edward P., and Hitchner, Bruce, R., (2008), "Making Bosnia Work: Why EU Accession is Not Enough", United States Institute of Peace.
 24. Kaldor, Mary, (1997), "One Year after Dayton", in Mient Jan Faber (ed.) Dayton Continued in Bosnia Herzegovina (1) (The Hague: Helsinki Citizens' Assembly Publication Series 11).
 25. Katana, G., and Igric, G., (2005), "While international players claim Bosnia's leaders have been secretly drafting a new constitution", Balkan Investigative Reporting Network, 18 November 2005.
 26. Kubicek, P., (2005) "The Europeanization and Grassroots Democratization of Turkey", in Turkish Studies 6(3): 361-377.
 27. Ladrech, Robert, (1994), "Europeanization of Domestic Politics and Institutions; the Case of France", Journal of Common Market Studies, 32 (1), p. 69-88.
 28. Lipjhart, A., (1994 a), "Electoral Systems and Party Systems", A Study of Twenty-Seven Democracies 1945-1990, Oxford University Press, Oxford.
 29. Lyon, James, (2006), "Overcoming Ethnic Politics in Bosnia? Achievements and Obstacles to European Integration", in Martina, Fischer (2006), Peace building and Civil Society in Bosnia-Herzegovina, Ten Years after Dayton, Münster: Lit Verlag 2006.
 30. Manning, C., & Antić, M., (2003), "The Limits of Electoral Engineering", Journal of Democracy, 14 (3), p. 45-59.
 31. Mujkić, A., (2007), "We, the Citizens of the Ethnopolis", Constellations Volume 14, Issue 1, 112-128.

32. Mujkic, Asim & Hulsey, John, (2010), "Explaining the Success of Nationalist Parties in Bosnia and Herzegovina", *Politicka misao*, god. 47, br. 2, 2010, str. 143-158.
33. Marko, Joseph, (2005), "Post-conflict Reconstruction through State- and Nation-building: The Case of Bosnia and Herzegovina", *European Diversity and Autonomy Papers*, EDAP 4/2005, available at http://webfolder.eurac.edu/EURAC/Publications/edap/2005_edap04.pdf.
34. OECD, (2007), "Centre for Co-operation with Non-members", Directorate for Education, Employment, Labour and Social Affairs, Education Committee. Thematic Review of National Policies for Education - Bosnia and Herzegovina. Stability Pact for South Eastern Europe Report, Table 1, Task Force on Education, 27 September 2001, 15.
35. O'Neill, Shane, (2000), "The Politics of Inclusive Agreements: Towards the Critical Discourse Theory of Democracy", *Political Studies*, 2000 Volume 48, 503-521.
36. OSCE, (1990), "Conference for Security and Co-operation in Europe", Document of the Copenhagen Meeting of the Conference on the Human Dimension of the CSCE, 5 June-29 July, available at http://aceproject.org/main/english/ei/eix_c070.htm.
37. Perry, Valery, (2002), "ECMI Civil Society Project in BiH: National Minorities and Educational Reform in Bosnia and Herzegovina", European Center for Minority Issues Workshop, Sarajevo. November, 2002.
38. Sarajlic, Eldar, (2010), "Report on Bosnia and Herzegovina", The report has been produced by the CITSEE project (The Europeanization of Citizenship in the Successor States of the former Yugoslavia) in close cooperation with EUDO CITIZENSHIP, available at <http://eudo-citizenship.eu/docs/CountryReports/Bosnia%20and%20Herzegovina.pdf>.
39. Schneckener, U. (2002), "Making Power-Sharing Work: Lessons from Successes and Failures in Ethnic Conflict Regulation", *Journal of Peace Research* 39(2): 203-228.
40. Seizovic, Zarije, (2007), "Constitutional Reform in Bosnia and Herzegovina: 'Civil State' of Constituent Peoples", This paper was presented at the Second Annual Conference on Human Security, Terrorism and Organized Crime in the

Western Balkan Region, organized by the HUMSEC project in Sarajevo, 4-6 October 2007.

41. Sejdic, Dervo, (2009), "Comments on the implementation of the framework convention on the protection of national minorities in Bosnia and Herzegovina", Council of Roma of the Federation of BiH, available at [http://www.internal-displacement.org/8025708F004CE90B/\(httpDocuments\)/E1DDFCE39A48E213802570B700587783/\\$file/Council+of+Roma+1.pdf](http://www.internal-displacement.org/8025708F004CE90B/(httpDocuments)/E1DDFCE39A48E213802570B700587783/$file/Council+of+Roma+1.pdf).
42. Soberg, Marius, (2008), "The Quest for Institutional Reform in Bosnia and Herzegovina", East European Politics and Societies, 2008; 22; 714 originally published online Sep 8, 2008.
43. Todorova, M., (1994), "The Balkans: From Discovery to Invention", Slavic Review, 53 (2), 1994, p. 453-482.
44. Touquet, Heleen and Vermeersch, Peter, (2008), "Bosnia and Herzegovina: Thinking Beyond Institution-Building", Nationalism and Ethnic Politics, Volume 14, Issue 2 April 2008, pages 266- 288.
45. Turcilo, Lejla, (2009), "Minorities in Bosnia and Herzegovina: Between Seeming Tolerance and Real Disregard", available at http://www.boell.ba/downloads/Minorities_in_BiH.pdf.
46. UNICEF, (2007), "Breaking the Cycle of Exclusion - Roma children in South-East Europe", 2007, available at www.unicef.org.
47. USAID, (2007), "Bosnia and Herzegovina and Governance Assessment", The publication was produced for review by the United States Agency for International Development by Democracy International, Inc. May, 2007, available at http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADK585.pdf.
48. Venice Commission, (2005), "Opinion on the Constitutional Situation in Bosnia and Herzegovina and the Powers of the High Representative", European Commission for Democracy Through Law, Venice Commission, Venice, 11 March 2005, available at [http://www.venice.coe.int/docs/2005/CDL-AD\(2005\)004-e.asp](http://www.venice.coe.int/docs/2005/CDL-AD(2005)004-e.asp).
49. Vogel, Toby, (2006), "Bosnia and Herzegovina: The Challenge of Legitimacy, FAST Country Risk Profile Bosnia and Herzegovina", Working Paper 2, 2006, Swiss Peace Foundation, available at http://www.swisspeace.ch/typo3/fileadmin/user_upload/Media/Publications/WP2_2006.pdf.

50. Vouters, Jan, (2001), "The EU Charter of Fundamental Rights: Some reflections on its external dimension", Institute for International Law, Working Paper No 3, May 2001, available at <https://www.law.kuleuven.be/iir/nl/onderzoek/wp/WP03e.pdf>.
51. Wilk-Woøe, Zofia, (2010), "The Role of Intercultural Dialogue in the EU Policy", Journal of Intercultural Management, Vol. 2, No. 1, March 2010, p. 78-88.
52. Yiftachel, O. and A. Ghanem, (2004), "Understanding 'Ethnocratic' Regimes: The Politics of Seizing Contested Territories", Political Geography, 23, 6:647-676, August 2004.
53. Zakaria, Fareed, (1997), "The Rise of Illiberal Democracy", Foreign Affairs 76 (November-December 1997): 22-43.
54. Živanovic, M. (2005), "U BiH ne živimo kao ljudi, nego kao Srbi, Hrvati i Bosnjaci", (2005, May 22) Oslobodjenje, Sarajevo.

Foto Duro

SISTEMI I PENSIONIMIT NË FORCAT E ARMATOSURA TË SHQIPËRISË

Abstrakt

Me gjithë deklaratimet glorifikuese që politika ka bërë herë pas here ndaj ushtarakëve, përballjet e vijueshme me shtetin nga ana e shoqatave të ushtarakëve në rezervë, por edhe e individëve, qofshin ato në gjykata apo në sheshe mitingjesh, dëshmojnë një realitet tjetër. Një prej aspekteve kryesore është përkujdesja ndaj ushtarakëve të liruar në fushën financiare, e cila, e provuar tashmë edhe me dy vendime të Gjykatës Kushtetuese, ka ardhur duke u reduktuar ndjeshëm. Ky fakt është mbuluar disi në një “miksturë” ligjesh, të vështira për interpretim. Në këtë shkrim, nëpërmjet analizës ligjore, llogaritjeve konkrete dhe krahasimeve me përvoja të tjera, synohet qartësimi i kësaj çështjeje, duke ofruar edhe rekomandime, për një të drejtë që po prodhon jo pak tension në radhët e ushtarakëve të liruar.

Hyrje

Për mbi një dekadë, politikanët e lartë shqiptarë u janë drejtuar ushtarakëve: “Ne ju mbajmë çdo ditë në mendje, në zemër dhe në vlerësimin tonë... la keni rritur shumë emrin Shqipërisë... Të gjithë ne së bashku jemi krenarë për ju, për gatishmërinë, për sakrificat, për profesionalizmin dhe për kontributin tuaj madhor... Jeni në pararojë të zhvillimeve të të gjithë shoqërisë sonë”¹. Në fakt, me gjithë respektin për sakrificat, kontributin ndaj shoqërisë

1. Janë përmendur vetëm këto dy kategori gradash, pasi përbëjnë shumicën dërmuese të oficerëve që shkëputen nga shërbimi aktiv. Ushtarakët me gradë “kolonel”, gjithashtu e vuajnë këtë problem pasi janë të detyruar të shkëputen në moshën 55-vjeçare, por kjo kategori përbën rreth 3 % të gjithë numrit të oficerëve.

dhe qenien “në pararojë të zhvillimeve” të vendit, mbetet ende e debatueshme nëse shteti e shoqëria shqiptare kanë arritur të kujdesen për Forcat e Armatosura e t’u sigurojnë përkujdesje, në të njëjtën shkallë me meritat.

Dikur, në një takim të nivelit të lartë, një ushtarak anglez u shpreh se përkujdesja ndaj ushtarakëve të liruar është jo vetëm detyrim njerëzor për sakrificat dhe kontributet e tyre në FA Britanike, por edhe marketingu më i mirë për gjeneratën e re, për t’iu bashkuar forcave të armatosura.

Përkujdesja ndaj ushtarakut si “detyrim moral”, por edhe si “marketing”, janë pa dyshim dy linja të rëndësishme në strategjinë dhe masat përkatëse, për mbajtjen e një force të armatosur të shëndetshme për nga vlerat, kompakte për nga kohezioni i brendshëm dhe në përtëritje të vijueshme për nga qarkullimi i gjeneratave.

Sfidat për ushtarakun shqiptar

Janë të njohura vështirësitë e profesionit të ushtarakut. Ato ekzistojnë, pa dyshim, në kohë lufte, kur kërkohet deri sakrifika më sublime, por edhe në kohë paqeje, ku ushtarakut i kërkohet përbalja me vështirësi e privacione të shumëllojshme, punë pa orar², duke nxjerrë shpesh në plan të dytë nevojat e veta apo familjare. Gjatë gjithë karrierës, atij i kërkohet të pranojë një numër privimesh nga të drejtat themelore të njeriut. Kështu, në dokumentet bazë, si “Statusi i Ushtarakut të RSH-së” dhe një numër ligjesh e kodesh që rregullojnë marrëdhëniet e ushtarakut tonë me shtetin dhe shoqërinë, mund të numërohen mbi njëzet “ndalime”³, që nga e drejta për organizim në sindikata, për greva e protesta, deri tek ajo për të lëvizur (jashtë shtetit) për të ndjekur shkollime të tjera (pa leje) etj. Përveç kësaj, në raport me civilin, për të njëjtën shkellje ligjore, ushtaraku zakonisht dënohet më rëndë (moralisht, nga opinioni publik, por në disa raste edhe juridikisht).

Privimeve e vështirësive të mësipërme u shtohet edhe fakti që për vetë natyrën e profesionit, ku kërkohet ruajtja e një numri parametrash

2. Në bazë të Ligjit Nr. 9210, datë 23.03.2004, “Për Statusin e Ushtarakut në FARSH”, Neni 31.2, puna jashtë orarit dhe në ditë pushimi nuk paguhet.

3. Shih: Ligji Nr. 9210, datë 23.03.2004, “Për Statusin e Ushtarakut në FARSH”, nenet 11.1; 13.2; 16ç, dh, ë; 17c, ç, dh; 19a-ç; 31.2; 46.1 etj.

fizikë, ushtaraku duhet (me ligj) të shkëputet nga FASH-ja⁴ në një moshë relativisht të re, mesatarisht 44 vjeç (për majorin) dhe 49 vjeç për nënkolonelin⁵. Nga ana tjetër, pensionin e plotë, si për çdo shtetas tjetër të RSH-së, ai e përfiton në moshën 65 vjeç. Probleme të ngjashme ekzistojnë edhe për kategorinë e nënoficerëve, ndërsa për atë të ushtarit profesionist, në rastin kur nuk arrin t'i bashkohet kategorisë së "nënoficerit", aktualisht nuk ka asnjë perspektivë punësimi afatgjatë në FASH (rrjedhimisht asnjë benefit pas lirimt).

FASH-të ende po përballen me vështirësi për prurje të reja në cilësinë dhe sasinë që u nevojiten. Duke iu referuar përvojës së vendeve të tjera, të cilat gjithashtu kanë kaluar në sistemin e ushtrisë profesioniste, konstatohet fakti që, falë një numri politikash favorizuese për individin, është arritur, p.sh., që në Britaninë e Madhe të aplikojnë për një vend pune në forcat e armatosura 9-10 veta, për Spanjën ky tregues është 6:1, për Sllovakinë 5:1, ndërsa për Republikën Çeke 4:1. Në rastin e vendit tonë, ky raport nuk shkon më shumë se 1,5:⁶. Është e kuptueshme që sa më i madh të jetë numri i aplikantëve për një vend pune, aq më të shumta janë mundësitë e institucionit për zgjedhje, pra edhe për cilësi më të lartë. Treguesi i ulët i aplikimeve për rekrutim në FASH, ndër të tjera, shpjegohet edhe me efektin frenues që ka pasur sistemi i përkujdesjes ndaj ushtarakut shqiptar pas lirimt nga shërbimi.

Hyrja e Shqipërisë në proceset demokratike të fillim viteve '90, përveç të tjerash, përcaktoi edhe një qasje të re ndaj sigurisë e mbrojtjes së vendit, e inkuadruar tashmë në një kontekst euroatlantik. Kjo u shoqërua me reduktim drastik të FASH-së në vitin 1992⁷, por edhe më pas, duke krijuar një masë të madhe të liruarish. Ata nuk mund të liheshin pa u mbështetur financiarisht, për shkak të ndikimit social, por edhe të faktit që

4. Shih: Ligji Nr. 9171, datë 22.01.2004, "Për gradat dhe karrierën ushtarake në FARSH", Neni 11.

5. Janë përmendur vetëm këto dy kategori gradash, pasi përbëjnë shumicën dërmuese të oficerëve që shkëputen nga shërbimi aktiv. Ushtarakët me gradë "kolonel", gjithashtu e vuajnë këtë problem pasi janë të detyruar të shkëputen në moshën 55-vjeçare, por kjo kategori përbën rreth 3 % të gjithë numrit të oficerëve.

6. Studim i Shtabit të Përgjithshëm të FASH-së, janar 2010.

7. Aktualisht, ndërsa komponenti aktiv i FASH-së (përfshi edhe punonjësit civilë) numëron rreth 10 500 veta, numri i ushtarakëve që trajtohen me pension të parakohshëm apo të plotë arrin në rreth 26 600 veta (gazeta "Ushtria", 28.12.2012, f. 13).

shteti kishte prishur në mënyrë të njëanshme e të beftë një kontratë (megjithëse të pashkruar) me ta.

Nga sa më sipër, natyrshëm dalin disa pyetje: Në kushtet e një force ushtarake profesioniste, pra në kushtet kur vendimi për t'iu bashkuar forcës së armatosur është thjesht zgjedhja individuale e gjithsecilit, sa të fuqishëm janë nxitësit për këtë zgjedhje? Cilët janë këta nxitës? A ka një kombinim të drejtë të nxitësve materialë me ata moralë? A ka një kompensim të drejtë, në formë benefitesh për privimet e përmendura më lart? Ky “set” pyetjesh merr kuptim nëse zgjidhet qartë e përfundimisht pyetja më kryesore: Në ç'masë ka nevojë sot shoqëria shqiptare për FASH? Në perceptimin e publikut, madje edhe të politikanëve shqiptarë, sa konsiderohen të kërcënuara sot interesat kombëtare dhe a e konsiderojnë ata FASH-në si garantuese të sigurt të këtyre interesave, duke realizuar proporcionalisht me këtë edhe përkujdesjen ndaj ushtarakut?

Për shumicën e pyetjeve të mësipërme, aktualisht mungojnë studime të mirëfillta, prandaj për to mund të gjykohet në të dhëna të tërthorta. Politikat e pensionimit dhe përkujdesjes ndaj ushtarakut, pas shkëputjes nga FASH-ja, hedhin jo pak dritë dhe ndihmojnë të nxirren disa konkluzione në lidhje me pyetjet e mësipërme. Për këtë arsye, ato janë vënë në objekt të këtij materiali.

Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Rregullimi ligjor i marrëdhënieve të shtetit e shoqërisë me ushtarakun u tentua relativisht herët, qysh në korrik 1991⁸, por ky “nxitim”, megjithëse i përligjur për shkak të situatës, u shoqërua me probleme ligjore si dhe me paqartësi konceptuale, rrjedhojë e mungesës së një strategjie në lidhje me burimet njerëzore në FASH. Duke studiuar përvojën e një numri vendesh të tjera, konstatohet se është pikërisht “Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore” që ndriçon konceptualisht rrugën dhe imponon përgatitjen e bazës ligjore në mbështetje të saj. Në vendin tonë ka ndodhur e kundërta, janë përgatitur aktet ligjore dhe pas kësaj është shkruar “Strategjia e Menaxhimit të Burimeve

8. Kjo u realizua me Ligjin Nr. 7496, datë 3.7.1991, “Për Statusin e Ushtarakut të RSH”-së.

Njerëzore të FASH"-së⁹, dokument i cili nuk e shtron fare nevojën dhe nuk e ka as forcën të ndikojë për ndryshime të drejta ligjore. Ky dokument ka vlera për një qasje të re që ofron ndaj burimit njerëzor të FASH-së, por duke parë përvojën e vendeve të tjera kjo qasje duhej të ishte më e evidente. Kështu, në dokumentin përkatës britanik, fokusi është qartas te njeriu: "...duke vendosur ushtarakët tanë në qendër të planeve tona, duke investuar për ta e duke u dhënë atyre dhe familjeve të tyre sigurinë për të ardhmen..."¹⁰. Ndërsa në dokumentin shqiptar fokusi vendoset te kapacitetet ushtarake duke e parë njeriun më shumë si mjet për këtë qëllim: "...njerëzit përbëjnë burimin më të rëndësishëm në Forcat e Armatosura. Investimi në aftësitë dhe cilësitë njerëzore është synimi ynë kryesor, i cili shton vlerat e kapaciteteve tona ushtarake"¹¹. Në këtë çështje, dokumenti hungarez zë një vend të ndërmjetëm me formulimin: "...personeli, para së gjithash është një burim, më i rëndësishmi kapital i qëndrueshëm i mbrojtjes, i cili duhet zhvilluar... vendosja e harmonisë midis interesave të organizatës dhe individëve është një çështje e rëndësishme"¹².

Kuadri ligjor ekzistues

Kuadri ligjor mbi të cilin mbështetet kujdesi ndaj ushtarakut të liruar nga FASH-ja, përbëhet nga dy blloqe kryesore: kuadri ligjor për sigurimet shoqërore në RSH dhe kuadri ligjor për kujdesin ndaj ushtarakut të FARSH-së. Për bllokun e parë, baza është Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në RSH", ndërsa për të dytin, duhej të ishte Ligji Nr. 9210, datë 23.04.2004, "Për statusin e ushtarakut të FARSH", i plotësuar më tej nga disa akte të tjerë ligjorë. Praktikisht, produkti i këtyre dy paketave është i tillë që vështirëson së tepërmi mbrojtjen

9. Dokumenti aktual, "Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në FASH" është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes, Nr. 1778, datë 02.11.2011.

10. Armed Forces Overarching Personnel Strategy, British Ministry of Defense, London, 2003, f. 8.

11. Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të FASH-së (02.11.2011), f. 5.

12. Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në FA-në Hungareze, 2008-2017", broshurë, botim i Ministrisë së Mbrojtjes të Hungarisë, f. 14.

ligjore, duke dëshmuar njëkohësisht një punë të nxituar jo aq profesionale e në ndonjë rast jo aq serioze. Kështu, Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993, është amenduar deri më tani 15 herë. Në ndonjë rast kjo ka ndodhur dy herë brenda 4 muajve¹³.

Ligji Nr. 9210, datë 23.03.2004, "Për statusin e ushtarakut...", synoi disa rregullime të mangësive të "Statusit..." të mëparshëm¹⁴, prej të cilave, dy më kryesoret ishin: a) ndarja në trajtim e ushtarakëve të liruar para vitit 1991 prej atyre që do të liroheshin pas këtij viti; b) sanksionimi i të drejtave në letër e mosrespektimi i tyre në praktikë. Në fakt, në letër kanë mbetur një numër përfitimesh të parashikuara edhe në "Statusin" aktual¹⁵, pasi ato nuk u mbështetën me akte të tjera nënligjore, apo me krijimin e zërave të veçantë në buxhetin e mbrojtjes, të dedikuar për këto përfitime. Për sa i përket ndarjes së ushtarakëve në kategori, "Statusi" aktual, e hoqi formalisht këtë ndarje, por me aktet e tjera ligjore vijuese, kjo ndarje u rikthye. Për këtë ndarje, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e vet Nr. 09, datë 26.02.2007, pasi i referohet Kushtetutës së RSH-së (Neni 18) dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (Neni 14)¹⁶ konkludon: "... një diferencim i tillë nuk ka sesi të përligjet me ndarjen kohore, sepse vetëm data e daljes në pension nuk mund të përbëjë kriter objektiv dhe të arsyeshëm që do të justifikonte diskriminimin"¹⁷, prandaj vendos shfuqizimin e neneve që ligjërojnë këtë ndarje. Pavarësisht nga kjo, në aktet ligjore të nxjerra më pas, kjo ndarje

13. Ky është viti 2006, kur Ligji në fjalë u amendua me Ligjin Nr. 9498, datë 03.04.2006 dhe Ligjin Nr. 9600, datë 27.07.2006.

14. I pari status për ushtarakun e FARSH-së, u miratua me Ligjin Nr. 7496, datë 03.07.1991.

15. Në Statusin në fjalë, sanksionohen një numër të drejtash për ushtarakun, të cilat ose janë realizuar përkohësisht, për një numër të kufizuar ushtarakësh, ose nuk janë përfituar fare, të tilla si: ndihma për banesë nëpërmjet kredisë ose rimbursimit (deri 80%) të qirasë, rimbursimi i barnave (80 %), trajtim shëndetësor falas, jo vetëm në institucionet shtetërore, por edhe private, kompensim për ushqim, e drejta e parablerjes së objekteve ushtarake të dala të lira nga ristrukturimi, e deri tek ankesat individuale apo në grup, ceremoni ushtarake dhe përballim nga shteti i shpenzimeve për varrim etj.

16. Shih: Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së, Nr. 09, datë 26.02.2007, f. 5.

17. Po aty, f. 7 dhe 12.

ka mbetur e pacenuar, me argumentin e pamundësisë së buxhetit të shtetit për të përballuar efektet financiare, për shkak të numrit të madh të ushtarakëve të liruar, si rezultat i reformave, në dy dekadat e fundit.

Aktualisht, masa e ushtarakëve të liruar nga FASH-ja (që trajtohet me pagesë kalimtare, pension të parakohshëm apo të plotë) është rreth 26 600 veta¹⁸. Duke pasur parasysh që forca aktive sot arrin në rreth 10 500 veta, rezulton një raport 1:2,5 midis këtyre dy kategorive. Në përgjithësi të gjitha vendet (e hapësirës euroatlantike) për shkak të reduktimeve të forcave të armatosura pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, përballen me detyrimin për të trajtuar sipas skemave të tyre të pensioneve, një masë relativisht të madhe të liruarish. Shqipëria këtu nuk përbën ndonjë rast të veçantë. Në FA-në britanike, komponenti aktiv arrin në rreth 200 mijë veta, ndërsa në total trajtohen financiarisht rreth 900 mijë veta (personel aktiv, në rezervë, në pension, veteranë lufte, të afërm të ushtarakëve) që do të thotë një raport 1:4,5¹⁹. Siç shihet, në krahasim me Shqipërinë, raporti në fjalë, në Britaninë e Madhe është më i disfavorshëm²⁰.

Ligji Nr. 9210 "Për statusin e ushtarakut", praktikisht është shfuqizuar nga ligje të dala më vonë, të cilat, në fakt, duhej të zhvillonin e detajonin më tej kërkesa të veçanta të "Statusit...". Kjo paraqet, së pari, probleme ligjore, pasi Ligji "Për statusin...", duke qenë një ligj organik, nuk mund të shfuqizohet nga ligje të tjerë të zakonshëm²¹. Gjithashtu, gjithë paketa e akteve ligjore të dala për të mbështetur e detajuar më tej Ligjin "Për statusin", në fakt e kanë ulur masën e përfitimit për ushtarakët e liruar (në raport me "Statusin e ushtarakut...") duke shpërfillur edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të dala posaçërisht për këto

18. Gazeta "Ushtria", 28.12.2012, f. 13.

19. Shih në internet: <https://www.gov.uk/pensions-and-compensation-for-veterans>.

20. Këtu mund të silleshin edhe shembuj të tjerë, kështu FA-ja hungareze pësoi një reduktim prej rreth 125 mijë vetash në rreth 25 mijë (aktualisht jo të gjithë të liruarit janë subjekt i skemës së pensioneve). Në internet: <http://www.zmne.hu/aarms/docs/Volume9/Issue1/pdf/08.pdf>

21. Kështu, Ligji Nr. 10142, datë 15.05.2009, me Nenin 31, shfuqizon disa nene të Ligjit Nr. 9210, datë 23.03.2004, "Për Statusin e Ushtarakut...", megjithëse ky i fundit, në bazë të Kushtetutës, Neni 81, pika 2/e, miratohet me shumicë të cilësuar (3/5 e gjithë anëtarëve të Kuvendit).

çështje. Kështu, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 09, datë 26.02.2007, shfuqizon Ligjin Nr. 9481, datë 16.02.2006, duke e konsideruar atë “jo në përputhje me parimet kushtetuese” (Vendimi, f. 4). Po kështu, në këtë Vendim përcaktohet që “... ndryshimet e bëra nuk kanë respektuar kërkesat kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të fituara” (f. 9). Pavarësisht nga kjo, Ligji Nr. 10142, datë 15.05.2009 e sanksionon përsëri një ulje të tillë të masës së përfitimit. Gjykata Kushtetuese shprehet edhe një herë ndaj këtij ligji, me Vendimin Nr. 33, datë 24.06.2010, ku midis të tjerave, interpreton Nenin 14/2 të Ligjit 10142 (i cili duke vendosur tavane, praktikisht e ul ndjeshëm masën e përfitimit). Sipas Gjykatës Kushtetuese: “...Nenet 14/2 dhe 27 të Ligjit Nr. 10142, datë 15.05.2009, ‘Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve...’, janë të papajtueshme me Kushtetutën, sepse cenojnë parimin e sigurisë juridike²² dhe si të tilla duhen shfuqizuar”²³, prandaj Gjykata Kushtetuese ka vendosur: “Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 2 të Nenit 14, si dhe të Nenit 27 të Ligjit Nr. 10142, datë 15.05.2009, ‘Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve...’”²⁴.

Me gjithë interpretimet e bëra nga Gjykata Kushtetuese, në dy vendimet e përmendura më lart, të cilat në esencë theksojnë respektimin e parimit të sigurisë juridike, pra ruajtjen e një të drejte të fituar më parë, aktet vijues, sanksionuan ulje të mëtejshme të përfitimeve për ushtarakun e liruar. Kështu, VKM-ja Nr. 793, datë 24.09.2010, futi konceptin e “Pagës mesatare referuese mujore”, të llogaritur për të gjithë periudhën e shërbimit të ushtarakut në FASH. Në këtë mënyrë, ndryshe nga të gjitha praktikat e njohura në lidhje me pensionet, baza për llogaritjen e pensionit të ushtarakut do të ishte mesatarja e gjithë pagave të tij (referuese) gjatë gjithë karrierës ushtarake, duke shkaktuar një ulje të ndjeshme të përfitimeve të ushtarakut të liruar nga FASH²⁵. Akti Normativ Nr. 05, datë 10.11.2010 e thelloi më tej

22. Parimi i sigurisë juridike ka të bëjë me mbrojtjen e një të drejte të fituar. “...shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë, vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese” (Vendim i Gjykatës Kushtetuese, Nr. 09, datë 26.02.2007, f. 8).

23. Vendim i Gjykatës Kushtetuese, Nr. 33, datë 24.06.2010, f. 20, paragrafi 2.

24. Po aty, paragrafi 3.

këtë ulje nëpërmjet sanksionimit të pagës neto mesatare për gjithë vitet e shërbimit dhe vendosjes së kontributit suplementar 5 %²⁶ për t'u paguar nga ushtaraku aktiv. Tabela e mëposhtme pasqyron më qartë efektet e këtyre uljeve²⁷:

Është e kuptueshme që për shkak të efektit “kaskadë”, zbritja

Baza e llogaritjes për pension, sipas akteve ligjore (në raport me “Statusin...”)						
Akti	Oficer				Nënoficer	
	Major	N/Kol	Kolonel	Gj. Brig.	Kapter	K/Kapter
Ligji Nr. 10142, datë 15.05.2009 ²⁸	87 %	75 %	65 %	59 %	85 %	78 %
VKM Nr. 739, datë 24.09.2010 ²⁹	72,7 %	60,7 %	51,9 %	46,6 %	66 %	60,7 %
Akt Norm. Nr. 05, datë 10.11.2010 ³⁰	65,6 %	54,7 %	46,8 %	42,1 %	62,8 %	57,7 %

e bazës llogaritëse në nivele të tilla, jep efekte të mëtejshme zbritëse në rezultatin e fundit, për llogaritjen konkrete të përfitimit të çdo ushtaraku. Paraqitja grafike (fig. 1) jep një pamje më të qartë të uljeve që ka pësuar baza e llogaritjes së përfitimeve të ushtarakut, për shkak të këtyre akteve, duke evidentuar njëkohësisht tendencën barazuese të këtyre përfitimeve drejt nivelit më të ulët, pavarësisht nga grada e përfituesit.

Ngritja e zërit nga shoqatat e ushtarakëve në rezervë në lidhje me reduktimet e mësipërme është kundërshtuar nga disa institucione shtetërore me argumentin e rritjes së konsiderueshme të pagave të ushtarakëve në 2-3 vitet e fundit. Tabela me të

25. Për të kuptuar teknikën e llogaritjes si dhe masën e shpërblimit që një ushtarak humbet me këtë mënyrë llogaritje, shih shtojcën 1.

26. Kontributi 5 %, i detyruar me Aktin Normativ Nr. 05, datë 10.11.2010, Neni 2, paguhet vetëm nga ushtarakët dhe punonjësit e policisë së shtetit. Për nëpunësit civilë (deri drejtor drejtorie në ministri) ky kontribut është 2 % - 3 % (shih Ligji Nr. 9061, datë 08.05.2003, Neni 2 dhe Ligji Nr. 8097, datë 21.03.1996, Neni 1/9).

27. Në tabelë nuk janë paraqitur gradat e ulëta, pasi ato, për shkak të vjetërsisë së pamjaftueshme (nën 15 vjet) nuk përfitojnë pension (të parakohshëm apo suplementar) kur shkëputen nga FASH-ja.

28. Ligji Nr. 10142, sanksionoi “Pagën referuese mujore” dhe pagesën e kontributit suplementar 2 %, së bashku me disa tavane kufizuese.

29. VKM Nr. 739 sanksionoi “Pagën mesatare referuese mujore” të llogaritur për të gjithë kohën e shërbimit të ushtarakut.

30. Akti Normativ Nr. 05 sanksionoi “Pagën mesatare referuese mujore - neto” dhe pagesën e kontributit suplementar 5 %.

dhënat konkrete të këtyre rritjeve, dhënë në “shtojcën 2”, tregon se këto rritje nuk kanë qenë në nivelin e pretenduar. Ato kanë hyrë në fuqi në mesin e vitit (gjë që e përgjysmon rritjen vjetore) duke pasur një efekt nga 1 % në 3,5 % në vitin 2011 dhe nga 0,5 % në 0,9 % në vitin 2012. Nga ana tjetër, aplikimi i pagesës nga ushtaraku të kontributit suplementar 5 %, jo vetëm i zhvlerëson rritjet e përmendura më lart, por praktikisht ka bërë që e ardhura vjetore e tij të ulet.




Fig. 1. Reduktimi i bazës së llogaritjes së përfitimit për ushtarakun
1 - Statusi, 2 - Ligji 10142, 3 - VKM 793, 4 - Akti Normativ Nr. 05

në lidhje me qëndrimin e shtetit ndaj individit. Kështu, në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH” (i cili është amenduar 15 herë), ende ekziston Neni 32/4 me përmbajtjen: “Shuma e përgjithshme e pensionit do të jetë jo më shumë se dyfishi i shumës bazë, ose 75 % e pagës neto mesatare të 3 vjetëve rresht të 10 vjetëve të fundit të punës së personit të siguruar, cila të jetë më e vogël”.

Në Ligjin Nr. 10142, datë 15.05.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar...”, në Nenin 12/1 përcaktohet e drejta e ushtarakut që lirohet, për të marrë “dy paga referuese mujore si shpërblim i menjëhershëm”, ndërsa në pikën 2 të po këtij Neni, përcaktohet e drejta për t’u trajtuar me pagë kalimtare, e cila “fillon në muajin e tretë nga dalja në rezervë apo lirim”, gjë që e zhvlerëson kuptimin e “shpërblimit të menjëhershëm” të përmendur në të njëjtin nen³¹. Këtyre

31. Një numër vendesh e aplikojnë shpërblimin e menjëhershëm për ushtarakun e liruar (pavarësisht pensionit). Në Greqi ky shpërblim është tetë paga mujore, kurse në Britaninë e Madhe, tre pensione vjetore (studim i Shtabit të Përgjithshëm të FASH-së, 09.03.2009).

Aktet ligjore për sigurimet shoqërore, duke qenë të destinuara për mbrojtjen e kategorive sociale vulnerable, duhet të bëjnë kujdes deri në mënyrën e formulimit, me qëllim dhënien e mesazhit pozitiv të përkujdesjes së shtetit e shoqërisë për këto kategori. Në legjislacionin shqiptar ka formulime e teknika llogaritëse që krijojnë një përshtypje aspak pozitive

neneve u shtohen nene të tjera ku përcaktohen tavane kufizuese³² të cilat të gjitha së bashku krijojnë perceptimin e një trendi sistematik për të zbritur sa më shumë nga përfitimi që ushtarakut të liruar i njeh Ligji Nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut në FARSH”.

Transparenca

Transparenca ka një rol të pazëvendësueshëm për besimin reciprok midis individit dhe institucionit, në zbutjen e “fërkimeve” të brendshme dhe forcimin e kohezionit. Ajo ka një numër aspektesh e fushash aplikimi. Në lidhje me politikat e pensionimit dhe mbështetjes të ushtarakëve, ajo megjulohet së tepërmi për shkak të vështirësisë për t’u orientuar e për të interpretuar kuadrin ligjor përkatës. Vetë amendimet e herëpashershme që u janë bërë ligjeve në fjalë, ndërvarësia dhe referimi i neneve të një ligji, tek ato të një ligji tjetër paraardhës, paraqesin një sfidë të vërtetë edhe për specialistin e fushës. Në mënyrë të veçantë, futja e konceptit të “pagës mesatare referuese mujore neto”, të përmendur më lart, e ka vështirësuar, në mos e ka bërë të pamundur llogaritjen e të drejtave financiare nga vetë personi i interesuar. Në shumë raste kjo ka sjellë mosbesim nga individ, konflikte me institucionet përkatës (FASH apo Sigurimet Shoqërore) deri në procese gjyqësore që zgjaten pa fund. Komplikimi i procedurave të llogaritjes së pensioneve për ushtarakët e liruar provohet edhe me faktin që, megjithëse përfundimi i llogaritjeve sipas kuadrit të ri ligjor u vu si detyrë parësore në Direktivën e ministrit të Mbrojtjes të vitit 2012³³, për pamundësi realizimi u përsërit edhe në Direktivën e vitit 2013³⁴, me të gjitha gjasat për shtyrje tjetër në kohë.

32. Tavane kufizues janë vendosur në Nenet 14 e 16 të Ligjit 10142, datë 10.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar...” dhe Neni 3/1 i Aktit Normativ Nr. 05, datë 10.11.2010 (i cili e ul nga 2 % në 1,5 % përfitimin për çdo vit shërbimi, mbi 15 vjet, për ushtarakët që përfitojnë pension të parakohshëm).

33. Direktiva e Mbrojtjes - 2012 përcaktonte gjashtëmujorin e parë të vitit 2012, për përfundimin e kësaj detyre, në internet: http://www.mod.gov.al/images/direktiva_e_mbrojtjes2012.pdf, f. 8.

34. Direktiva e Mbrojtjes - 2013 e përsërit këtë detyrë, duke vendosur si afat gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, në internet: <http://www.mod.gov.al/images/direktiva2013.pdf>, f. 5.

Praktikat e vendeve të tjera janë shumë më të thjeshta. Kështu, në sistemin anglez, pensioni (i parakohshëm ose i plotë) për ushtarakun llogaritet me një formulë³⁵ të vetme: $P = PgV \times NrV \times 1/70$ ku P është pensioni që i takon ushtarakut, PgV është paga më e lartë vjetore në tre vitet e fundit të shërbimit, NrV është numri i viteve në shërbim dhe 1/70 një koeficient i njëjtë për çdo ushtarak. Duke ditur dy të dhënat (Pgv e NrV) çdo ushtarak shqiptar mund ta llogarisë shumë thjesht shumën për pension, për kolegun e vet anglez, ndërkohë që e ka gati të pamundur të llogarisë e të jetë i bindur për pensionin e vet.

Në mbështetje të nevojës për praktika më transparente e më të thjeshta, flet edhe numri i madh i padive të bëra në gjykata nga ushtarakët e liruar, për llogaritjet e pasakta (të pretenduara prej tyre) të pensioneve. Kështu, nga një vëzhgim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vetëm për periudhën 11 janar deri 7 shkurt 2013, pra për më pak se një muaj, rezultojnë të regjistruara 51 padi të reja³⁶, të ngritura kundër Institutit të Sigurimeve Shoqërore me objekt "...rillogaritjen e pensionit". Në total, nisur nga disa deklarime të drejtuesve të shoqatave të ushtarakëve, gjykohet që vetëm çështje gjyqësore të fituara shkojnë në rreth 1000³⁷.

Integrimi/punësimi në jetën civile

Vështirësitë në funksionimin e sistemit të pensionimit të ushtarakëve të FASH, mund të lehtësoheshin disi nëpërmjet politikave më të qarta e më efektive të punësimit të tyre, pas lirimit nga forcat e armatosura, duke u integruar në sektorin civil. Kjo favorizohet nga mosha relativisht e re, por edhe edukimi i marrë në FASH. Aktualisht, këto politika mungojnë. Natyrisht,

35. UK Armed Forces Pensions Scheme (MMP/124), f. 9, në internet: www.armedforcespensions.mod.uk.

36. E para çështje regjistruar në këtë Gjykatë, me objektin në fjalë, ka Numrin 7919 dhe mban datën 11.01.2013, ndërsa e fundit për periudhën në studim (11 janar - 7 shkurt 2013) ka Nr. 9409 dhe datë 07.02.2013, në total, për këtë periudhë, vetëm në Gjykatën e Tiranës janë regjistruar 51 çështje të reja gjyqësore.

37. Shih intervistën e Kujtim Çakos, president i AKUSH-së, për gazetën "Telegraf", në internet <http://gazetatelegraf.com/euromil-dhe-ushtaraket-shqiptare/>.

një pjesë e ushtarakëve të liruar kanë mundur të punësohen me përpjekjet e veta, në kushte pune e pagese, përgjithësisht të papërshtatshme për ta dhe për marketingun e synuar të FASH-së. Në Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të përmendur më lart, ka formulime të tipit: "...do të zhvillojmë një program mirënjohje për personelin që ka shërbyer në FA", "...do të bashkëpunojmë me institucionet e tjera qeveritare dhe private për riintegrimin e personelit...", "...do t'i përfshijmë ata në njoftimet për të aplikuar në pozicionet e lira civile të MM-së e FA-së..."³⁸. Në fakt, ato nuk kanë mundur të zhvillohen më tej, në dokumente të tjerë detyrues, programe pune, marrëveshje ndërminstrore etj., për të pasur ndonjë efekt konkret.

Duke iu referuar sërish përvojës angleze, konstatohet se për këtë qëllim janë përpiluar 5 politika të veçanta. Në to, veç deklarimit të detyrimit të shtetit për përkujdesje ndaj ushtarakëve të liruar, paraqiten programe për riintegrimin e tyre në jetën civile. Çdo vit, FA-ja sritanike i siguron tregut civil të punës rreth 17-18 mijë ish-ushtarakë të trajnuar kënaqshëm për t'u integruar në të³⁹. Në këtë aspekt, një nga objektivat e FA-së britanike është që "...jo më pak se 85 % e ushtarakëve të liruar të punësohen brenda 6 muajve të largimit nga shërbimi ushtarak"⁴⁰.

Në SHBA punësimi i ushtarakëve të liruar është marrë në dorë nga vetë Shtëpia e Bardhë. Janë bërë praktike tashmë takimet midis Departamentit të Mbrojtjes, Departamentit të Veteranëve dhe kompanive të mëdha private. Aktualisht kompania më e madhe tregtare "Wal-Mart"⁴¹ ka shpallur planet për të punësuar, brenda 5 vjetëve, 100 mijë ushtarakë të liruar. Sipas presidentit të "Wal-Mart"-it: "Ky është vendimi më i mirë...(pasi ata) kanë përvojën e punës nën presion. Ata mësojnë shpejt dhe janë të familjarizuar me punën në grup... me disiplinën, trajnimin dhe qëndrimin ndaj detyrës. Është serioziteti dhe ndjenja drejt qëllimit, të edukuara nga shërbimi ushtarak, të cilat na duhen ne

38. "Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në FASH", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes, Nr. 1778, datë 02.11.2011, f. 19.

39. UK Armed Forces Overarching Personnel Strategy, British Ministry of Defense, London, 2003, f. 7.

40. Po aty, f. 13.

41. Kompani private gjigante që vetëm në SHBA ka rreth 1,4 milionë punonjës.

sot më shumë se kurrë”⁴².

Riintegrimi i ushtarakëve të liruar është parë me efekt për të lehtësuar faturën e pensionimit edhe nga një numër vendesh të tjera. Kështu Bosnja, Serbia dhe Maqedonia kanë përfituar nga Trust-Funds dhe donacione të qeverive të tjera në vlera të konsiderueshme, pasi paraqitën programe të qarta për riintegrimin civil të ushtarakëve të liruar, ndërsa Kroacia këto programe i ka financuar nga buxheti i mbrojtjes. Për periudhën 2007-2012, Bosnja ka përfituar fonde për riintegrimin e ushtarakëve për një vlerë prej rreth 11,2 milionë euro, ndërsa Serbia rreth 12 milionë euro (për të njëjtën periudhë). Vetëm për trajnimin e ushtarakëve të liruar, Kroacia paguan rreth 2000 euro/person. Në FA-në hungareze, duke filluar nga viti 2000⁴³, janë aplikuar rreth 35 lloje kursesh trajnimi. Programet përfshijnë gjithashtu masa për informim, mbështetje psikologjike, konsultim, ndërmjetësim dhe sidomos trajnim profesional për t’iu përshtatur kërkesave të tregut të punës⁴⁴. Një numër vendesh të NATO-s janë ofruar me ndihmë financiare, asistencë teknike etj., në këto programe (në mënyrë të posaçme Norvegjia, Britania e Madhe, Holanda, Sllovenia etj.).

Problemet në përkujdesjen ndaj ushtarakëve shqiptarë të liruar, nuk mund ishin pa pasoja ndaj prurjeve të reja. Kështu, sipas një studimi të Shtabit të Përgjithshëm për vitin 2009, kompletimi i FASH-së në gradat “kapiten” e “major” (të cilat përbëjnë masën kryesore të oficerëve) ka qenë përkatësisht 38 % e 84 %, ndërsa konstatohet tendenca e largimit të oficerëve të rinj dhe specialistëve, për “arsye ekonomike”.

Përfaqësimi dhe lobimi

Aktualisht, duke gjykuar nga deklaratimet në media të krerëve të Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë dhe Shoqatës “Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë”⁴⁵, si dhe në një

42. <http://www.military.com/veteran-jobs/career-advice/2013/01/15/walmart-hiring-veterans.html?comp=7000024213943&rank=2>

43. <http://www.zmne.hu/aarms/docs/Volume9/Issue1/pdf/08.pdf>.

44. Burimi: Defense Conversion Modalities in South East Europe, Specific Regional Model, RACVIAC-Centre for Security Cooperation, October 2012, p.5-80.

numër demonstrimesh publike të tyre, rezulton se në radhët e ushtarakëve të liruar ka zhgënjim, ka njëfarë tensioni që vjen nga pritshmëritë e parealizuar, mungesa e transparencës, ndryshimi i disahershëm i “rregullave të lojës” prej qeverisë, të cilat kanë sjellë vetëm ulje të përfitimeve për ta. Gjykata Kushtetuese (sikurse është përmendur tashmë) është vënë dy herë në lëvizje prej tyre, kundër akteve ligjore të Qeverisë e Parlamentit, ndërsa po përgatitet tentativa e tretë në këtë Gjykatë⁴⁶. Megjithëse çështjet e mësipërme janë të karakterit jetik, tensioni mund të zbutet nëse do të ekzistonte një përfaqësim e lobim më i mirë. Në saje të tyre, do të kishte më shumë hapësirë për dialog e mirëkuptim, shteti do të ishte më i kujdesshëm në nismat që do të ndërmernte, ndërsa vetë ushtarakët e liruar do të krijonin besimin se zëri i tyre po dëgjohej më mirë, duke gjetur edhe zgjidhje të pranueshme.

Përfaqësimi i ushtarakëve sot bëhet nga dy shoqata të ndryshme, të cilat vetëm së fundmi kanë vendosur të bashkëpunojnë dhe për këtë është nënshkruar edhe një marrëveshje⁴⁷. Megjithatë, ato ende nuk kanë mundur të grupojnë rreth vetes gjithë masën e ushtarakëve të liruar, një pjesë e madhe e të cilëve, duke pasur më imediate sigurimin e mjeteve të jetesës për familjen, kanë lidhje të dobëta ose inekzistente me shoqatat e tyre. Për më tepër, krahas dy shoqatave kryesore, ka edhe organizime të tjera mbi bazë specialitetesh të ngushta⁴⁸ të cilat natyrshëm duke thelluar mungesën e unitetit midis ushtarakëve të liruar, pakësojnë shanset që të merren seriozisht nga institucionet shtetërore dhe gjithë shoqëria.

Për sa i përket lobimit, përjashtuar ndonjë deklaratë të bërë aty këtu, kryesisht në kohë fushatash, mungon pothuajse plotësisht edhe përçapja më e vogël në këtë drejtim. Aktualisht, 2-3 deputetë me kapacitet ushtarak dhe 2-3 të tjerë, që, për shkak të

45. Intervista më e fundit është dhënë nga Kryetari i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë, zoti Medi Pogaçe, në gazetën “Telegraf”, datë 14 shkurt 2013.

46. Zoti Medi Pogaçe, Kryetar i SHKUR-së, intervista në gazetën “Telegraf”, datë 14.02.2013.

47. Zoti Medi Pogaçe, Kryetar i SHKUR-së, intervista në gazetën “Telegraf”, datë 05.02.2013.

48. Janë mbi 12 shoqata të tjera më të vogla si ajo e aviatorëve, xhenerëve etj.

funksioneve të mëparshme, kanë shprehur njëfarë gatishmërie për të sjellë në parlament shqetësimet e ushtarakëve (aktivë apo të liruar), janë shumë pak për t'u konsideruar "lob" e "lobim". Është e pamundur të gjendet krahasimi më i vogël me vende të tjera ku lobet e proushtarakëve, të mbështetura nga industritë ushtarake respektive, janë faktorë që nuk mund të injorohen lehtë në parlamentet përkatëse, apo institucione të tjera të shoqërisë⁴⁹. Këto lobime duhen kuptuar drejt, si mekanizma balancash demokratike, por ato nuk mund të krijohen vetëm nga humanizmi, as mund të konsiderohen efektive, nëpërmjet deklaratave të shtetarëve të lartë. Lobimi ngrihet e funksionon mbi bazë interesash madhore, kur shoqëria apo grupe të caktuara të saj, shohin tek ushtarakët nevoja e role të qenësishme, të cilat nuk mund t'i përmbushin ndryshe.

Përfundime dhe rekomandime

1. Shqipëria ka e do të ketë nevojë për Forcat e Armatosura. Nga ana tjetër, standardet mbeten faktor i dorës së parë për këtë forcë, për rrjedhojë edhe tërheqja e individëve cilësorë në radhët e saj.

1.1. Për një vizion me të qartë në menaxhimin e personelit rekomandohet të rishikohet "Strategjia e menaxhimit të burimeve njerëzore" e cila, nga njëra anë, duhet të japë vizionin afatlargët për "thithjen" dhe menaxhimin e materialit njerëzor në FASH dhe, nga ana tjetër, duhet të ketë autoritetin të imponojë ndryshime rrënjësore në kuadrin ligjor dhe një numër masash të tjera, që kanë të bëjnë me kujdesin e shtetit dhe shoqërisë për ushtarakun shqiptar.

2. Kuadri ligjor ekzistues në mbështetje të ushtarakut, sidomos pjesa e legjislacionit që ka të bëjë me përkujdesjen ndaj tij pas lirimimit nga shërbimi aktiv, nuk ia ka arritur plotësisht qëllimit. Pjesë

49. Aktualisht anëtarët e Kongresit në SHBA, me kapacitet ushtarak, përbëjnë rreth 21 %, ose rreth 112 anëtarë (nga 535 gjithsej në Senat dhe në Dhomën e Përfaqësuesve). Kjo konsiderohet një shifër e vogël, pasi në periudha të tjera ata kanë përbërë deri 80 % të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kongresit. Aktualisht ata kryesojnë dy nga katër komisionet më të rëndësishme të sigurisë dhe mbrojtjes. Në internet: <http://edition.cnn.com/2011/US/01/20/congress.veterans/index.html>, ose: <http://www.usatoday.com/story/news/nation/2012/11/20/fewer-congress-vets/1716697/>.

të këtij legjislacioni janë në mospërputhje me ligje të tjera apo me vendime të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa një numër klauzolash krijojnë konfuzion për interpretim apo zbatim. Për sa më sipër rekomandohet:

2.1. Rishikimi e ripunimi i legjislacionit ekzistues me qëllim harmonizimin e tij me Ligjin “Për statusin e ushtarakut të FARSH”- së dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese (Nr. 09 e 33).

2.2. Shfuqizimi i asaj pjese të legjislacionit që merr si bazë llogaritjet për pensionimin e ushtarakut “pagën mesatare referuese neto”.

2.3. Puna për rishikimin e legjislacionit në fjalë të synojë gjithashtu homogenizimin e thjeshtimin e tij për t’i shërbyer në mënyrë më efektive përkujdesjes ndaj ushtarakut në shërbim aktiv apo të liruar.

3. Një numër përfitimesh të tjera për ushtarakun të njohura nga Ligji “Për statusin...” (përfshirë pagën apo pensionin) janë shkëputur dhe nuk aplikohen fare. Kuadri ligjor i rinovuar duhet t’i përfshijë e të krijojnë lidhjen e nevojshme me politikën dhe masat e tjera të trajtimit financiar e pensionimit.

3.1. Kuadri ligjor të përcaktojë detyrimin e institucioneve përkatëse (në mënyrë të posaçme Ministria e Mbrojtjes) për planifikimin e programimin e masave konkrete për garantimin e këtyre përfitimeve. Ndër detyrimet kryesore duhet të jenë: krijim i zërave të posaçëm në buxhetin e mbrojtjes dhe lidhja e marrëveshjeve detyruese përkatëse me institucione të tjera të shtetit.

3.2. Pjesë e kësaj mbështetje duhet të bëhet edhe asistencë juridike, falas, për ushtarakun (në shërbim aktiv apo të liruar) për kategori të caktuara çështjesh gjyqësore, sidomos ato që lidhen me mbrojtjen e të drejtat ligjore të ushtarakut.

4. Integrimi në jetën civile të ushtarakut të liruar, nëpërmjet programeve efektive të trajnimit e punësimit ka përfitime të shumëfishta e reciproke, për individin dhe shoqërinë.

4.1. Procesi i integritetit të ushtarakëve të liruar duhet të udhëhiqet direkt nga Ministria e Mbrojtjes duke koordinuar punën me institucione të tjera qendrore⁵⁰, organizata joqeveritare (sidomos me shoqatat e ushtarakëve të liruar e në pension) etj.

4.2. Të përgatiten e mbahen në gatishmëri programe të

50. Sidomos Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

posaçme për trajnim, informim, ndërmjetësim e vendosje kontaktesh me agjenci apo punëdhënës të interesuar, së bashku me një sistem monitorimi për njohjen në çdo kohë të gjendjes së punësimit të ushtarakëve të liruar.

5 - Përmirësimi e fuqizimi i përfaqësimit të ushtarakëve dhe lobimit në favor të tyre, po del si një nevojë e rëndësishme për të fuqizuar zërin e tyre, jo vetëm në lidhje me plotësimin e nevojave të veta, por edhe në një kontekst më të gjerë të përdorimit të ekspertizës së tyre në reformimin e sektorit të sigurisë.

5.1. Shoqatat aktuale të ushtarakëve të liruar duhet të gjejnë fushat e bashkëpunimit e të afrimit me njëra-tjetrën, në mos bashkimit në një organizatë të vetme.

5.2. Është e domosdoshme që ato të shpallin e të mbajnë një distancë të arsyeshme nga politika e ditës, duke u fokusuar më shumë në popullarizimin e problemeve e nevojave ekonomiko-sociale të ushtarakëve që përfaqësojnë.

5.3. Anëtarësimi i shoqatave shqiptare të ushtarakëve të liruar në Konfederatën Ndërraleate të Oficerëve në Rezervë (CIOR) është një hap pozitiv në forcimin e identitetit të tyre, por duhet të bëhet më shumë në tërheqjen prej Konfederatës të ekspertizës dhe mbështetjes së nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të ushtarakëve shqiptarë.

5.4. Në mungesë të një tradite lobuese për ushtarakët në Parlament, si dhe të mungesës së disa faktorëve tradicionalë në këtë aspekt, është e nevojshme të eksplorohej rrugë e mundësi të reja për këtë lloj lobimi, sidomos duke shfrytëzuar përvojat e vendeve të rajonit.

Shtojca 1:

Efekti zvogëlues i pagës mesatare referuese mujore (neto) në pensionin e ushtarakut

OFICERË

Grada	Vite shërbimi	Paga mujore	PMRMN - Paga mesatare refer. muj. - neto	PMRMN ndaj pag. më të mirë
N/Toger	1	44000	Nuk përfitojnë pension, vetëm një pagesë të menjëhershme (aq paga mujore sa vite shërbimi)	
	2	44000		
	3	45000		
Toger	4	47600		
	5	48800		
	6	48800		
	7	49700		
Kapiten	8	52000		
	9	52300		
	10	52300		
	11	53000		
Major	12	53000		
	13	58300		
	14	58300		
	15	59300		
N/Kolonel	16	59300	38889	65,6 %
	17	74100		
	18	74100		
	19	75300		
	20	75300		
Kolonel	21	76650	41949	54,7 %
	22	93500		
	23	95500		
	24	95500		
	25	97400	45628	46,8 %
Gj. Brig.	26	117000		
	27	117000		
	28	11700	49221	42,1 %

NËNOFICERË

Grada	Vite shërbimi	Paga mujore	PMRMN - Paga mesatare refer. Muj. - neto	PMRMN ndaj pag. më të mirë
Nëntetar	1	32300	Nuk përfitojnë pension, vetëm një pagesë të menjëhershme (aq paga mujore sa vite shërbimi)	
	2	32300		
	3	33100		
	4	34300		
Tetar	5	37700		
	6	37700		
	7	38100		
	8	38100		
Rreshter	9	39500		
	10	39500		
	11	41200		
	12	41200		
Kapter	13	43400		
	14	44700		
	15	46200		
	16	46200		
	17	47000		
	18	47000		
K/kapter	19	52400	29499	62,8 %
	20	52400		
	21	53500		
	22	53500		
	23	55100		
	24	55100		
	25	56200	32404	57,7 %

Shtojca 2:

Rritja e pagës së ushtarakut (tre vitet e fundit) sipas gradave ⁽⁵²⁾.

Grada	Vjetërsi pune	VKM				
		532/27.04.09	549/11.08.11		502/01.08.12	
		Paga	Paga	Rritja	Paga	Rritja
.Major	Mbi 12 vjet	53500	57350	7,2 %	58300	1,7 %
	Mbi 14 vjet	54400	58300	7,2 %	59300	1,7 %
	Mbi 16 vjet	55300	59300	7,2 %	60300	1,7 %
	Mbi 18 vjet	57000	61100	7,2 %	62200	1,8 %
	Mbi 20 vjet	58500	62650	7,1 %	63200	0,9 %
	Mbi 22 vjet	59300	63500	7,1 %	64500	1,6 %
	Rritja mesatare			7,2 %		1,6 %
.Nënkolonel	Mbi 14 vjet	67000	71700	7,0 %	72700	1,4 %
	Mbi 16 vjet	68200	73100	7,2 %	74100	1,4 %
	Mbi 18 vjet	69400	74350	7,1 %	75300	1,3 %
	Mbi 20 vjet	70600	75650	7,2 %	76650	1,3 %
	Mbi 22 vjet	71800	76800	7,0 %	77800	1,3 %
	Mbi 24 vjet	73000	78200	7,1 %	79200	1,3 %
	Mbi 26 vjet	74200	79400	7,0 %	80400	1,3 %
	Rritja mesatare			7,1 %		1,3 %
.Kolonei	Mbi 18 vjet	88500	91000	2,8 %	92000	1,1 %
	Mbi 20 vjet	90000	92500	2,8 %	93500	1,1 %
	Mbi 22 vjet	92000	94500	2,7 %	95500	1,1 %
	Mbi 24 vjet	93600	96400	3,0 %	97400	1,0 %
	Mbi 26 vjet	96000	98000	2,1 %	99000	1,0 %
	Rritja mesatare			2,7 %		1,1 %
.Gj. Brig.	Mbi 22 vjet	112000	115000	2,7 %	116000	0,9 %
	Mbi 24 vjet	114000	116000	1,8 %	117000	0,9 %
	Mbi 26 vjet	114000	116000	1,8 %	117000	0,9 %
	Rritja mesatare			2,1 %		0,9 %
Nënoficerët						
.Kapter	Mbi 12 vjet	40800	43700	7,1 %	44700	2,3 %
	Mbi 14 vjet	42200	45200	7,1 %	46200	2,2 %
	Mbi 16 vjet	42900	45990	7,2 %	47000	2,2 %
	Mbi 18 vjet	43500	46600	7,1 %	47600	2,1 %
	Mbi 20 vjet	45000	48200	7,1 %	49200	2,1 %
	Mbi 22 vjet	47000	50350	7,1 %	51300	1,9 %
	Rritja mesatare			7,1 %		2,1 %
.VeKapter	Mbi 18 vjet	48000	51400	7,1 %	52400	1,9 %
	Mbi 20 vjet	49000	52500	7,1 %	53500	1,9 %
	Mbi 22 vjet	50500	54100	7,1 %	55100	1,8 %
	Mbi 24 vjet	51500	55200	7,2 %	56200	1,8 %
	Mbi 26 vjet	52500	56250	7,1 %	57200	1,7 %

52. Nivelet e pagave për gradë janë marrë nga tabela e pagave, bashkëngjitur VKM-ve përkatëse. Të mbahet parasysh që rritjet kanë qenë efektive në gjysmën e dytë të vitit të daljes së VKM-ve, për rrjedhojë, e llogaritur për të gjithë vitin në fjalë, rritja reale ka qenë dy herë më pak.

Të kihet gjithashtu parasysh që pagesa e kontributit suplementar, 5 % (që aplikohet vetëm për ushtarakët dhe policinë) praktikisht e ka ulur pagën reale për periudhën në fjalë.

Rezart Tërshana

FORCAT E ARMATOSURA
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE TË DREJTAT E LIRITË
THEMELORE TË NJERIUT
(E DREJTA E SHOQËRIMIT)

Hyrje

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke përmbushur misionin e tyre të përcaktuar në nenin 12/1 të Kushtetutës, pavarësinë e vendit, tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues, si pjesë kryesore e strukturave me rol në sigurinë kombëtare, luajnë një rol kyç në sigurimin e një mjedisi të sigurt që na mundëson t'i gëzojmë të drejtat dhe liritë e patjetërsueshme që na takojnë të gjithëve si qenie njerëzore. Nenet 166-169 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i kanë përcaktuar këto Forca si institucion kushtetues duke rregulluar strukturën e tyre kryesore. Kushtetuta jonë i kushton një vend të veçantë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ajo në detaje përcakton, në pjesën e dytë të saj, nga neni 14 deri në nenin 63, të drejtat dhe liritë e njeriut që gëzohen në Republikën e Shqipërisë si dhe Parimet e Përgjithshme (Kreu I, pjesa 2) e disa instrumente kryesor për garantimin e këtyre të drejtave. Në këto pjesë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka burimin e saj dhe qasja që i bëhet në Forcat e Armatosura çështjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Strukturat shtetërore janë shkelësit kryesor cilësor dhe sasior të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Si përfaqësues i strukturës shtetërore, personeli i Forcave të Armatosura është i detyruar t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare gjatë kryerjes së detyrave të tij. Por ky personel mund ta bëjë këtë më mirë kur të drejtat dhe liritë e vetë atij garantohen në kazerma apo operacione, brenda

vetë institucionit të tij. Që të garantohen këto të drejta dhe liri, legjislacioni që rregullon këtë fushë duhet të jetë në koherencë me parashikimet ndërkombëtare e kombëtare dhe instrumentet garantuese për zbatimin e tij duhet të jenë të aplikueshme.

Që nga fillimi i vitit 2011 Shqipëria, ashtu si edhe një numër i madh shtetesh aleate të Traktatit të Atlantikut të Veriut, e transformoi forcën e armatosur nga një forcë që bazohet te rekrutimi apo shërbimi i detyrueshëm ushtarak, në forcë profesionale (në një forcë tërësisht vullnetare)¹, të paktën në kohë paqeje apo krizash të menaxhueshme vetëm me këto forca dhe ku mobilizimi i pjesshëm apo i përgjithshëm nuk është i nevojshëm. Roli dhe detyrat e forcës së armatosur janë gjithashtu në ndryshim e sipër me përfshirjen e ushtarakëve tanë në misionet që kryhen në zbatim të Kapitullit VI dhe VII të kartës së OKB-së, detyrimeve të anëtarësisë në NATO apo dhe atyre humanitare. Për më tepër, gjithnjë e më shumë i vihet theksi domosdoshmërisë së sigurimit të kontrollit demokratik mbi forcat ushtarake dhe e shqyrtimit të strukturave të tyre ushtarake me qëllim që ato të jenë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut.

Edukimi i personelit të forcave të armatosura për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që aplikohen si për ta dhe nga ato kundrejt të tjerëve, sidomos para dhe gjatë misioneve jashtë vendit dhe ku strukturat kontrolluese si prokuroria, gjykata, apo edhe strukturat joqeveritare që e kanë këtë veprimtari në fushën e tyre të kompetencave dhe ekspertizës, mungojnë apo janë shumë larg mbulimit të këtyre çështjeve, merr një rol të dorës së parë.

Është shumë e rëndësishme që vetë personeli i Forcave të Armatosura, oficerë, nënoficerë e ushtarë, të kuptojë se i takojnë të njëjtat të drejta dhe liri themelore të njeriut si edhe gjithë qytetarëve të tjerë, me përjashtim të disa kufizimeve të cilat shkaktohen për shkak të misionit dhe rolit shumë të rëndësishëm në garantimin e pavarësisë së vendit, tërësinë territoriale dhe

1. Pika 6.1 e dokumentit të Strategjisë Ushtarake i miratuar me Ligjin Nr. 9858, datë 27.12.2007 "Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë". Kjo pikë parashikonte që në fund të vitit 2010 Shqipëria synonte të kishte një ushtri tërësisht profesionale dhe ushtarë të shërbimit të detyrueshëm. Kjo u realizua sipas parashikimit dhe në vitin 2011 Shqipëria nuk ka rekrutuar më ushtarë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

rendin kushtetues, siç mund të jetë e drejta për bërjen e grevës apo dhe raste të tjera të cilat do të përmenden më poshtë.

Ajo ç'ka është themelore në të gjitha traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë pasi ato janë bërë pas ratifikimit - pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm, është se të gjitha qenieve njerëzore, pa marrë parasysh situatën e tyre profesionale apo pozitën e tyre në shoqëri, u takojnë të drejtat dhe liritë e tyre të patjetërsueshme.

Sfida dhe metoda

Ky studim pjesor (e drejta e shoqërimit) për aplikimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në forcat e armatosura shqiptare është frymëzuar nga gama e gjerë e traktateve të ratifikuara nga Shqipëria në këtë fushë dhe nga parashikimet e plota të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutën tonë. Legjislacioni i sipërpërmendur e detyron shtetin shqiptar që në ligjet ose dokumentet e tjera të tyre të reflektojnë të drejtat dhe detyrimet e personelit të Forcave të Armatosura dhe të sigurojnë që personeli i forcave ushtarake të mund t'i gëzojë dhe t'i realizojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ai i detyron, gjithashtu, shtetin dhe strukturat përkatëse të sigurojnë procedura të përshtatshme ligjore dhe administrative për t'i mbrojtur të drejtat e personelit së të gjitha forcave të tyre.

Pyetje që vetiu të vijnë ndër mend janë:

- A i njohin ushtarakët liritë dhe të drejtat e tyre ashtu siç duhet dhe a i aplikojnë ato?

- A ka ardhur koha për një qasje më liberale në zbatimin e këtyre të drejtave për ushtarakët?

Unë mendoj dhe sugjeroj se ka ardhur momenti që legjislatori të "kufizojë kufizimet" e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që aplikohen për personelin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ky punim është pjesë e një seti punimesh që do të pasojnë duke marrë në shqyrtim njohjen dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore kryesore të njohura nga Kushtetuta jonë për personelin ushtarak, dhe do të përpiqet të japë një qasje ndryshe nga sa parashikohet sot në legjislacion.

Në këtë pjesë të këtij studimi të madh, do të trajtojmë të drejtën dhe lirinë e shoqërimit (anëtarësimi në parti dhe pjesëmarrja në aktivitete politike).

Me një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është një ndër parakushtet kryesore përbërëse për stabilitetin dhe sigurinë rajonale.

Nga hulumtimet e deritanishme rezulton një vakum në literaturën apo punimet shkencore të akademikëve dhe studiuesve shqiptar që lidhen me pasqyrimin dhe aplikimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Forcat tona të Armatosura.

Sfidë tjetër është hendeuku mes dispozitave ligjore dhe realitetit. Normat dhe standardet e përcaktuara në kushtetutën dhe ligjet e një shteti nuk respektohen gjithmonë në realitet. Për këto arsye duhen bërë disa hulumtime nëpërmjet pyetësorëve dhe pas rezultateve duhet të bëhen krahasime midis parashikimeve ligjore dhe realitetit në terren.

Për të bërë një përjasje të drejtë e shkencore, përgjatë studimit do të bëjmë një përmbledhje të legjislacionit, politikave dhe mekanizmave për sigurimin e mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të personelit të Forcave të Armatosura.

Do të studiojmë e krahasojmë aplikimin e këtyre të drejtave dhe lirive themelore në disa shtete aleate anëtare të aleancës, edhe pse e pranojmë se nuk ekziston një model i vetëm që të aplikohet në mënyrë të njëjtë në secilin shtet të marrë për krahasim.

Si çdo studim, i cili nëse nuk do të kishte rekomandime për përmirësimin e gjendjes së konstatuar, do të ishte pa ndonjë vlerë të shtuar në literaturën kombëtare, pas gjetjeve do të ketë disa rekomandime për strukturat e sigurisë dhe sidomos për hartuesit e legjislacionit, grupet e interesit, parlamentarët dhe mbi të gjitha për vetë personelin e Forcave të Armatosura, për masat që duhet të ndërmerren me qëllim që politikat dhe praktikat që zbatohen në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në Forcat e Armatosura të jenë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kushtetuta, citime dhe kontradikta

Kushtetuta shqiptare, ashtu si edhe kushtetutat moderne të botës së sotme, jo vetëm përëndimore, në dispozitat e saj

parashikon një sërë të drejtash dhe lirish të cilat duhet t'i gëzojnë të gjithë shtetasit shqiptar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Një karakteristikë e veçantë e personelit të Forcave tona të Armatosura është se këto të drejta ato i gëzojnë edhe jashtë territorit shqiptar kur dërgohen me misione të ndryshme. Kjo çështje është zgjidhur dhe do të vazhdojë të zgjidhet nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat sigurojnë statusin e këtyre Forcave. Gjithashtu Forcat tona duhet t'i zbatojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që aplikohen në vendin tonë edhe përkundrejt të tjerëve apo personelit të një force të huaj ushtarake. P.sh një i ndaluar apo i burgosur lufte, në territorin e një shtetit tjetër, por që mbahet nga personeli ynë ushtarak do të duhet të trajtohet ashtu si e përcakton ligji ynë i brendshëm, pra me të njëjtat të drejta e liri siç përcakton Kushtetuta, legjisllacioni ynë, dhe ligji aplikativ ndërkombëtar i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Kushtetuta jonë i kushton një vend të veçantë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ajo në detaje përcakton në pjesën e dytë të saj nga neni 14 deri në nenin 63, të drejtat dhe liritë e njeriut që gëzohen në Republikën e Shqipërisë si dhe Parimet e Përgjithshme (Kreu I, pjesa 2) e disa instrumente kryesor për garantimin e këtyre të drejtave siç është edhe Avokati i Popullit (Kreu VI, pjesa 2). Gjithashtu, në Kreun V të kësaj pjese, Kushtetua vendos disa nga objektivat sociale, të cilat do të mundësojnë prosperitetin e mëtejshëm të shoqërisë sonë, dhe si pjesë shumë vitale dhe e rëndësishme e kësaj shoqërie edhe e grupimit të madh të personelit të Forcave të Armatosura.

Kushtetuta i ndan të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në tre krerë të veçantë, brenda pjesës së dytë të saj:

1. Liritë dhe të drejtat vetjake.
2. Liritë dhe të drejtat politike.
3. Liritë dhe të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore.

Nga ana tjetër, Forcat e Armatosura gjejnë rregullimin e vet kushtetues në pjesën e pesëmbëdhjetë, nga neni 166 deri në nenin 169 të saj.

Që në fillim të kësaj pjese, pra, në nenin 166 të Kushtetutës, përcaktohet e drejta e shtetasit shqiptar që për arsye ndërgjegjeje nuk pranon të shërbejë me armë në Forcat e Armatosura, të ketë mundësinë të kryej një shërbim alternativ sipas përcaktimit të bërë me ligj. Në këtë pjesë të studimit nuk

do të ndalemi në këtë çështje, por do t'i kthehemi asaj më vonë në botimet e ardhshme.

Me rëndësi në këtë fazë të analizës qëndron fakti se Kushtetuta në nenin 167 të saj bën dy përcaktime:

167/1 - ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në parti ose në veprimtari politike.

167/2 - pjesëtarët e Forcave të Armatosura ose personat që kryejnë shërbim alternativ, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë kushtetuese, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Shtetasit, ashtu si edhe përcakton nenin 167/2, nuk i humbasin të drejtat e tyre të njeriut kur hyjnë në Forcat e Armatosura, ligji mund të kufizojë gëzimin e tyre për shkak të kërkesave specifike të jetës ushtarake. Veçantitë e jetës ushtarake që përdoren për të justifikuar kufizimet në realizimin e të drejtave të njeriut në repartet ushtarake shpeshherë janë të lidhura me ruajtjen e rendit dhe disiplinës në ushtri; vendosjen e neutralitetit politik të Forcave të Armatosura; ruajtjen e efektivitetit operativ; mbrojtjen e informatave të klasifikuara; zbatimin e urdhrave; dhe mbajtjen e strukturës hierarkike të organizatës ushtarake.

Personeli i forcave të armatosura i parë nga jashtë mund të duket si “populli” homogjene, por faktikisht nuk është “një popullsi” homogjene, meqenëse ekzistojnë shumë nënkategori, ushtar, nënoficer, oficer, anëtarët e forcave të ndryshme, si marina, forcat ajrore, tokësore, policia ushtarake, njësitë speciale etj., si dhe gradat e ndryshme që prej ushtarit të thjeshtë deri te gjenerali.

Të qenët anëtar i një kategorie të caktuar, pra të personelit ushtarak, nuk duhet të ketë ndikim jo logjik dhe jo të përshtatshëm - marrë kjo edhe në referencë të kohëve që po jetojmë, mbi gëzimin e të drejtave të njeriut nga “kjo popullsi johomogjene”.

Unë mendoj dhe sugjeroj që parashikimi i bërë në nenin 167/1 të Kushtetutës sonë, pjesërisht duhet të ndryshojë. Kur them “pjesërisht”, e kam fjalën për kufizimin e vendosur për pjesëmarrjen e ushtarakut në veprimtari politike apo parti të spektrit politik shqiptar.

Në kushtetutën tonë këto lloj kufizimesh nuk janë vendosur vetëm në pjesën që i përket Forcave të Armatosura, por një kufizim i tillë është vendosur edhe në nenin 69/b i cili përcakton se ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të kandidojnë e as të zgjidhen deputet pa hequr dorë nga detyra.

Në pamje të parë, megjithëse Kushtetuta jonë është e re, për mendimin tim ajo përmban kufizime të cilat nuk duhet të jenë më pjesë e saj, por ashtu si edhe ajo vetë përcakton në nenin 167/2: “Pjesëtarët e Forcave të Armatosura ose personat që kryejnë shërbim alternativ, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë kushtetuese, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe”, duhet të ishin pjesë e ligjeve të dala në zbatim të saj.

Kushtetuta, nga njëra ana ju njeh pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të gjitha të drejtat dhe liritë kushtetuese, duke ju referuar kufizimeve që mund të vendosen me ligje të veçanta ndërsa, nga ana tjetër, vendos kufizime për ushtarakët aktiv nëpërmjet neneve të saj (167/1), një teknikë legjislative kjo jo shumë e përshtatshme pasi sjell kontradikta mes normave kushtetuese.

Megjithëse për mua nuk është shumë e qartë se çfarë duhet të kuptojmë me shprehjen e përdorur në nenin 167/1 - ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore... për momentin do të fokusohem te kufizimi kushtetues për pjesëmarrjen në aktivitete politike apo qenien anëtar i partive të ndryshme politike për ushtarakët e shërbimit aktiv.

E drejta e shoqërimit dhe personeli ushtarak

Ashtu si e përmenda dhe më lart, dua të ritheksoj dhe një herë se ky kufizim kushtetues, pra ai i pjesëmarrjes në aktivitete politike apo anëtarësimit në parti të ndryshme të spektrit politik, i bërë për ushtarakët e shërbimit aktiv, jo vetëm që nuk duhej të ishte bërë në Kushtetutë, pra ashtu si edhe ajo vetë e përcakton se duhej të bëhej në ligje të tjera, por ai me ndryshimet e fundit kushtetuese duhej të ishte hequr nga sfera e kufizimeve për ushtarakët e shërbimit aktiv.

Termi që përdoret për personelin e Forcave të Armatosura si “qytetar me uniformë”, ka marrë një njohje ndërkombëtare, dhe si të tillë, pra “qytetar”, anëtarët e Forcave të Armatosura shqiptare i gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore të njeriut, por këto u nënshtrohen kufizimeve dhe detyrimeve të caktuara, të imponuara nga shërbimi ushtarak, si veprimtari shoqërisht e domosdoshme për funksionimin e shtetit. Unë nuk mendoj

se shërbimi ushtarak në ditët e sotme duhet të jetë pengesë për qytetarët me uniformë, për të ushtruar të lirë bindjet e tyre politike, për të marrë pjesë në aktivitete politike apo edhe për të qenë anëtar i partive politike. Unë nuk sugjeroj që shërbimi ushtarak të interferojë me aktivitetin politik, pra këto aktivitetet përveçse duhet të kryhen jashtë orarit zyrtar dhe pa uniformë, nuk duhet të bien ndesh me detyrat e ngarkuara personelit ushtarak. Gjithashtu, në rast konflikti të mundshëm mes detyrës dhe aktivitetit politik, ligji duhet të përcaktoj qartë që detyra dhe përmbushja e misionit të ligjshëm duhet të prevalojë.

Në parim, personeli ushtarak, si qytetarë me uniformë, i gëzon të drejtat e njëjta themelore si çdo qytetar. Megjithatë, Forcat e Armatosura të shumë shteteve konsiderojnë që aktivitetet politike janë të dëmshme për nevojën për disiplinë dhe nuk janë në përputhje me profesionin ushtarak. Për këtë arsye, neutraliteti politik i ushtarakëve është çështje kontroverse për të gjitha sistemet ushtarake. Edhe pse rregullat për neutralitetin politik në suaza të Forcave të Armatosura janë mjaft të ngjashme, shkalla e detyrimit për t'u përmbajtur nga aktivitetet politike jashtë Forcave të Armatosura ndryshon shumë. Në lidhje me këtë, shpeshherë imponohen kufizime mbi lirinë e fjalës së ushtrisë, pjesërisht për shkak të nevojës që ajo të shihet si politikisht neutrale, dhe pjesërisht që të pengohen kundërshtimi dhe mosbindja. Këto kufizime gjithashtu imponohen në Shqipëri edhe për shkak të begraundit historik të vendit tonë, e këtu mbaj parasysh periudhën e diktaturës komuniste dhe ngjarjet e mbrapshta të vitit 1997. Forcat e sigurisë, në rastin tonë Forcat e Armatosura jo vetëm për shkak të mbajtjes së disiplinës apo termave të tjerë më të butë të përdorur rëndom, kërkohen që të jenë të distancuara nga politika edhe për shkak të mënjanimi sa më shumë nga përdorimi i tyre për qëllime politike.

Në mënyrë të përmbledhur kufizimet më të shpeshta të aktiviteteve politike të anëtarëve të Forcave të Armatosura të parashikuara nga Kushtetuta janë:

- Ndalimet e pjesëmarrjes në parti politike.
- Ndalimet e pjesëmarrjes në veprimtari politike.
- Ndalimet e kandidimit apo të zgjedhjes pa dhënë më parë dorëheqje.
- Ndalimet e emërimit apo zgjedhjes në detyra shtetërore.

Justifikimet për kufizimet e këtij lloji janë të ndryshme, e më poshtë po përmendim disa prej më kryesoreve.

Së pari, si mbrojtëse të integritetit territorial, pavarësisë dhe të rendit kushtetues, Forcat e Armatosura duhet të shihen që janë të pavarura dhe mbi mosmarrëveshjet politike. Neutraliteti e ndihmon sigurimin e asaj që vetëm votuesit të përcaktojnë kush do ta qeverisë shtetin. Në shumë vende demokratike në tranzicion, Forcat e Armatosura kanë pasur një histori të njollësuar dhe represive të lidhshmërisë me partinë dominuese politike, dhe kërkesat e neutralitetit janë mënyrë e pastrimit me të kaluarën.

Edhe në vendin tonë domosdoshmëria e vendosjes së kufizimeve të tilla lidhet me historinë e paraviteve '90, dhe në vitet '90 të ushtrisë sonë. Të gjithë e mbajmë mend se si në vitet '90 kur po ndryshohej sistemi qeverisës në Shqipëri nga një sistem diktatorial-komunist në atë demokratik, ishin forcat e sigurisë përfshirë edhe ato ushtarake ato të cilat demonstironin forcën përballë popullit që kërkonte ndryshimin.

E njëjta gjë ndodhi edhe në vitin e mbrapsht '97, kur palët akuzonin njëra-tjetrën për përdorimin e ushtarakëve në rezervë për destabilizimin e vendit, nga njëra anë, dhe për përdorimin e ushtarakëve aktiv kundër protestuesve, nga ana tjetër.

E nisur nga ky sfond historik nuk kishte se si në vitin 1998 Kushtetuta jonë të mos kishte parashikime të tilla që ndalonin ushtarakët për pjesëmarrje në jetën politike të vendit, duke siguruar në këtë mënyrë të paktën ligjërisht neutralitetin e tyre karshi partive dhe veprimtarive politike.

Por tashmë kanë kaluar mbi 16 vjet nga zhvillimet e sipërpërmendura, dhe gjërat kanë ndryshuar kah stabilitetit, zhvillimit ekonomik e prosperitetit dhe nga kjo "popullsi johomogjene" mendoj se duhet të pritët, por dhe të kërkohet më shumë, dhe të hiqet dorë nga pengesat ligjore për ushtrimin e të drejtave themelore të njeriut. Duhet të kemi të gjithë bashkë parasysh se ushtarakët janë ndër grupet shoqërore më të mirëshkolluara e të disiplinuar dhe kanë nxjerrë nga gjiri i tyre njerëz me emër e me karriera të shkëlqyera pothuajse në të gjitha fushat e jetës.

Prandaj edhe unë që në fillim të këtij punimi jam shprehur se koha ka ardhur për disa ndryshime, pra që ndalime të tilla në një shoqëri që po zhvillohet me hapa të shpejt dhe që kontributet e

gjithsecilit janë të mirëpritura dhe të nevojshme, duhet të hiqen për personelin e Forcave të Armatosura.

Së dyti, kufizimet kanë për qëllim t'i pengojnë kontroversat politike brenda forcave të armatosura të cilat mund ta pakësojnë efektivitetin dhe moralin e tyre, posaçërisht në rastin e kritikës së udhëheqjes politike të shtetit ose të detyrave të cilat udhëheqësit e zgjedhur ia kanë dhënë ushtrisë.

Së treti, kontrolli efektiv civil dhe llogaridhënia për Forcat e Armatosura kërkojnë ndarje të sferave politike dhe ushtarake. Nëse anëtarët e Forcave të Armatosura janë aktorë të rëndësishëm në sferën politike, kjo do ta dobësojë llogaridhënien demokratike dhe do të krijojë konflikte të interesave. Rrjedhimisht, mund të jenë të nevojshme kufizime për ta penguar përfshirjen aktive të anëtarëve të Forcave të Armatosura në politikë.

Aktualisht ne qeverisemi nga dy lloj nivelesh qeverisje, ajo qendrore dhe lokale. Ndonëse lidhja e qeverisjes qendrore me Forcat e Armatosura është më e dukshme dhe e fortë, lidhja e qeverisjes lokale me Forcat e Armatosura nuk është e fortë dhe ndikimi i ndërsjellët të këto struktura mund të mos jetë i konsiderueshëm për të vendosur ndalime të tilla si ato të përcaktuara në nenin 167/1 të Kushtetutës, pra që ushtarakët të mos zgjidhen apo emërohen në detyra shtetërore apo të mos marrin pjesë në aktivitete politike.

Gjermania ka qasjen se arsimimi më i mirë për praktikën demokratike për anëtarët e Forcave të Armatosura është qytetaria aktive. Prandaj, ato imponojnë kufizime minimale mbi aktivitetet politike. Aty ku imponohen kufizime mbi aktivitetet politike të anëtarëve të forcave të armatosura, është e qartë që ato nuk duhet të jenë më shumë se proporcionale me qëllimet e sigurimit të rendit kushtetues ose të mbrojtjes së disiplinës ushtarake. Ato duhet të kenë bazë ligjore në mënyrë që i bën ato transparente dhe të parashikueshme. Për shembull, një kufizim i pjesëmarrjes aktive në politikën kombëtare mund të jetë i justifikuar nga nevoja për ndarje të ushtrisë dhe politikës, por ky argument është më i dobët kur bëhet fjalë për politikën lokale, veçanërisht nëse nuk ka kontroll ose përfshirje të autoriteteve lokale në çështjet ushtarake.

Në një rast që përfshinte kufizime të imponuara në Hungari, të cilat i pengonin anëtarët e forcave të armatosura, të policisë dhe të shërbimeve të sigurimit t'i bashkëngjiten cilësdo parti politike

dhe të angazhohen në çfarëdo qoftë aktiviteti politik, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi që nuk ka shkelje të nenit 10 ose 11 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (më poshtë KEDNJ) për shkak se kufizimet ndiqnin qëllime legjitime, përkatësisht mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike dhe pengimin e prishjes së rendit. Kufizimet kishin për qëllim ta depolitizojnë policinë dhe si rrjedhojë të kontribuojnë drejt konsolidimit dhe ruajtjes së demokracisë pluraliste. Duke e pasur parasysh rolin e rëndësishëm të policisë në shoqëri, Gjykata konstatoi që kufizimet janë në përputhje me parimet demokratike. Gjykata deklaroi:

41. ...Efektivit policor i janë dhënë kompetenca detyruese për rregullim të sjelljes së qytetarëve, dhe në disa shtete ai është i autorizuar të mbajë armë në kryerjen e detyrave të tij. Në fund, forca policore është në shërbim të shtetit. Së këndejmi, qytetarët kanë të drejtë të presin që, në marrëdhëniet e tyre me policinë, të ballafaqohen me policë politikisht neutralë, të cilët janë të shkëputur nga beteja politike.

Parime të ngjashme do të aplikoheshin edhe mbi anëtarët e Forcave të Armatosura. Megjithatë, në rastin e tyre mbase është më vështirë të justifikohen kufizimet e pjesëmarrjes në politikën lokale, për shkak se nevoja për neutralitet me qëllim të shmangies së konfliktit të interesave aplikohet në radhë të parë në nivel kombëtar.

Pra, ashtu si edhe mund të konstatohet, vende të ndryshme siç janë Gjermania dhe Polonia kanë qasje të ndryshme mbi çështje të njëjta.

Unë mendoj se qasja e Gjermanisë është qasje më e drejtë dhe prandaj duhet të ndjekim në një masë të caktuar shembullin e saj në lidhje me këto të drejta.

Këto ndalime duhet të vijnë duke u zbutur edhe te ne, si fillim të hiqet kufizimi i pjesëmarrjes në aktivitete politike, gjithmonë duke mos lejuar pjesëmarrjen me uniformë, e më vonë duke u lejuar ushtarakëve të jenë anëtar sipas bindjeve të tyre politike të partive të ndryshme të ligjshme.

Të drejtat kryesore që po diskutojmë janë liritë e të shprehurit (p.sh. për të shprehur dhe komunikuar pikëpamje politike) dhe të shoqërimit (p.sh. për t'iu bashkëngjitur një partie politike).

Neni 25 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (më poshtë KNDKP) përcakton:

Secili qytetar ka të drejtë dhe mundësi, pa asnjërin prej dallimeve të përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

(a) të marrë pjesë në kryerjen e punëve publike, drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë të lirë;

(b) të votojë dhe të jetë i zgjedhur në zgjedhje të mirëfillta periodike, të cilat realizohen me të drejtë të përgjithshme dhe të barabartë të votimit dhe mbahen me votim të fshehtë, duke e garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;

(c) të ketë qasje, në kushte të përgjithshme të barazisë, deri te shërbimi publik në shtetin e tij².

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut ka vërejtur se nëse ekzistojnë baza të arsyeshme për atë që poste të caktuara të zgjedhura të konsiderohen si të papërputhshme me qëndrimin në pozita specifike (p.sh. gjykatësit, postet ushtarake të rangut të lartë, shërbimi publik), masat për shmangie të çfarëdo konflikti qoftë të interesave nuk duhet në mënyrë të panevojshme t'i kufizojnë të drejtat e mbrojtura nga paragrafi (b)³. Në një rast, u mbështetën kufizimet e imponuara në Holandë, të cilat e pengonin një polic në shërbim nga marrja e postit të tij të votuar në zgjedhje në një këshill lokal: Komiteti konsideronte që nuk kishte shkelje të nenit 25 për shkak se kufizimet ishin dizajnuar të pengojnë konflikt të interesave⁴. Parime të ngjashme do të aplikoheshin edhe mbi kufizimet në Forcat e Armatosura.

Po të studiohet çështja nga pikëpamja e qeverisjes në nivel vendor, atëherë kufizimi i të drejtave bëhet edhe më joefikas. Janë vetë partitë politike të të gjithë spektrit ato të cilat këto zgjedhje nuk i konsiderojnë politike, por i quajnë ato "zgjedhje administrative" dhe produkt i të cilave është një grup njerëzish që kujdesen lokalisht për mbarrëvajtjen e punëve të komunës,

2. Për më tepër, neni 3 i Protokollit të parë të KEDNJ-së thotë: "Palët e larta kontraktuese obligohen të mbajnë zgjedhje të lira me votim të fshehtë në intervale të arsyeshme, në kushte të cilat do ta sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës".

3. Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, komenti i përgjithshëm 25 (57), UN Doc. CCPR/C/21/Rev.1/Add.7 (1996), paragrafi 25.

4. Debreczeny kundër Holandës (Debreczeny v. The Netherlands), Komiteti i KB-së për të Drejtat e Njeriut, 3 prill 1995, Komunikimi Nr. 500/92, UN Doc. CCPR/C/53/D/500/1992.

bashkisë apo qarkut, pa u ngatërruar me politikat kombëtare për të cilat kujdeset qeveria dhe parlamenti.

Qeverisja vendore dhe parimet kryesore të funksionimit të saj janë parashikuar në nenet 108-115 të Kushtetutës sonë si dhe në Ligjin Nr. 8652/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Në këto nene të Kushtetutës, nuk kemi të përcaktuar asnjë kriter të përgjithshëm apo posaçëm për kandidatët për poste ekzekutive apo për këshilltarët e këtyre njësive vendore. Gjithashtu edhe në Ligjin Nr. 8652/2000, nuk kemi ndonjë përcaktim për kriteret për t'u zgjedhur në këto poste përveç referencës në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë që i bëhet në nenin 23 dhe 39 të Ligjit të sipërpërmendur.

Gjithashtu, nga studimi i bërë në legjislacionin e mbrojtjes nuk rezulton të kemi një ndalesë të posaçme për kandidimin për poste ekzekutive apo këshilltar në këto njësi bazë të qeverisjes vendore.

Ndërkohë, Kodi Zgjedhor i miratuar me Ligjin Nr. 10 019, datë 29.12.2008 i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012, në nenin 63 të tij përcakton:

1. Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin një listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.

2. Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.

3. Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie apo komune, ose për këshillat vendore në KZAZ.

4. Përveç kushteve të parashikuara në pikën 3, nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen pa hequr dorë më parë nga detyra:

- a) gjyqtarët, prokurorët;
- b) ushtarakët e shërbimit aktiv;
- c) punonjësit e policisë dhe të sigurimit kombëtar.

Pra, ashtu si edhe mund të vihet re, ligjvënësi nëpërmjet Kodit Zgjedhor ka unifikuar kriteret për t'u zgjedhur si kryetar apo këshilltar të njësive të qeverisjes vendore me kriteret për t'u zgjedhur në Kuvend si deputet.

Por ajo që konstatohet është se ndërsa kriteret për të qenë deputet janë parashikuar në nenin 45 dhe 69 të Kushtetutës, ato për t'u zgjedhur në poste ekzekutive apo këshilltar në njësitë e qeverisjes vendore nuk janë të përcaktuara në Kushtetutë. Në këtë rast do të aplikoheshin vetëm kriteret e përcaktuara në nenin 45 të Kushtetutës të cilat janë:

1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.
2. Përjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paafte mendërisht.
3. Të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë, kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur...

Nga analiza e mësipërme rezulton se Kodi Zgjedhor ka tejkaluar kufizimet e përcaktuara nga neni 69 i Kushtetutës duke vendosur kufizime të panevojshme për ushtarakët edhe për zgjedhjet për qeverisjen vendore.

Unë mund të kuptoj shumë mirë që një ushtarak nuk do të mund të kandidojë apo edhe të zgjidhet për poste ekzekutive të këtij niveli qeverisjeje, pra për kryetar komune apo bashkie, pa bërë disa rregullime të posaçme ligjore procedurale, por që të kufizohet një ushtarak për të kandiduar dhe më tej të zgjidhet dhe të ushtrojë funksionin e tij si këshilltar pranë një njësie të caktuar vendore, mendoj së është një vendim i marrë jo në përputhje dhe jo në përpjesëtim me atë se çka është munduar të rregullohet. Pra, kufizimet e të drejtave dhe lirive nuk duhet të jenë më shumë se proporcionale me qëllimet e sigurimit të rendit kushtetues ose të mbrojtjes së disiplinës ushtarake. Pra, një kufizim i pjesëmarrjes aktive në politikën kombëtare mund të jetë i justifikuar nga nevoja për ndarje të ushtrisë dhe politikës, por ky argument është më i dobët kur bëhet fjalë për politikën vendore, veçanërisht nëse nuk ka kontroll ose përfshirje të autoriteteve lokale në çështjet ushtarake që faktikisht ndodh edhe në Shqipëri.

E drejta e shprehjes dhe e shoqërimit në Kushtetutën tonë rregullohet në nenin 22/1 i cili citon: "Liria e shprehjes është e garantuar" dhe në nenin 46/1 "Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm".

Kushtetuta jonë në nenin 45/1 përcakton se "çdo shtetas që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë dhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet".

Po në këtë nen, por në paragrafin e dytë dhe të tretë të tij, Kushtetuta jep edhe kategoritë e personave që privohen nga kjo e drejtë, dhe ato janë shtetasit që janë deklaruar me vendim gjykatë të formës së prerë si të paafte mendërisht, ndërsa të burgosurit mund të ushtrojnë vetëm të drejtën e zgjedhjes dhe jo të zgjidhen. Ndërkohë që konstatojmë se ky nen i Kushtetutës bie ndesh me nenin 167/1 të Kushtetutës i cili ashtu si edhe konstatuam më lart në këtë studim përjashton ushtarakët nga e drejta e zgjedhjes, dhe në një mënyrë jo të përshtatshme e vë këtë personel në pozitën e të burgosurve, pra që kanë të drejtë vetëm të zgjedhin përfaqësuesit e tyre.

Për më tej, ky nen i Kushtetutës është implementuar dhe në Ligjin Nr. 9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Në nenin 19 "Ndalimet për shkak të detyrës ose shërbimit" përcaktohet se:

1. Ushtarakut aktiv, për shkak të detyrës ose shërbimit, i ndalohet:

a) të jetë anëtar i partive politike, i organizatave ose shoqatave me karakter politik, si dhe të marrë pjesë në veprimtaritë politike që organizohen prej tyre.

Gjithashtu, në nenin 3 të Ligjit të sipërpërmendur përcaktohet se "shërbimi ushtarak është veprimtari e veçantë, shoqërisht e domosdoshme për shtetin, që kryhet në bazë të dëshirës, vullnetit dhe detyrimit për t'i shërbyer atdheut dhe interesave të kombit, përgjegjësisë për zbatimin e legjislacionit, paanësisë politike, bindjes, profesionalizmit dhe vazhdimësisë së karrierës.

Pra, ashtu si edhe mund të konstatohet, ndalimi i vënë në Kushtetutë përsëritet në ligjin që rregullon statusin e personelit ushtarak të Forcave të Armatosura.

Ashtu si edhe konstatojmë çdo ditë në jetën e përditshme, të pakët janë ata ushtarakë që nuk kanë bindje politike të majta, të djathta apo të çfarëdo lloji. Kjo është shumë thjeshtë e vërtetueshme, duke u bazuar në pyetjen nëse në zgjedhjet e fundit politike ato kanë votuar ose jo.

Për efekt të këtij studimi janë pyetur 140 ushtarakë, pra rreth 10 % e numrit total ose gati 20 % e numrit real, të Forcave tona të Armatosura. Ushtarakët e pyetur kanë qenë 50 % oficerë, 30 % nënoficerë dhe 20 % ushtarë. Gradat kanë qenë të ndryshme sipas grupit që i përkisnin të pyeturit. Janë pyetur më shumë oficerë, pasi pritshmëria ime te ky grupim për njohjen e të drejtave

dhe lirive themelore të njeriut ishte më e lartë.

Nga 140 të pyetur, rezultoi se të gjithë kishin votuar, pra dhe ato në momentin e duhur kanë shprehur vullnetin e tyre politik.

Sipas mendimit tim e rëndësishme për çdo ushtarak, por jo vetëm, është të bëjë një ndarje të qartë të detyrës së tij si qytetar me uniformë dhe detyrës së tij si qytetar i Shqipërisë. Gjithashtu duhet të arrihet një balancim i drejtë i kohës në të cilën ushtaraku mund të merret me politikë si dhe, sigurisht, ai nuk duhet ta ushtrojë këtë detyrë qytetare në uniformë, dhe për më shumë të ndikojë te personeli vartës në lidhje me bindjet e tij politike.

Kufizime të ngjashme janë vendosur edhe për nëpunësit civilë të Shqipërisë. E veçanta në rastin e nëpunësve civilë është se ato mund të merren me politikë dhe mund të jenë pjesëtar të partive politike me përjashtim të mbajtjes së posteve drejtuese në këto organizata.

Germa “e” e nenit 20 të Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” përcakton se “Nëpunësit civil kanë këto të drejta:

e) të jenë anëtarë të partive politike, por jo në organet qendrore ekzekutive.

Nga ana tjetër, ky Ligj, në nenin 3 të tij, “Parimet e shërbimit civil” shprehet se “shërbimi civil është i ndërtuar dhe vepron mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, të pavarësisë dhe integritetit, të paanësisë politike, të transparencës, të shërbimit ndaj publikut, të vazhdimësisë së karrierës, të përgjegjësisë dhe korrekhtësisë në zbatimin e ligjit”.

Nga një konstatim i thjeshtë mund të themi se ashtu si në nenin 12/2 të Kushtetutës shqiptare dhe nenin 3 të Ligjit Nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” përcaktohet asnjënjësia e Forcave të Armatosura nga çështjet politike, ashtu edhe në nenin 3 të Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, përcaktohet parimi i paanësisë politike të shërbimit civil si institucion.

Për implementimin e mëtejshëm të kësaj të drejte, pra ajo e anëtarësimit në parti politike, dhe për kontrollin e zbatimit të saj në përputhje me parimin e paanësisë politike të shërbimit civil, është miratuar edhe një dispozitë e veçantë në Vendimin Nr. 306, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinën në shërbimin civil”.

Pika 1 e këtij vendimi përcakton në detaje shkeljet disiplinore për nëpunësit civil të Republikës së Shqipërisë. Germa “g” e

nenit 1 të këtij Vendimi të Këshillit të Ministrave përcakton si vijon: “Shprehja e mendimeve apo kryerja e veprimtarive publike me karakter partiak në rolin e nëpunësit civil ose gjatë orarit të punës”. Pra, janë shkelje disiplinore si shprehja e mendimeve me karakter partiak ashtu edhe kryerja e veprimtarive partiake gjatë orarit të punës, gjë e cila do të cenonte rëndë paanësinë politike të shërbimit civil të garantuar nga neni 3, Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për Statusin e nëpunësit civil”.

Rregullimi që ka bërë legjislacioni për nëpunësin civil, është shumë i gjetur dhe ka një qasje të mirë me zhvillimet shoqërore të komunitetit të nëpunësve civil si pjesë e shoqërisë. Pra, shërbimi civil në përmbushjen e detyrave të tij udhëhiqet nga parimi i paanësisë politike ndërsa nëpunësit civilë mund të jenë anëtarë të partive politike. Ato nuk lejohen që të ushtrojnë detyra në strukturat udhëheqëse të partisë, dhe nuk mund të lejojnë të ketë konflikte interesi mes tyre në zbatimin e detyrave shtetërore dhe atyre partiake. Sigurisht, veprimtaria politike zhvillohet jashtë institucioneve dhe orarit zyrtar të punës. Kjo veprimtari nuk duhet assesi të cenojë punën, në përgjithësi, dhe shërbimin civil, në veçanti, si të paanshëm politikisht.

Shqipëria është anëtare e OSBE-së dhe si e tillë është politikisht e detyruar të zbatojë angazhimet e marra përsipër në rang ndërkombëtar. OSBE-ja vazhdimisht e afirmon rëndësinë e të drejtave civile dhe politike dhe të sigurimit të asaj që ato të mund të realizohen plotësisht⁵. Në Paris, në vitin 1990, OSBE-ja e afirmoi të drejtën e lirisë së shoqërimit dhe tubimit paqësor, dhe, në konferencën e saj të Kopenhagës në të njëjtin vit, e theksoi rëndësinë e të drejtës së themelimit të partive politike. Në Kopenhagë, OSBE-ja gjithashtu afirmoi që: “Secili ka të drejtën e lirisë së të shprehurit duke e përfshirë të drejtën e komunikimit ... lirinë e mendimit, pranimin dhe dhënies së informatave dhe ideve pa ndërhyrje nga ndonjë autoritet publik dhe pa marrë parasysh kufijtë”⁶. Angazhimet e mëtejshme për të drejtat e njeriut e qartësojnë atë që liria e të shprehurit i përfshin të drejtat e përhapjes dhe publikimit të

5. Helsinki 1975 (Çështjet në lidhje me sigurinë në Europë: 1. (a) Deklarata për parimet udhëheqëse për marrëdhëniet mes shteteve pjesëmarrëse - Parimi VII); Madrid, 1983 (Çështjet në lidhje me sigurinë në Europë: Parimet); Vjenë, 1989 (Çështjet në lidhje me sigurinë në Europë: Parimet).

6. Kopenhagë, 1990, paragrafi 9.1.

pikëpamjeve dhe informatave⁷. Diskriminimi negativ i Kushtetutës sonë që i bëhet personelit ushtarak, apo qytetarit në uniformë, mendoj se është i tepruar. Ky diskriminim duhet të hiqet dhe rregullat e reja në kontekstin e ri historik e shoqëror të Shqipërisë t'i qasen përvojave më të mira të vendeve perëndimore apo edhe qasjeve që ka ligji për nëpunësit civilë të Republikës së Shqipërisë.

Politikat shumë restriktive, mesatarisht restriktive dhe së paku restriktive

Paragrafi 23 i Rregullores së OSBE-së për aspektet politiko-ushtarake të sigurisë thotë që “derisa i parasheh të drejtat civile të anëtarit individual të shërbimit, secili shtet do të sigurojë që forcat e tij të armatosura të jenë politikisht neutrale”. Ekuilibri mes interesit të përbashkët në neutralitetin politik të forcave të armatosura në tërësi dhe të drejtave politike të anëtarëve individualë të Forcave të Armatosura mund të përcaktohet në mënyra të ndryshme.

Georg Nolte dhe Heike Krieger janë të mendimit që mes shteteve europiane mund të shihen tri pozita të veprimit sa i përket nivelit të pjesëmarrjes në procesin politik që u lejohet anëtarëve të Forcave të Armatosura, të cilat janë:

1. Politikat shumë restriktive të neutralitetit politik.
2. Politikat mesatarisht restriktive të neutralitetit politik.
3. Politikat më së paku restriktive të neutralitetit politik⁸.

Politikat shumë restriktive në mënyrë efektive e sigurojnë padukshmërinë e Forcave të Armatosura sa i përket debatit publik. Në të vërtetë, kjo qasje përpiqet ta sigurojë neutralitetin nëpërmjet vënies së forcave të armatosura në karantinë dhe ndarjes së tyre nga angazhimi aktiv politik.

Kjo qasje aktualisht zbatohet edhe për personelin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Pra, ky personel është i ndarë totalisht nga aktivitetet e mundshme politike, siç janë pjesëmarrja në mbledhje të partive politike, kandidimi për një parti politike pa hequr dorë nga shërbimi ushtarak apo anëtarësimi në një parti politike.

7. Ibid., paragrafi 10.1.

8. G. Nolte dhe H. Krieger, “Krahasim i sistemeve europiane të ligjit ushtarak” (“Comparison of European Military Law Systems”), në Nolte, op. cit., shënimi 6, f. 77.

Politikat mesatarisht restriktive të neutralitetit politik përpiqen ta kufizojnë mënyrën e pjesëmarrjes së anëtarëve të Forcave të Armatosura në jetën publike. Qëllimi është të shmangët paraqitja që ushtria ose individët e identifikuar si ushtarakë ose ushtarake janë publikisht të angazhuar për ndonjë kauzë politike. Për shembull, në Itali, Belgjikë dhe Mbretërinë e Bashkuar ekzistojnë kufizime të aktiviteteve politike gjatë mbajtjes së uniformës⁹. Mund të imponohen kufizime ndaj marrjes së posteve në parti politike nga ushtarët në shërbim (si në Mbretërinë e Bashkuar), por jo ndaj vetë anëtarësimit.

Mund të ekzistojnë detyrime që të kërkohet leje ose të njoftohen autoritetet para angazhimit në aktivitete politike. Për shembull, në Kroaci, e drejta e kandidaturës në zgjedhje, e drejta e bashkëngjitjes ndonjë partie politike dhe e drejta e lirisë së të shprehurit në lidhje me çështjet ushtarake kërkojnë aprovim paraprak në nivel ministror¹⁰. Në Luksemburg, anëtarëve të Forcave të armatosura u lejohet të jenë kandidatë në zgjedhje, por nëse fitojnë, duhet patjetër të tërhiqen nga shërbimi.

Unë mendoj se kjo qasje, pra ajo mesatarisht restriktive do të ishte shumë e gjetur dhe me vlera për personelin tonë të Forcave të Armatosura. Ndryshimet duhet të bëhen në drejtim të lejimit, së pari për t'u anëtarësuar në parti të ndryshme politike me kushtin e mosmbajtjes së posteve drejtuese, të lejimit të pjesëmarrjes në aktivitete politike, por jashtë orarit të punës pa cenuar shërbimin ushtarak dhe pa uniformë.

Kjo qasje u ofrohet e rregulluar ligjërisht nëpunësve civil të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, në lidhje me të drejtën e kandidimit, unë do të sugjeroja që ajo të lejohet për personelin ushtarak, por ai duhet që të pezullohej nga ushtrimi i detyrave ushtarake gjatë periudhës së garës elektorale, dhe nëse fiton këtë garë, atëherë të ketë të drejtën e zgjedhjes midis punës në Forcat e Armatosura dhe vendit të fituar nëpërmjet garës në zgjedhje.

Sigurisht që këto ndryshime duhet të bëhen, së pari, në Kushtetutë dhe të gjejnë rregullime implementuese në legjislacionin e mbrojtjes.

Ajo që nevojitet për t'u pasur në vëmendje gjatë implementimit të sugjerimeve është ndjeshmëria ndaj asaj se kur aktiviteti politik

9. Nolte dhe Krieger, op. cit., shënimi 74, f. 79-80.

10. Pyetësori i projektit të ODIHR-DCAF-it, pyetja 54/b, 2006.

vërtet e vë në diskutim neutralitetin e sanksionuar në nenin 12/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ndaj asaj kur janë të tepërta kufizimet e të drejtave.

Neni 12/2 i Kushtetutës citon: "Forcat e Armatosura ruajnë asnjëherë në çështjet politike dhe i nënshtrohen kontrollit civil".

Përcaktimi i mësipërm nuk mendoj se duhet lexuar në mënyrë restriktive maksimaliste. Ashtu si u diskutua edhe më sipër, Forca e Armatosur si institucion kushtetues duhet të ruajnë asnjëherë e saj nga çështjet politike. Qytetari në uniformë, personel i saj, duhet të ketë një qasje pro aktive ndaj çështjeve politike dhe jashtë kohës së punës apo shërbimit. Sugjerimi i mësipërm assesi nuk do të thotë që forca e armatosur humbet asnjëherë e saj ndaj çështjeve politike nëse personeli i saj në përputhje me kriteret rigorozë ligjore, që do të implementojnë ndryshimet kushtetuese, do të ushtrojë këtë të drejtë.

Kufizimet e të drejtave të personelit ushtarak sipas rrethanave, duke i marrë parasysh shtresat e ndryshme të posteve politike, shkallët e ndryshme të angazhimit politik dhe kërkesat ushtarake të vendeve dhe rasteve të ndryshme mund të arsyetohen më lehtë. Në këtë kuptim, preferoj politikën më pak restriktive, edhe pse, në raste të jashtëzakonshme, historia ose situata e veçantë në një shtet mund të justifikojë një qasje më restriktive për ta siguruar neutralitetin. Gjithashtu, në raste të jashtëzakonshme do të mund të justifikoheshin ndalimet e bazuara në llojin e pikëpamjes politike që përkrahet nga ndonjë anëtar i Forcave të Armatosura; megjithatë, kufizimet e tilla mund të justifikohen në rastin e ndonjë partie politike që e mbështet rrëzimin e institucioneve demokratike.

Kjo, siç u tha dhe më lart, duhet të rregullohet nëpërmjet përcaktimeve të qarta, transparente, të logjikshme dhe proporcionale, të cilat duhet të bëhen së pari në Kushtetutë dhe më pas në Legjislacionin e Mbrojtjes.

Politikën më së paku restriktive të neutralitetit politik kanë për qëllim ta inkurajojnë pjesëmarrjen politike nëpërmjet "kufizimit të kufizimeve" të anëtarëve të Forcave të Armatosura, me kusht që realizimi i të drejtave politike të mos ndërhyjë në detyrimin ushtarak. Holanda e ndjek këtë qasje dhe madje lejon, në rrethana të caktuara, demonstrata në objekte ushtarake ose pjesëmarrje të ushtarëve në uniformë në takime publike.

Për sa i përket kësaj lloj qasje mendoj se shoqëria shqiptare dhe personeli i Forcave të Armatosura si komponent e kësaj shoqërie nuk e ka arritur atë shkallë emancipimi dhe zhvillimi shoqëror sa për të vënë në jetë këtë qasje që megjithëse duket shumë e mirë në momentin që flasim, mendoj se nuk do t'i nevojitej personelit ushtarak.

Normalisht ne duhet të ecim me hapa të sigurt duke kapërcyer shkallët e klasifikimit të mësipërm një e nga një, pra nga politikat restriktive tek ato mesatarisht restriktive. Më vonë, me maturimin e proceseve politike dhe të shoqërisë sonë dhe asaj ushtarake, në veçanti, aplikimi i politikave më së paku restriktive do të vijë natyrshëm edhe te ne.

II. Rekomandime

Pas analizës së bërë rreth përcaktimeve kushtetuese mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në lidhje me personelin e Forcave të Armatosura, shembujve të vendeve të ndryshme dhe qasjes së tyre me zbatimin e këtyre të drejtave, legjislacionit respektiv të mbrojtjes apo edhe të shërbimit civil në Shqipëri:

Problematikave dhe paqartësive të implementimit në legjislacion të vullnetit të qartë të legjislatorit në lidhje me kufizimin apo lejimin e të drejtës së shoqërimit.

Paqartësisë së personelit ushtarak në lidhje me lejimet apo kufizimet e kësaj të drejte.

Rekomandoj që nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

1. Të ndërmerren ndryshime kushtetuese në lidhje me ushtrimin e të drejtës së anëtarësimit në parti politike të personelit të Forcave të Armatosura, pa prekur parimin e paanësisë politike të institucionit të Forcave të Armatosura.

2. Pas ndryshimeve kushtetuese, duhet të përcaktohen qartë në legjislacionin e mbrojtjes, kushtet e zbatimit të së drejtës së shoqërimit, pra kushtet për anëtarësim në parti politike dhe ushtrimin e kësaj të drejte pa cenuar shërbimin ushtarak, sigurinë kombëtare dhe rendin kushtetues.

3. Kodi Zgjedhor duhet medoemos të bëjë, së pari, ndarjen e kriterëve të përcaktuara për kandidatët për zgjedhjet politike, pra për deputet në kuvendin e Shqipërisë, nga kriteret për kandidat për

postet ekzekutive apo këshilltarët e qeverisjes vendore (zgjedhjet administrative) dhe, së dyti, të ripërcaktojë në përputhje me Kushtetutën dhe praktikën më të mira ndërkombëtare kufizimet për ushtarakët e Forcave të Armatosura për zgjedhjet administrative.

4. Të ndërmerren ndryshime në Legjislacionin e mbrojtjes duke mundësuar ushtrimin e këtyre të drejtave në mënyrë proporcionale dhe të aplikohet në mënyrë jodiskriminuese.

5. Të bëhen fushata promovimi dhe trajnimi me të gjithë personelin e Forcave të Armatosura në lidhje me njohjen dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Bibliografia

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Ligji Nr. 9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".
3. Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Për statusin e nëpunësit civil".
4. Ligji Nr. 9858, datë 27.12.2007 "Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë".
5. Ligji Nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 306, datë 13.6.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil".
6. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar.
6. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.
7. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike.
8. Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.
9. G. Nolte dhe H. Krieger, "Krahasim i sistemeve europiane të ligjit ushtarak" ("Comparison of European Military Law Systems").
10. Rregullorja e OSBE-së për aspektet politiko-ushtarake të sigurisë.

Burime të zgjedhura nga interneti

1. Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF), www.dcaf.ch.

2. Organizata Europiane e Shoqatave Ushtarake (EUROMIL), www.euromil.org.
3. Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), www.osce.org/odihr.
4. Këshilli i Europës, www.coe.int.
5. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, www.echr.coe.int.
6. Komiteti i Kombeve të Bashkuara kundër Torturës, <http://www.ohchr.org/english/bodies/cat/>.
7. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, www.assembly.coe.int.
8. Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, www.ohchr.org.
9. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, www.icrc.org.

**Drita Avdyli - Kandidate për Dr.
Gentiana Bektashi (Patozi) - Doktorante
në Studimet Europiane**

**ANALIZË MBI POLITIKËN E MAKSIMIZIMIT TË
NDIKIMIT POZITIV TË KTHIMIT
TË EMIGRANTËVE SHQIPTARË
NGA JASHTË VENDIT**

Hyrje

Migracioni sot është një ndër çështjet e vendosura në qendër të vëmendjes dhe është një ndër temat për të cilat është shkruar dhe folur më shumë, veçanërisht në dekadën e fundit. Si migracioni në tërësi ashatu dhe elementë të veçantë të tij janë studiuar gjerësisht deri më tani. Në pothuajse të gjitha këto punime autorë të shumtë kanë synuar të propozojnë politika mbi mundësitë për të përfutur nga ky fenomen.

Zgjerimi i kanaleve të rregullta të migracionit, aplikimi i politikave të kthimit, mbrojtja e të drejtave ekonomike dhe sociale të emigrantëve si dhe procedurat e lehtësuara të lëvizjes së shtetasve, konsiderohen sot si politika të cilat kanë prioritet në raport me politikat represive, në luftën ndaj migracionit të paligjshëm.

Nënshkrimi dhe implementimi i marrëveshjeve të ripranimit dhe protokolleve të zbatimit me BE-në, me të gjithë vendet e rajonit, si dhe disa vende të treta, është konsideruar nga Shqipëria si detyrim në përmbushjen e standardeve në proceset integruese, parakusht në procesin e liberalizimit të vizave me BE-në, si dhe për të nxitur kthimin e ligjshëm.

Për më tepër, kontributi i përbashkët në fushën e ripranimeve, kthimeve vullnetare si dhe riintegrit të qëndrueshëm dhe veçanërisht aktivitetet e përbashkëta kërkojnë të japin mesazhin e qartë të gjithë ata që do të tentojnë të qëndrojnë në mënyrë të paligjshme se kjo do të jetë një mundësi e humbur për ta.

Një numër i konsiderueshëm strategjish kombëtare, plane veprimi apo nisma të tjera ligjore janë ndërmarrë vitet e fundit jo vetëm nga Shqipëria, por nga shumë vende të rajonit, madje dhe ato europiane për ta shndërruar migracionin në zhvillim. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm institucionesh janë angazhuar në fushën e migracionit për shkak të natyrës shumëdimensionale që ai ka.

Synimi i këtij punimi është që ta analizojë çështjen e kthimeve të shtetasve shqiptarë jo në këndvështrimin e ngushtë të procesit të kthimit, apo respektimit të të drejtave të shtetasve të kthyer, por në propozimin e politikave se si mund të arrihet maksimizimi i ndikimeve pozitive nga ky proces.

Ky punim tenton të përcjellë se:

Së pari, duhet pranuar që migracioni është një çështje komplekse ku në të përfshihen aspekte sociale, ekonomike, politike dhe më pas ato të masave represive.

Së dyti, trajtimi i çështjeve migratore mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse bëhet në frymën e partneritetit në mes vendeve të origjinës, destinacionit duke përfshirë dhe ato transite.

Së treti, politikat migratore mund të jenë të suksesshme dhe mund të arrijnë vërtet që migracionin ta kthejnë në zhvillim apo të synojnë maksimizimin e përfitimeve nga migracioni, vetëm në sja të harmonizimit të komponentëve përbërës të politikës migratore, ku dhe politika e kthimit ka një rol parësor.

Duke e trajtuar çështjen e kthimeve në këndvështrimin e propozimeve të politikave për të siguruar maksimizimin e ndikimeve pozitive prej saj, nën fokusin e kuptimit të politikës ekzistuese migratore shqiptare, në përgjithësi, dhe asaj të kthimeve, në veçanti, si dhe të një analize konkrete jo vetëm të kthimeve, por dhe të ndikimeve pozitive të përfituara nga kthimet në një periudhë kohe trevjeçare (2008, 2009 dhe 2010), do të mundësojnë që politikat e propozuara për maksimizimin e ndikimeve pozitive nga kthimet që burojnë nga një realitet ekzistues i paraqitur në punim dhe një domosdoshmëri e identifikuar gjithashtu nëpërmjet këtij punimi.

Propozimet në formën e rekomandimeve si edhe analiza e fenomeneve në tekstin e punimit për politika mbi maksimizimin e ndikimeve pozitive nga kthimet e shqiptarëve jashtë vendit do të shërbejnë si për strukturat politikëbërëse përgjegjëse për migracionin, por dhe si një platformë për studiues të tjerë për të vazhduar më tej studimin në këtë drejtim.

**Politika e kthimit e Republikës së Shqipërisë si pjesë
e politikës migratore
Implementimi i marrëveshjeve të ripranimit**

Politika e ripranimeve si pjesë përbërëse e politikës migratore është zhvilluar pas vitit 1997, pra akoma më e re se politika migratore në përgjithësi.

Politika e ripranimit, e shprehur në një numërtë konsiderueshëm të marrëveshjeve të ripranimit dhe protokolleve të zbatimit të nënshkruara deri tani, nuk synon vetëm plotësimin e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të anëtarësimeve euroatlantike, por konsiderohet si një mekanizëm shumë i rëndësishëm në luftën kundër migracionit të paligjshëm. Shqipëria jo vetëm ka nënshkruar, por ka implementuar gjithashtu këto marrëveshje duke ripranuar një numër të konsiderueshëm të shtetasve të saj të cilët janë gjendur me qëndrim të paligjshëm në vendet e palëve kontraktuese.

Politika e ripranimit, së fundmi është plotësuar me politikën e riintegrit të të kthyerve me anë të strategjisë së riintegrit të shtetasve shqiptarë të kthyer, e cila synon pengimin e riemigrimit të të kthyerve nëpërmjet riintegrit të qëndrueshëm të tyre në vend.

Politika e largimit dhe dëbimit të të huajve është në përputhje të plotë me standardet e BE-së dhe synon garantimin e zbatimit të ligjshmërisë, mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike, si dhe sigurisë dhe interesave kombëtare. Kjo politikë përbëhet nga politika e refuzimit të hyrjes në kufi, të largimeve, të largimeve me forcë dhe dëbimeve nga territori. Në interes të ekzekutimit të largimeve dhe dëbimeve, Shqipëria ka rritur dhe forcuar kapacitetet njerëzore, logjistike e juridike.

Proceset integruese, si ato për anëtarësim në NATO, të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, të liberalizimit të vizave dhe së fundmi ato për anëtarësim të plotë në BE, kanë qenë katalizatorët e zhvillimit të shpejtë të kësaj politike, sepse Shqipëria është një ndër vendet me numrin më të madh të marrëveshjeve të ripranimit dhe protokolleve të zbatimit të nënshkruara, por dhe implementimit në të gjitha vendet e rajonit.

Ndërsa kthimi, në përgjithësi, është një masë represive, e ndërmarrë dhe pranuar nga shteti dhe që implementohet kryesisht bazuar në urdhra apo veprime të detyruara, kthimi i

emigrantëve të kualifikuar apo kthimi i trurit nxitet nga autoritetet shoqërore, nëpërmjet hartimit të programeve të posaçme dhe të mbështetura nga donatorë apo OJF¹.

Përmirësimi i politikës së kthimit, duke nxitur nga njëra anë kthimin vullnetar, por dhe duke realizuar kthimin e qëndrueshëm dhe të kategorive të tjera, nëpërmjet riintegrit të tyre është çelësi i suksesit për të rritur ndikimet pozitive nga kthimet.

Pikërisht për këtë qëllim, në vitin 2010 qeveria shqiptare miratoi Strategjinë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer.

Strategjia për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer është pjesë e politikave kombëtare për migracionin. Ajo zgjeron më tej parashikimet e Strategjisë Kombëtare për Migracionin në lidhje me riintegrimin e emigrantëve shqiptarë të kthyer, të cilët nuk adresojnë në mënyrë të plotë çështjet e riintegrit. Vizioni i saj është siguri i një kthimi të qëndrueshëm për emigrantët, përmes mbështetjes së procesit të riintegrit, pavarësisht formës së kthimit.

Strategjia shënjestrën, në radhë të parë, shtetasit shqiptarë të kthyer në kuadër të Marrëveshjes së Ripranimit KE-Shqipëri dhe marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit që Shqipëria ka nënshkruar me vende të tjera, ose përmes formave të tjera të kthimit të detyruar. Gjithashtu, kjo strategji paracakton mekanizmat që vlejnë dhe adresojnë edhe shtetasit shqiptarë të kthyer vullnetarisht.

Strategjia për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer i kushton një vëmendje të dorës së parë edhe shmangies së diskriminimit pozitiv për pjesën tjetër të popullatës jomigratore. Kjo nënkupton se “mbështetja për riintegrim” konsiston kryesisht në përmirësimin e informimit të shtetasve shqiptarë të kthyer mbi shërbimet publike ekzistuese tek të cilat kanë akses të gjithë shtetasit shqiptarë sipas kriterëve të përcaktuara nga kuadri ligjor shqiptar, dhe jo në ofrimin e shërbimeve specifike për të kthyerit.

Harmonizimi i politikave migratore të vendeve të origjinës së migracionit me vendet e destinacionit, përfshirë dhe ato tranzite, ndikon drejtpërsëdrejti në unifikimin e një politike të përbashkët për të garantuar krijimin gradual të një zone lirie, sigurie dhe drejtësie.

1. Neni 22 i Ligjit “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë”

Në këtë kontekst, Shqipëria me legjislacionin e vet konsiderohet një vend i cili garanton siguri duke penguar jo vetëm imigracionin e paligjshëm, por edhe emigracionin e paligjshëm. Nuk duhet harruar se që nga viti 1990 Shqipëria ka qenë një nga vendet që ka “eksportuar” emigrantë jo të ligjshëm. Për të mos iu larguar “eksportimit” të emigrantëve jo të ligjshëm, ata kanë qenë jo vetëm shqiptarë, por edhe të huaj, të cilët e kanë përdorur Shqipërinë si vend tranzit.

Ligji “Për të huajt” dhe aktet nënligjore të dala në/dhe për zbatim të tij, përveçse janë në përputhje me strategjinë migratore të vendit tonë, parashikojnë masa që kanë ulur ndjeshëm përdorimin e Shqipërisë për tranzitim drejt vendeve europiane.

Megjithatë, politika migratore, në përgjithësi, si dhe ajo e kthimeve, në veçanti, si politikë e re, është një politike në zhvillim, në përmirësim dhe kompletim.

I gjithë ky proces tashmë është orientuar drejt unifikimit të politikave kombëtare të të gjitha vendeve të Bashkimit Europian, të vendeve që aspirojnë të bëhen anëtare të familjes europiane, siç është dhe Shqipëria, por dhe të vendeve të tjera në partneritet, në një politikë të përbashkët migratore, përfshirë dhe atë të ripranimeve.

Direktivat e posaçme të BE-së si në standardizimin e modeleve të Marrëveshjeve të Ripranimit, por dhe të standardeve që duhen ndjekur për implementimin e këtyre marrëveshjeve, janë platforma të përbashkëta që mundësojnë këtë unifikim.

Në interes të maksimizimit të ndikimeve pozitive nga kthimet, politika e kthimeve duhet të orientohet në të ardhmen më shumë drejt nxitjes së kthimeve vullnetare, madje dhe të mbështetjes me politika favorizuese për të kthyerit, sesa kthimeve të detyruara apo me forcë.

Shqipëria është vendi i parë në rajonin e Ballkanit Perëndimor që ka nënshkruar Marrëveshjen e Ripranimit me vendet e KE-së. Ndërkohë, Marrëveshjet e para dypalëshe të Ripranimit mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera janë më të hershme, që në vitin 1997. Pikërisht për të mundësuar implementimin sa më efikas të Marrëveshjeve të Ripranimit, Shqipëria u fokusua në hartimin dhe nënshkrimin e Protokolleve të Zbatimit.

Situata e ripranimeve në vitet 2008, 2009 dhe 2010 paraqitet si më poshtë:

Të ripranuar gjithsej - shtetas shqiptarë²:

Viti 2008 - 72 155 shtetas

Viti 2009 - 65 491 shtetas

Viti 2010 - 52 917 shtetas

Implementimi i Marrëveshjeve të Ripranimit nuk konsiston vetëm në kthimin mekanik të shtetasve të vendeve pjesëmarrëse në Marrëveshje, por, në fakt, më shumë në zbatimin e një procedure të përcaktuar në Marrëveshje dhe më pas në mënyrë më të detajuar në Protokolle të Zbatimit.

Mënyra e implementimit të Marrëveshjeve të Ripranimit ndikon drejtpërsëdrejti në të gjitha procedurat që e pasojnë ripranimin e një shtetasi e më pas në faktin nëse ripranimi do të konsiderohet i suksesshëm.

Të riintegrosh një të kthyer, me qëllim që ai të mos riemigrojë përsëri, do të thotë t'i krijosh atij kushte të barabarta apo të përafërta me ato të cilat ai kishte në vendin ku u gjend me qëndrim të paligjshëm në momentin e kthimit dhe gjithashtu t'i eliminosh atij faktorët të cilët e nxitën atë më parë të emigronte në mënyrë të paligjshme.

Llojet e emigracionit

Ndikimi i tij në zhvillimin social-ekonomik

Arsyeja themelore e emigracionit është ekonomike. Emigracioni masiv i pakontrolluar buroi nga kushtet e vështira ekonomike ndërthurur me ato politike, pasojë e regjimit komunist. Më pas emigracioni shqiptar është në masën e vet mbizotëruese, i karakterit ekonomik. Një tjetër shkak janë edhe faktorët e sigurisë dhe të qetësisë, të cilët në momente të veçanta (p.sh. në vitin 1997) kanë ndikuar veçanërisht në zgjedhjen e rrugës së emigrimit. Shkollimi i fëmijëve dhe përgjithësisht siguri i një të ardhmeje më të mirë e më të sigurt për ta, përbën një tjetër motiv që haset shpesh në vendimin që marrin familjet për të emigruar.

Të gjitha këto përfshihen në konceptin për një jetë më të mirë, me të cilin përligjet rëndom shtysa për të emigruar. Ky

2. Burimi i statistikave nga Policia Kufitare dhe Migracionit.

koncept, në raport me faktorë të tillë, si papunësia, të ardhurat e pamjaftueshme për jetesë, problemet e strehimit etj., është i pamatshëm dhe përmban elementë subjektivë të perceptimit, shpresave, standardeve dhe aspiratave të individëve të veçantë. Pikërisht me këto perceptime individuale dhe subjektive shpjegohet fakti që zgjedhjen e emigracionit e kanë bërë jo vetëm individë apo familje me të ardhura shumë të vogla apo të vogla, por edhe ata që kanë të ardhura të mjaftueshme për një jetesë normale, madje ndonjëherë mjaft të mirë në Shqipëri. Po kështu individë me arsim të lartë kanë parapëlqyer të emigrojnë edhe kur në vendin pritës kryejnë punë inferiore në krahasim me profesionin dhe punën që kanë pasur në Shqipëri.

Për sa i përket përbërjes demografike, shoqërore dhe kulturore të emigrantëve shqiptarë, mund të thuhet se:

- Në emigracionin shqiptar mbizotërojnë moshat e reja (deri në 30 vjeç) dhe mesatare (40-50 vjeç). Duke pasur parasysh se flukset migratore gjatë viteve të fundit janë ulur, prirja e përgjithshme e emigracionit shqiptar do të jetë rritja e moshës mesatare.

- Në mënyrë deduktive mund të pohohet që meshkujt përbëjnë pjesën më të madhe të emigracionit.

- Prejardhja gjeografike e emigrantëve përfshin të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe është e vështirë të përcaktohet nëse ata me prejardhje nga fshati mbizotërojnë mbi elementët me prejardhje qytetare.

- Ndërsa mund të pohohet se niveli arsimor i shumicës së emigrantëve ka qenë i ulët. Vitet e fundit emigracioni është "ushqyer" me një kontingjent me shkallë më të lartë arsimimi dhe kulture, qoftë për shkak të prurjeve migratore, qoftë për shkak se një pjesë e mirë e studentëve shqiptarë që kanë përfunduar studimet jashtë vendit kanë zgjedhur të qëndrojnë në vendin pritës.

- Ndonëse nuk ka të dhëna sistematike dhe të besueshme për punësimin, profesionet që ushtrojnë, statusi ekonomik etj. i emigrantëve shqiptarë, informacioni i disponueshëm dhe vëzhgimet sporadike shtojnë të mendohet se shumica dërrmuese e emigrantëve shqiptarë ushtrojnë profesione që i përkasin punës fizike dhe numri i intelektualëve që ushtrojnë profesionet e tyre është i paktë. Në veçanti gratë, edhe pse me arsim të lartë, punojnë, në një shkallë të madhe, në shtëpitë e vendasve (si pastruese, babysitter etj.).

Emigracioni i parregullt

Emigracioni i paligjshëm dhe për vitin 2010 është zhvilluar kryesisht drejt Greqisë (98 %) dhe me pas drejt vendeve të tjera të BE-së, si: Itali, Gjermani, Francë, Belgjikë, Angli etj.

Numrin e emigrantëve të paligjshëm përbëjnë shtetas shqiptarë të kthyer nga vendet e destinacionit apo të tranzitimit, si dhe ato të kapur në tentativa për kalim të paligjshëm të kufirit.

Në raport me vitin 2009, në vitin 2010 vihet re një ulje me 12 567 raste të emigrimit të paligjshëm. Në total, për vitin 2010 janë regjistruar 53 711 raste kthimi të shtetasve shqiptarë dhe 3 raste kthimi të shtetasve të vendeve të treta. Kjo ulje erdhi si rezultat i masave të marra për forcimin e kontrollit të kufirit në kuadër të angazhimit për të plotësuar detyrimet për përfitimin e procesit të liberalizimit të regjimit të vizave me BE-në për shtetasit shqiptarë, si dhe nga fushata informuese për qytetarët mbi këtë proces që filloi nga mesi i vitit 2010.

• Ndikimet e emigracionit në tregun e punës

Ndikimi i emigracionit në tregun e punës dhe në kushtet kur ky emigracion përbën një përqindje të konsiderueshme në raport me popullsinë dhe kur kategoria e emigrantëve është 90 %, pjesa më aktive e tregut të punës mund të veçohet si në aspektin afatshkurtër ashtu dhe afatgjatë.

Ndikimi i emigracionit në tregun e punës duhet shikuar në kontekst me shkallën e papunësisë në vend si dhe ritmet e zhvillimit ekonomik të vendit që lidhen me perspektivën e tregut të punës për fuqi punëtore.

Ndërkohë që emigracioni mund të konsiderohet si fenomen negativ në tregun e punës, nga ana tjetër ai ka një ndikim pozitiv në aspektin afatshkurtër, pasi shoqërohet me rënie të papunësisë së popullsisë aktive. Efekti pozitiv i rënies së papunësisë (në mënyrë mekanike për shkak të emigrimit) përveç të tjerash qëndron dhe në faktin se reduktohen shpenzimet buxhetore për të paguar kategorinë e të papunëve. Megjithatë, në të njëjtën kohë që kemi reduktim të buxhetit për të mbuluar pagesën sociale për të papunët, si pasojë e uljes së numrit të papunësisë nga emigracioni, kemi dhe reduktim të të ardhurave nga taksimi në buxhet, i ardhur për të njëjtën arsye, nga emigracioni.

Përveç emigracionit të mirëfilltë, një ndikim në tregun e punës kanë dhe lëvizjet e popullatës nga një zonë në një zonë

tjetër, për motive punësimi, ose i quajtur ndryshe “emigracioni i brendshëm”, i cili duhet analizuar në këndvështrimin e ndikimit në tregun e punës së bashku me emigracionin klasik drejt vendeve të tjera të destinacionit.

• **Ndikimet në demografi**

Emigracioni si lëvizje apo zhvendosje e popullatës nga vendi i origjinës në vendin e destinacionit, apo ai i brendshëm si lëvizje e popullatës nga një zonë në një zonë tjetër, domosdoshmërisht shoqërohet me ndryshime në demografi.

Analizimi i ndikimeve në demografi i këtyre ndryshimeve për shkak të emigracionit ndihmon për të përcaktuar përshtatjen e politikave të brendshme si në terma afatshkurtër ashtu edhe afatgjatë, pasi kjo tablo e ndryshimeve pasqyron ndryshimet e momentit, por dhe trendin për të ardhmen.

Në bazë të këtyre ndryshimeve do të ndryshojë dhe planifikimi i zhvillimit të zonave të vendit, orientimi i investimeve, prioritetet, shërbimeve ndaj komunitetit etj.

Gjithashtu, emigracioni ka ndikim jo vetëm në ndryshimin e numrit të popullatës, por dhe të gjinisë, moshës, kualifikimit etj. Ndonjëherë, prishja e raporteve ndërmjet gjinive mund të ndikojë në elementë të tjerë, si shtimi i popullsisë apo interesi për të qëndruar në një zonë banimi të caktuar.

Ndikimi i emigracionit në demografi mund të shkojë deri në prishjen e balancave rajonale dhe të kërkojë ndryshim (zgjerim apo zvogëlim) të njësive administrative të organizimit të sistemit të qeverisjes vendore.

• **Ndikimi final**

Ndikimi më i rëndësishëm i migracionit konsiderohet në rritjen e remitançave dhe përdorimi i tyre në mënyrë të drejtë në interes të zhvillimit ekonomik të vendit.

Zgjerimi i kanaleve të ligjshme të migracionit do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit edhe nëpërmjet zgjerimit të mundësive dhe kanaleve për sjelljen e investimeve direkte të huaja në vend, por dhe të diasporës.

Nxitja e migracionit të ligjshëm, nga njëra anë, si dhe lufta kundër migracionit të paligjshëm, nga ana tjetër, do të plotësonin dy komponentët e domosdoshëm për ta shndërruar migracionin në zhvillim.

Të gjitha së bashku, përveç ndikimit në politikën e brendshme, do të kenë një ndikim direkt në politikën e jashtme, në elementin kyç të saj, atë të integritetit evropian.

Ndikimet e zhvillimit social-ekonomik në politikat migratore si dhe format e tjera të ndikimit mbi migracionin

Në interes të përmirësimit të normativës migratore në përputhje me *acquis communautaire*, nga viti 2005 dhe në vazhdim është punuar në përmirësimin e kësaj normative në përputhje me atë të BE-së, por dhe në interes të mbështetjes së zhvillimit social-ekonomik të vendit.

Kthimi i migracionit në zhvillim ka qenë motoja e politikës migratore për vitet 2005-2010. Ky objektivi është synuar të arrihet nëpërmjet maksimizimit të përfitimeve nga migracioni i ligjshëm, jo duke e nxitur, por duke e mirëmenaxhuar atë, si dhe nëpërmjet minimizimit të kostove nga migracioni i ligjshëm duke e parandaluar dhe luftuar atë.

Shqipëria është një vend në të cilin shfaqen të gjitha dukuritë migratore, ndikimet e të cilave ndihen shumë shpejt si në këndvështrimin pozitiv ashtu dhe atë negativ.

Vlerësim i ndikimit pozitiv i kthimeve në Republikën e Shqipërisë për periudhën 2008-2010

Përgjatë viteve, migracioni i kthimit ka lindur si një tjetër dukuri brenda migracionit shqiptar për arsye të ndryshme që lidhen me arsyet e emigracionit, me situatën e personit që ka emigruar apo kontekstin familjar. Këta faktorë shpesh konsiderohen se ndikojnë te kthimi vullnetar. Nga ana tjetër, përvojat e kthimit mund të lindin nga përvoja negative e migracionit, si: dështimi në marrjen e statusit të rregullt në vendet e destinacionit, kthimi i detyruar si pasojë e qëndrimit të paligjshëm në vendet e destinacionit, sipas përcaktimeve në marrëveshjet e ripranimit apo praktikave të tjera të kthimit në vendin e origjinës.

Në përgjithësi emigrantët shqiptarë me status të parregullt në BE, veçanërisht ata që jetojnë në Itali dhe në Greqi kanë qenë më të ekspozuar ndaj kthimit të detyruar sesa emigrantët me status të rregullt të kthyer vullnetarisht.

Pavarësisht formave të kthimit vullnetar apo të detyruar, të kthyerit mund të klasifikohen si investitorë të mundshëm, emigrantë të kualifikuar ose pa profesion pas kthimit. Po ashtu,

ndërhyrjet që lehtësojnë përvojën e kthimit duhet të jenë të ndryshme në varësi të nevojave të personave në secilën kategori. Këto ndërhyrje duhet të sigurojnë riintegrimin e personave të kthyer me qëllim qëndrueshmërinë e kthimit. Qeveria shqiptare është e motivuar të mbështesë kthimin dhe riintegrimin e shtetasve të saj për të siguruar një kthim të qëndrueshëm në vend si dhe maksimizimin e të mirave të migracionit.

Për ta analizuar kthimet në Shqipëri, le të marrim si rast statistikor atë të vitit 2009.

Sipas statistikave zyrtare të Ministrisë së Brendshme, gjatë vitit 2009 janë regjistruar 64 625 raste kthimi ose 47 239 shtetas shqiptarë të kthyer, prej të cilëve 38 412 janë raste të kapura në kufi ose në afërsi të kufirit dhe 26 213 raste të kapura në thellësi të territoreve të vendeve të origjinës.

Të ndarë sipas gjinisë, 62 331 raste ose 34 940 persona kanë qenë meshkuj dhe 2 294 raste ose 12 299 persona kanë qenë femra; të ndarë sipas moshës, 11 236 raste ose 6 741 persona kanë qenë minorenë meshkuj dhe 452 raste ose 388 persona kanë qenë minorene femra. Motivi i emigrimit në 99,99 % të rasteve ka qenë për punësim.

Sipas analizës së mësipërme rezulton se nëse numri i kthimeve është 64 625, numri i personave të kthyer është 47 239, diferenca në mes këtyre dy të dhënave që është 17 386, përbën numrin e personave të cilët kanë rëmigruar përsëri, apo që ripranimi i tyre nuk ka rezultuar efikas as në rrafshin minimal të sigurimit të qëndrueshmërisë së tyre pas kthimit.

Mungesa e zbatimit të kushteve të kërkuara dhe përcaktuara në Marrëveshjet e Ripranimit, ka bërë që kthimet më shumë të kenë qenë “transport” ndërkufitar i shtetasve sesa aktivitetet migratore.

Megjithëse çështje si kthimi dhe riintegrimi i shtetasve shqiptarë, ngritja e shërbimeve të punësimit dhe të formimit profesional për ta, ngritja e shërbimeve sociale për grupet më në nevojë, kthimi dhe riintegrimi i viktimave të trafikimit, i fëmijëve vulnerabël apo të braktisur, janë në fokus të disa strategjive, si: Strategjia Sektoriale e Punësimit dhe Formimit Profesional 2007-2013; Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013; Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013; Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010 dhe Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima

të Trafikimit, Strategjia Kombëtare për Fëmijët 2005-2010; Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom si dhe Planit Kombëtar i Veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2010-2015, përsëri mungesa e aplikimit të këtyre masave që në momentet e para, në atë të ripranimit në kufi, prish zinxhirin e aktiviteteve të mëpastajshme. Për pasojë dhe mundësitë për të përfituar ndikim pozitiv nga kthimet kanë qenë të kufizuara dhe të diktura.

Shndërrimi i politikës së kthimit në një mundësi zhvillimi

Siç është trajtuar dhe më lart, politika e kthimit është pjesë përbërëse e politikës migratore dhe përbëhet nga politika e largimeve, largimeve me forcë, deportimeve si dhe ripranimit të shtetasve të vet. Kjo është ajo që rëndomë përmendet dhe elaborohet kur bëhet fjalë për politikën e kthimeve.

Sikur në planin e parë do të mendonim se politika e kthimeve të përbëhej vetëm nga këto aspekte, do të orvateshim të gjenim rrugë, mënyra, të propozonim politika se si t'i kthenim gjithë këto aktivitete në mundësi zhvillimi.

Nëse do të kërkonim se në ç'drejtim do t'i orientonim për të kthyer politikat e kthimit në mundësi zhvillimi, këto mundësi do t'i gjenim pikërisht në të gjitha ato fusha ku migracioni ka ndikim dhe që janë trajtuar sa më sipër në këtë punim.

Gjithashtu, nëse do ta konturizonim politikën e kthimit vetëm në konceptin konservator të tij, përsëri ka vend për të menduar për politika të cilat do të synojnë, por dhe do të mundësojnë maksimizimin e përfitimeve apo shndërrimin e kthimeve në zhvillim.

Në këto raste, nuk do të ishte e vështirë të bënim analogjinë me ndikimet e kthimeve në fushat e ndryshme të jetës ekonomike, shoqërore dhe politike të vendit, ku në mënyrë modeste më lart është dhënë kuptimi i ndikimeve pozitive të kthimeve në këto fusha. Pra, pikërisht ky është trendi apo politika e rekomanduar për ta shndërruar kthimin në zhvillim.

Politikat e propozuara deri tani në këtë drejtim nga institucionet shqiptare, si në Strategjinë Kombëtare mbi Migracionin 2005-2010, apo aktivitetet e përcaktuara në Planin e saj të Veprimit,

në planin teorik duket sikur e përmbushin qëllimin e mbështetjes dhe nxitjes së kthimeve të këtyre kategorive, por praktika e implementimit gjatë këtyre viteve tregon se ende duhet të bëhet punë në këtë drejtim. Në raport me këtë kategori emigrantësh, për të shndërruar kthimin e tyre në zhvillim, çelësi i suksesit qëndron në politikat për të nxitur dhe realizuar de facto kthimin e tyre.

Konkluzione dhe rekomandime

Për të garantuar maksimizimin e përfitimit nga kthimi i emigrantëve apo për ta shndërruar kthimin në zhvillim, politikat e rekomanduara do të përfshinin:

- Garantimin e kthimeve të suksesshme nëpërmjet riintegrit të qëndrueshëm të të kthyerve në vend.
- Nxitjes së kthimeve vullnetare për të gjithë emigrantët - në përgjithësi dhe në veçanti - për ata që në momente të caktuara mund të mos gjenden në pozita shumë të lakmueshme në vendin e destinacionit.

- Nxitjen dhe mbështetjen e kthimit të bizneseve shqiptare të ngritura nga sipërmarrës shqiptarë në vendet e destinacionit.

Në interes të shndërrimit të kthimeve në zhvillim, është e rëndësishme të harmonizohen politikat në mes vendeve të destinacionit dhe vendeve të origjinës mbi migracionin, ose e thënë ndryshe kërkohet të ngrihen partneritete të gjera gjeografikisht në këtë fushë.

Mungesa e informacionit apo e të dhënave mbi emigrantët jashtë vendit nga strukturat shtetërore përgjegjëse ka minimizuar deri në pamundësi menaxhimin e kthimit të shtetasve shqiptarë, e për pasojë menaxhimin dhe ndikimeve si pozitive ashtu dhe negative nga kthimet.

Në të shumtën e rasteve ndikimet pozitive dhe ato negative janë përlllogaritur vetëm nëpërmjet treguesve makroekonomikë të vendit, në mungesën e dërgesave nga emigrantët apo shpeshherë dhe në analizën e kthimeve nëpërmjet Marrëveshjeve të Ripranimit.

Procesit të menaxhimit të kthimit i ka munguar një tërësi masash për të mundësuar ndikimet pozitive nga kthimet, si p.sh.:

- a) krijimi i një baze të dhënash qendrore pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për shtetasit shqiptarë të kthyer dhe përditësimi i saj periodik. Kjo do të ndihmonte në identifikimin e dukurive demografike në nivel prefekturë dhe do t'u mundësonte institucioneve të përfshira në shërbimet e riintegrit të bënin vlerësime të sakta dhe të përditësuara të përhapjes së migracionit të kthimit nëpër rajone. Baza e të dhënave do të ndihmonte gjithashtu në monitorimin e asistencës për riintegrim dhe suksesin e saj në vijimësi;
- b) për të arritur në një koordinim sa më të mirë të punës, ky proces nxjerr në pah nevojën për mundësimin e marrjes së informacionit paraprak për rastet e kthimit të detyruar, flukset dhe shpërndarjen e tyre nga ana e sporteve të migracionit, për të përmirësuar bazën e të dhënave si dhe për të ndihmuar në njohjen e profileve të shtetasve shqiptarë të kthyer përpara referimit të mundshëm drejt strukturave apo shërbimeve të tjera.
- c) forcimi i mekanizmit institucional për informimin dhe referimin e shtetasve shqiptarë të kthyer te shërbimet publike me interes për ta. Nevojitet një komunikim i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve që luajnë rol aktiv në njohjen dhe lehtësimin e procesit të kthimit dhe riintegrit. Ato duhet të shkëmbejnë vazhdimisht informacion, ekspertizë dhe burime me njëra-tjetrën për të qartësuar pozicionin e tyre në procesin e riintegrit dhe limitet e përfshirjes së tyre, si dhe për të planifikuar rritjen e mëtejshme të kapaciteteve në drejtim të riintegrit;
- ç) përmirësimi i bazës ligjore për të mundësuar funksionimin e mekanizmit të referimit në vazhdimësi dhe për të krijuar më shumë hapësirë për grupet në nevojë mes kategorisë së shtetasve shqiptarë të kthyer (fëmijët, minoritetet: përfshirë romët, personat e trafikuar, shtetasit shqiptarë me probleme ekonomike të kthyer etj.);
- d) rritja e kapaciteteve të strukturave ekzistuese të shërbimeve të referimit për shtetasit shqiptarë të kthyer, konkretisht sporteve të migracionit pranë zyrave rajonale dhe vendore të punësimit;
- e) identifikimi i mundësive ekzistuese për formim profesional për shtetasit shqiptarë të kthyer.

- f) sigurimi i kushteve të nevojshme për të siguruar vënien në përdorim të aftësive të fituara në emigracion, përfshi ndihmën për punësim, formim profesional, apo edukim të mëtejshëm;
- g) nxitjen e shtetasve shqiptarë të kthyer për të kontribuar në zhvillimin e vendit përmes investimit, veçanërisht shtetasit shqiptarë që kthehen në zonat rurale;
- h) nxitja e bashkëpunimit me shoqërinë civile për zbatimin e projekteve të përbashkëta në ndihmë të riintegrit.

Literatura

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Strategjia Kombëtare mbi Migracionin 2005-2010.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Plan i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare mbi Migracionin.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e të Kthyerve si dhe Plan i saj i Veprimit, Tiranë, 2010.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Strategjia Sektoriale e Punësimit dhe Formimit Profesional 2007-2013; Tiranë.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010.

Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit.

Strategjia Kombëtare për Fëmijët 2005-2010.

Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom.

Plani Kombëtar i Veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2010-2015.

Ligji “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë”.

Ministria e Brendshme, Marrëveshjet e Ripranimit mes Republikës

së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, si dhe Marrëveshje të tjera Ripranimi dhe Protokolle Zbatimi që Republika e Shqipërisë ka nënshkruar.

Legjislacioni i BE-së në fushën e migracionit

Treaty establishing the European Community - Title IV Article 63 Provisions on visas, asylum, immigration and other policies related to free movement of persons.

Thessaloniki European Council, 19/20 June 2003 (§ 24-27).

Laeken European Council (PDF File 140 KB) 14/15 December 2001 (§ 38-41).

Tampere European Council 15/16 October 1999 (§ A); The conclusions of this European Council constitute the Tampere programme.

Vienna European Council 11/12 December 1998 (§ 85).

Council and Commission Action Plan implementing the Hague Programme on strengthening freedom, security and justice in the European Union - 10 June 2005

Official Journal C 198, 12/08/2005 P. 0001 – 0022.

10.03.2006 COM (2006) 110; Modified proposal for a Council Regulation amending Regulation (EC) 1030/2002 laying down a uniform format for residence permits for third-country nationals (presented by the Commission pursuant to Article 250 (2) of the EC Treaty).

14.10.2002 COM (2002) 564 final; Communication from the commission to the council and the European parliament on a community return policy on illegal residents.

15.11.2001 COM (2001) 672 final; Action plan on illegal immigration (part III, points 4.1. to 4.8.). Communication from the Commission to the Council and the European Parliament on a common policy on illegal immigration.

28.05.2001, Council Directive 2001/40/EC of 28 May 2001 on the mutual recognition of decisions on the expulsion of third country nationals.

16.05.2007 COM (2007) 249 final; Proposal for a Directive of the European Parliament and of the Council providing for sanctions against employers of illegally staying third-country nationals {SEC(2007) 596} {SEC(2007) 603} {SEC(2007) 604}.

01.09.2005 COM (2005) 391 final; Proposal for a Directive of the European Parliament and of the Council on common standards and procedures in Member States for returning illegally Staying third-country nationals.

ABSTRACTS

Protecting Human Rights in the Armed Forces of Bosnia and Herzegovina: the Role of BiH Parliamentary Military Commissioner
By Jasna Pekic and Jasmin Porobic

The Parliamentary Military Commissioner improves protection of human rights in the Ministry of Defense and the Armed Forces of Bosnia and Herzegovina. It significantly contributes to the increased confidence in the military sector by creating greater transparency in human rights protection without prejudice to the military hierarchy.

This paper reflects on the role and mandate of the Military Commissioner in the overall human rights institutional framework. It compares the mandate of the Commissioner with those of the Inspector General of the Ministry of Defense of Bosnia and Herzegovina and the Institution of the Ombudsman of Bosnia and Herzegovina. By clearly demonstrating the role, mandate and the results of the Military Commissioner, this paper argues that the Military Commissioner has a positive impact on Bosnia and Herzegovina endeavors to implement international human rights standards not only in the civilian but also in the military environment.

The German model of the Parliamentary Military Commissioner, as adopted in Bosnia and Herzegovina, improved the human rights protection of military personnel. The number of reported human rights violation cases has significantly increased. The rate of resolved cases is close to 90 %. The Commissioner creates an environment that improves access to justice, free legal aid and human rights protection to the military personnel. It eliminates the risk of fear of retribution of military commanders and contributes

to the better human rights protection in Bosnia and Herzegovina. Many other challenges lay ahead and the Parliamentary Military Commissioner will remain central in resolving human rights violation cases of the military personnel in the future to come.

Gender and security issues

By Elona Dhëmbo

Gender is a crucial component of our identity. However, gender interacts with and is influenced by many other factors such as class, ethnicity, nationality, sexual orientation, age etc. Men learn to be “masculine” and women learn to be “feminine” according to their age, social class, ethnic origins, country, culture, and even sub-cultures, such as urban and rural (GTZ, 2005). These lead to many types and forms of masculinities and femininities. In some societies the border between them is very sharp, in others more blurry. These sharp (to various degrees) gender differences are present in all areas of life, including security. Women, men, girls and boys have different security experiences, needs, priorities and actions defined by both their gender and sex (Valasek, 2007; GTZ 2005). Gender is important to our security and this makes gender central to the security debate. Reviewing relevant literature in the area this paper puts forward the argument that integration of gender perspective into the security reform processes is becoming a must in order to address the gender differences in security. It is time for gender perspective to be mainstreamed also in Albanian security debates which thus far have been mainly gender blind.

Institutional Discrimination against the Minority Groups in Bosnia and Herzegovina: Barrier to the EU Membership

By Bedrudin Brljavac

Although over more than 10 years Bosnia and Herzegovina has been going through extensive European Union-related reform process the country is still facing serious democratic deficit. In

particular, the post-Dayton public sphere has been dominated by ethno-nationalist political elites which are doing everything to exclude non-nationalists and members of minority groups from the decision-making process. This is a clear paradox since one of the main objectives behind the integration of the European countries into the European Community was to reduce disintegrative and dangerous influences of nationalists and establish peaceful, prosperous, and secure community. In this article, we analyze the process of the post-Dayton ethno-nationalization resulting in a widespread discrimination against the so-called Others as they are defined in the Constitution. In the post-war BiH democratic participation has turned into a competition between the three ethnic communities, Bosniaks, Serbs, and Croats, rather than race of equal individuals having equal right of vote. That's why, Bosnian people are still living under the political system which is closer to ethno-democracy or ethnocracy rather than democratic regime. Under such discriminatory regime BiH can not enter the European Union which is a model of open and democratic society.

Pensioning system in the Albanian Armed Forces **By Foto Duro**

Despite glorifying declarations that politicians extend to militaries time and again, another, quite different, reality exists concerning financial treatment of the Albanian militaries, especially upon their separation from the active duty. This is becoming evident in many occasions, being them individual-against-state courter trials, or organized demonstrations. One of the drivers of this "unease" is the fact that state care towards retired militaries, especially the financial support, has been reduced drastically. Constitutional Court ruled twice in favor of retired militaries, but the Government practically disregarded Court's decisions and followed reduction of pensions for the retired militaries. This fact, is actually hidden somehow, in the midst of a "law labyrinth", difficult to be interpreted. In this article, through legal framework analysis, calculations and comparisons with practices of other countries on armed forces human resource management strategies in general and their

militaries care systems in particular, the author intends to clarify further the policies and practices in place, in this regard and their direct effect in recruitment flow in the Albanian Armed forces. He maintains that paying attention to retired militaries is an obligation for their long career sacrifices; on the other hand, it is the best marketing to convince the new generation to join armed forces. He underlines the special importance of transparency in treating the Albanian militaries upon their separation from active service. Another issue elaborated in the article is lobbying (actually missing in Albania) and its role in bringing the voice of militaries, both in active duty and reserve, in the Parliament and other forums where their demands are discussed and solved. In addition, the author makes some recommendations to ease the financial burden of the actual pensioning scheme for retired militaries, by applying some dedicated projects for their training, as well as disseminating information on job opportunities, aiming at possible reintegration retirees in civil life, combined with a carefully and reasonably extension of their stay in service.

The Albanian Armed Forces and Human Rights (Freedom of Association)

By Rezart Tërshana

The Albanian Constitution contemplates very carefully the fundamental human rights and freedoms that are enjoyed in the Republic of Albanian as well as the instruments for guaranteeing the protection of those rights. From this perspective, this study discusses the freedom of association (in political parties and the participation in political activities) of the armed forces personnel.

International law and treaties set the obligation for the national legislation to reflect the rights and duties of the armed forces personnel and to guarantee that the later may freely enjoy and realize the fundamental human rights and freedoms.

This study gives an overview of the legislation, policies and mechanisms for the protection of the human rights in the Armed Forces. Moreover, the Albanian practice is being compared with some other NATO member states in terms of how human rights

are being applied for the armed forces personnel. This study concludes with some recommendations about the steps that need to be undertaken so that the policies and practices in relation to the human rights in the Armed forces are fully compatible with the international standards and the Constitution of the Republic of Albania.

An Analysis of Maximizing the Positive impact of the Return Policy for the Albanian Migrants.

By Drita Avdyli

Gentiana Bektashi (Patozi)

Migration constitutes today a very sensitive and important issue. The extension of regular migration channels, the application of return policies, the protection of economic and social rights of migrants as well as the facilitation of procedures for the free movement of people enjoys today more priority than repressive policies of fighting irregular migration.

This study aims to analyse the return process of the Albanian citizens, not from the strict sense of analysing the process itself or how the rights of the returnees are being respected, but from the perspective of achieving a maximisation of the positive impact from the reintegration of the Albanian returnees.

This paper proposes policies to secure the benefits of the return process, with a focus on the existing migration policy and especially the return policy, by analysing the positive impacts of this process in the last 3 years.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHTJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË -24

Formati: 15.5 x 24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: ++355 4 22 40 116
Tiranë, 2013